



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 10/23

Rahovec, 18.10.2023

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e dhjetë (10), e cila do të mbahet më **27 tetor 2023 (premtë)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar – shtator 2023;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Draft - planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) 2023 – 2031;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-00239-0, në zonën kadastrale Bërnjak;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-00236-0, në zonën kadastrale Bërnjak;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.29/23, i datës 28.2.2023, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër;
8. Shqyrtimi i vendimit për organizimin e mësimi joformal në institucionin e arsimit dhe aftësimin profesional në shkollën “Selajdin Mullaabazi – Mici”
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për shpalljen “QYTETAR NDERI” të Komunës së Rahovecit, z. Erich Rathfelder, gazetar i Republikës së Gjermanisë.

KRYESUES I KUVENDIT

Arbër Zenuni

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) dhe nenit 40, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, Rregullores (MASHT) Nr. 01/2017 për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe të aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.10.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për organizimin e arsimit dhe të aftësimit për të rritur në IAAP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec

1. Me këtë vendim, **lejohet** organizimi i arsimit dhe i aftësimit për të rritur në IAAP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec, në drejtimet dhe profilet si në vijim:
 - 1.1. Drejtimi: Ekonomi, Profili: Tregti me pakicë e shumicë, Kontabilitet;
 - 1.2. Drejtimi: Teknologji Ushqimore, Profili: Përpunim i produkteve ushqimore; dhe
 - 1.3. Drejtimi: Makineri, Profili: Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit.
2. Pagesa (participimi) për organizimin e mësimi sipas pikës 1 të këtij vendimi është si në vijim:
 - 2.1. Për një klasë: 250 € (dyqind e pesëdhjetë euro); dhe
 - 2.2. Për diplomën e përfundimit të shkollimit: 50€ (pesëdhjetë euro).
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **Drejtorisë për Arsim,**
- **Shërbimit të Kuvendit, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01Nr.____/23
Arbër Zenuni

Datë:27.10.2023

Kryesues i Kuvendit

Republic of Kosovo
Municipality of Rahovec

In accordance with article 12, paragraph 12.2, letter d) and article 40, of Law Nr. 03/L-040 for the Local Self-Governing of the Republic of Kosovo ("*Official Newspaper of the Republic of Kosovo Nr. 28/2008*"), provisions of Law NR. 04/ L-143 for the

Adult Education and Training in the Republic of Kosovo, of The Regulation (MASHT) Nr. 01/2017 for the planning and expanses of realized own entries from the educational institutions and professional competencies and the adult education, article 10, paragraph 2, point 2.4, article 39, article 40 and article 57, of the Status of the Municipality of Rahovec, Nr. 1005, from the date 29.3.2017, Municipality of Rahovec, in the meeting held in 27.10.2023, comes to the:

D E C I S I O N

For the arrangement of the adult education and training in IAAP “Selajdin Mullabazi - Mici” in Rahovec

1. With this decision, the organising of the adult education and training in IAAP “Selajdin Mullaabazi - Mici” in Rahovec **is authorized**, in the directions and profiles such as:
 - 1.1. Course: Economics, Profile: Majority and Minority Trade, Accounting;
 - 1.2. Course: Food Technology, Profile: Processing of food products; and
 - 1.3. Course: Machinery, Profile: Heating Installation, air-conditioning, water-supply and wastewater.
2. Payments (participation) for the organising of learning according to point 1 to this decision as follows:
 - 2.1. For per class: 250€ (two hundred and fifty euros); and
 - 2.2. For the diploma of graduation from the schooling: 50€ (fifty euros).
3. The application of this decision will be handled by the Directorate of Education of the Municipality of Rahovec.
4. After the approval from the Assembly of the Municipality of Rahovec, this decision is effective 15 days after it is sent to the supervising authority, in understanding with article 81 of Law Nr. 03/L-040 for the Local Self-Government and article 8, linked with article 9 to the Regulation (QRK) Nr. 10/2019 for the administrative revision of the municipalities acts, modified and completed with The Regulation (QRK) Nr. 06/2021 and 7 days after the public announcement in the announcement table or the official web-page of the Municipality:

This decision will be sent to:

- **MAPL,**
- **The Mayor of the Municipality,**
- **Department of Education,**
- **The Assembly Service, and**
- **The Archive.**

M U N I C I P A L A S S E M B L Y I N R A H O V E

C

01 Nr. ____/23
Date:27.10.2023

Assembly

Arber Zenuni
Leader of The Municipal



KOMUNA E RAHOVECIT

Plani Komunal i Veprimit për Energjinë dhe Klimën (PKVEK)

2023 - 2030

Tetor 2023

Deklarim:

Studimi, mbledhja e të dhënave dhe hartimi i planit është realizuar nga Shoqata për Efikasitet të Energjisë së Ripërtëritshme (SH.E.E.R). Pikëpamjet e hartueseve të këtij plani (SH.E.E.R).

Me vendim të kryetari të Komunës 01 Nr.334/23, të datës 15.03.2023, emërohet grupi punues për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë:

- Përparim Krasniqi - Menaxher i projektit
- Besnik Hoti - Anëtar
- Avni Morina - Anëtar
- Afrim Limani - Anëtar
- Erhan Morina - Anëtar
- Saranda Sallteku - Anëtare
- Afrim Dina - Anëtar
- Berat Duraku - Anëtar
- Nora Boshnjaku - Anëtare
- Fatmir Hoti - Anëtar
- Diellza Çanta - Anëtare

PËRMBAJTJA

Shkurtesat/Akronimet.....	8
1. Hyrje.....	9
1.1. Kontekst.....	9
1.1.1. Objektivi i PKVEK.....	9
1.1.2. Kuadri ligjor dhe politik.....	10
1.1.3. Aktivitetet dhe procesi përgatitor.....	12
1.1.4. Zhvillimi i PKVEK.....	13
1.1.5. Zbatimi i PKVEK dhe përfitimet e pritshme.....	16
1.1.6. Miratimi si dokument zbatues.....	16
1.1.7. Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit dhe raportimi.....	17
2. Përmbledhje e plotë.....	17
3. Informacioni bazë për komunën.....	22
3.1. Pozicioni dhe topografia.....	23
3.2. klima Lokale.....	24
3.3. Popullsia dhe vendbanimet.....	24
3.4. Struktura administrative lokale dhe ajo organizative për zbatimin e veprimit të energjisë dhe të klimës (NECP).....	25
3.5. Treguesit ekonomikë dhe financiarë.....	27
3.6. Rëndësia me politikat vendore, kombëtare dhe të tjera përfshirja e autoriteteve lokale.....	28
3.7. Përvoja në zbatimin e Masave të efikasitetit të energjisë.....	29
3.7.1. Aftësia për të zbatuar projekte.....	30
4. Treguesit e energjisë komunale (furnizimi dhe prodhimi i energjisë komunale).....	30
4.1. Furnizimi me energji.....	30
4.1.1. Elektricitet.....	31
4.1.2. Fosilet djegëse.....	34
4.1.3. Biomasa.....	36
4.2. Gjenerimi i energjisë.....	38

4.2.1. Nga burimet e rinovueshme të energjisë (HEC, PV diellore, termike diellore, pompë nxehtësie, erë, gjeotermale).....	39
4.2.2. ngrohja qendrore.....	39
4.3. Prodhi i energjisë sipas sektorëve.....	39
4.3.1. Prodhi i energjisë në sektorin e ndërtimit (banesa, ndërtesa publike).....	39
5. Analiza e konsumit të energjisë sipas sektorëve.....	39
5.1. Konsumi i energjisë në ndërtesa.....	41
5.1.1. Konsumi i energjisë në ndërtesat e banimit.....	42
5.1.2. Konsumi i energjisë në ndërtesat në pronësi komunale.....	43
5.1.3. Konsumi i energjisë në shërbimet publike.....	52
5.2. Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë.....	53
5.3. Konsumi i energjisë në sektorin e transportit.....	54
5.3.1. Flota komunale.....	55
5.3.2. Transporti publik.....	56
5.3.3. Automjete private dhe komerciale.....	56
6. Objektivat dhe shënjestrimet lokale.....	57
6.1. Reduktimet e gazrave serrë.....	58
6.2. Energji e Ripërtëritshme.....	59
6.3. Efiçienca e energjisë.....	60
6.4. Varfëria energjetike.....	61
7. Analizat e Emetimeve të gazrave serrë.....	62
7.1. Inventari referencial i CO2.....	62
7.2. Inventari i skenarit 'biznes si rëndom' (BSR) të CO2 -2023-2030. .	64
8. Politikat dhe masat për përmirësimin e EFIÇIENCËS të energjisë, Integritit të BRE-VE dhe reduktimin e emetimeve të GS.....	69
8.1. Politikat dhe masat lokale.....	70
8.1.1. Masat e efiçencës së energjisë.....	70
8.1.2. MASAT E BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISE (BRE) 94	
8.1.3. Masat ndërsektoriale - ngritja e NDËRGJEGJËSIMIT, informacioni dhe ngritja e kapaciteteve.....	100

8.1.4. Masat e reduktimit të gazrave serrë.....	101
8.1.5 Reduktim total i gazrave serrë.....	102
9. Plani i veprimit.....	103
9.1 Zbatimi i masave të Politikës Vendore, Promovimi dhe ngritja e vetëdijes.....	103
9.2 Zbatimi i masave në sektorin publik.....	104
9.3 Zbatimi i masave në bujqësi.....	105
9.4 Zbatimi i masave në transport.....	105
9.4.1 transporti publik.....	105
10. Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e PKVEK /Planit të Veprimit. .	105
10.1 Menaxhimi i energjisë komunale – PKVEK.....	106
10.2 Koordinimi.....	106
10.3 Raportimi.....	107
10.3.1 Monitorimi dhe raportimi i brendshëm.....	110
10.3.2 Raportimi te qeveria qendrore AKEE.....	111
11. Modeli dhe burimet e financimit të zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë - SECAP dhe MEEAP.....	112
11.1 Financimi me Buxhetin Komunal.....	112
11.2 Financimi nga Buxheti i Qeverisë Qendrore.....	112
11.3 Financimi nga donatorët.....	112
11.4 Financimi nga BE-së.....	113
12. Përmbyllje.....	113
13. Referenca.....	114
14. Shtojcat -.....	115

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Potenciali i kursimit të energjisë sipas sektoreve.....	21
Figura 2 Struktura organizative.....	26
Figura 3 Konsumi i energjisë elektrike në territorin e Komunës së Rahovecit	32
Figura 4 Rrjeti i energjisë elektrike.....	34
Figura 5 Basenet qymyrbajtëse të Kosovës.....	36
Figura 6 Konsumi i energjisë elektrike i shprehur në %.....	43
Figura 7 Konsumi i specifik i energjisë në ndërtesat administrative.....	45
Figura 8 Konsumi specifik i energjisë në sektorin e arsimit.....	48
Figura 9 Konsumi i energjisë në sektorin Shëndetësisë.....	50
Figura 10 Struktura e automjeteve të regjistruara sipas llojit.....	57
Figura 11 Emisioni i CO2 në të gjitha sektorët i shprehur në %.....	64

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim të energjisë në ndërtesat komunale	18
Tabela 2 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndriçimit publik.....	18
Tabela 3 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin Banimit.....	20
Tabela 4 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin Komercial.....	20
Tabela 5 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e bujqësisë.....	20
Tabela 6 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e transportit...	21
Tabela 7 Të dhënat përmbledhëse.....	21
Tabela 8 Lista e popullsisë etnike në komunën e Rahovecit.....	25
Tabela 9 Buxheti i Komunës për vitin 2023.....	27
Tabela 10 Projektet e zbatuara në fushën e EE.....	29
Tabela 11 Konsumi i energjisë elektrike në Komunën e Rahovecit.....	32
Tabela 12 Konsumi i naftës sipas sektoreve në komunën e Rahovecit.....	34
Tabela 13 Rezervat e qymyrit në Republikën e Kosovës.....	35
Tabela 14 Vlerat kalorike të drurit.....	37
Tabela 15 Konsumi i energjisë elektrike dhe termike në të gjitha sektorët.	41
Tabela 16 Konsumi i energjisë për ngrohje.....	42
Tabela 17 Konsumi i energjisë në ndërtesat administrative.....	44

Tabela 18 Konsumi i energjisë në ndërtesat e arsimit.....	46
Tabela 19 Konsumi i energjisë ne sektorin e Arsimit.....	48
Tabela 20 Konsumi i energjisë në ndërtesat e nen sektorit te shëndetësisë.	48
Tabela 21 Konsumi total i energjisë për ngrohje.....	50
Tabela 22 Konsumi i energjisë në ndërtesat për kulturë e sport.....	50
Tabela 23 Llojet e llambave dhe kapaciteti i instaluar.....	51
Tabela 24 Sipërfaqet e kulturave bujqësore sipas kategorive (ASK).....	54
Tabela 25 Konsumi total i energjisë në sektorin e arsimit.....	54
Tabela 26 Konsumi i energjise ne transport sipas sektorve.....	55
Tabela 27 Konsumi i energjise ne transportin publik për Autobus.....	56
Tabela 28 Konsumi i energjisë në transportin publik për Taksi.....	56
Tabela 29 Nr i automjeteve te regjistruara për vitin bazë.....	56
Tabela 30 Faktori parësor i energjisë.....	63
Tabela 31 Emisioni i CO2 në të gjitha sektorët.....	63
Tabela 32 Konsumi i energjisë dhe emitimi i CO2 në ndriçim publik.....	64
Tabela 33 Emisionet e CO2 në vitin referues 2019 për burimet e energjisë dhe nënsektorët në sektorin e ndërtesave.....	65
Tabela 34 Parashikimet e emisioneve të CO2 në vitin 2030 për skenarin pa masa për sektorin e ndërtesave.....	65
Tabela 35 Parashikimi i rritjes së përgjithshme të emisioneve të CO2 në vitin 2030 sipas sektorëve të konsumit të energjisë për skenarin pa masa.....	66
Tabela 36 Reduktimi i emisioneve te CO2 gjer në vitin 2030 për skenarin me masa në sektorin e ndërtesave për secilën masë.....	66
Tabela 37 Zvoglimi i emisioneve të CO2 gjer në vitin 2030 për skenarin me masa në sektorin e ndërtesave për nënsektorët.....	67
Tabela 38 Krahاسimi i emisioneve të CO2 në vitin 2019 dhe 2030 sipas sektorëve të konsumit të energjisë për skenarin me masat.....	67
Tabela 39 Krahاسimi i projeksioneve të emisioneve të CO2 në vitin 2030 për skenarin BSZ dhe skenarin me masat.....	68
Tabela 40 Caku dhe niveli i kursimit te energjisë në raport me konsumin e përgjithshëm mesatar vjetor të energjisë si dhe reduktimi i emetimeve te CO2 ne te gjithë sektoret (2023-2030).....	69
Tabela 41 Kompleksiteti në procesin e raportimit dhe metodologji.....	107
Tabela 42 Konsumi i energjisë dhe potenciali i kursimit në ndërtesat të cilat kanë nevojë për intervenim në sektorin e arsimit	115
Tabela 43 Konsumi i energjisë dhe potenciali i kursimit në ndërtesat të cilat kanë nevojë për intervenim në sektorin e shëndetsisë.....	116
Tabela 44 Konsumi i energjieë dhe potenciali i kursimit në ndërtesat të cilat kanë nevojë për intervenim në sektorin e administratës.....	117

SHKURTESAT/AKRONIMET

AKEE	Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
FKEE	Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
PKVEK	Plani Komunal i Veprimit për Energji dhe Klimë;
LEAP	Sistemi i Planifikimit Afatgjatë i Energjisë
IEB	Alternative; Inventari i Emisioneve Bazë të CO ₂
BE	Bashkimi Evropian;
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
CFL	Compact Fluorescent Lamp- llambë fluoreshente kompakte;
CO ₂	Dyoksidi i karbonit;
EE	Eficienca e Energjisë;
HC	Hidrocentrale;
KEDS	Kompania Kosovare për Shpërndarjen e energjisë elektrike;
KESCO	Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike;
kV	Kilovolt;
kWh	Kilovat orë;
KP	Kompani private;
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave;
ktoe	Kiloton oil ekuivalent;
LED	light-emitting diode;
m ²	Metër katror;
m ³	Metër kub;
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
MW	Megavat;
AMF	Ambulancat e mjekësisë familjare;
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë familjare;
QMF	Qendra e Mjekësisë familjare;
SME	Softueri për menaxhim të energjisë;
SHFMU	Shkolla Fillore e mesme e ulët;
UA	Udhëzimi Administrativë;
BSZ	Skenari biznes si zakonisht

1. HYRJE

1.1. KONTEKST

Komuna e Rahovecit sipas Ligjit për Eficiencë të Energjisë nr. 06/L -079 ka zhvilluar Planin Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për periudhën 2019-2021 dhe sipas këtij ligji komunat janë të obliguara që të përditësojnë këto plane dhe ti aprovojnë në periudha të rregullta 3 vjeçare. Duke qenë se në nivelin qendror Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) do të zëvendësojë Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë në të ardhmen e afërt, atëherë edhe komunat duhet t'i përshtaten këtyre ndryshimeve.

Zhvillimi i një Plani Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) është vetëm njëra nga disa procese që janë të nevojshme për një komunë për të vendosur dhe arritur objektivat e saj për Eficiencën e Energjisë, energjinë e ripërtëritshme dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë. PKVEK do të përfshijë një vlerësim të status quo-së në kontekstin vendor të energjisë, një vlerësim bazë të emetimeve të CO₂ me referencë vitin bazë, një identifikim të qartë të politikave dhe masave lokale për reduktimin e energjisë dhe emetimeve, duke përfshirë veprimet e planifikuara, afatet kohore për zbatimin, përgjegjësitë e caktuara, vlerësimi i ndikimit dhe kostos.

Objektivi kryesor i Planit Komunal për Energjinë dhe Klimën është të udhëzojë autoritetet vendore/lokale për të përgatitur planin dhe veprimet e tyre në mënyrë që të kontribuojnë ndjeshëm në zbatimin e objektivave Kombëtare të Energjisë dhe Klimës për vitin 2030 duke synuar planifikimin afatgjatë për dekarbonizimin e ekonomisë lokale.

1.1.1. OBJEKTIVI I PKVEK

Objektivat specifike të cilat parashihet të arrihen pas zbatimit të planit të veprimit janë:

- Përmirësimi i shërbimeve komunale,

- Reduktimi i kostos së energjisë në buxhetin komunal,
- Renovimi i sistemeve të energjisë dhe ndërtesave,
- Përmirësimi i komfortit të punës dhe banimit,
- Informimi lidhur me shfrytëzimin eficient të energjisë operatorët, dhe përdoruesit fundor;
- Zvogëlimin e emetimeve të dëmshme për mjedisin.
- Krijimin dhe zhvillimin e sistemit për menaxhim të energjisë;
- Krijimin e kapaciteteve profesionale për planifikim, monitorim dhe raportim;
- Zvogëlimin e konsumit të energjisë në ndërtesat publike komunale, në ndriçimin publik dhe në transport;
- Përmirësimin e kushteve sanitare dhe përmirësimit e kushteve në ndërtesat publike;
- Ruajtjen e mjedisit përmes reduktimit të emetimeve të CO2 dhe gazrave tjera me efekt serë përmes zbatimit të masave të EE dhe përdorimin e energjisë se pastër.

Lidhur me plotësimin e objektivit që ka të bëjë me burimet e ripërtëritshme, strategjia parasheh ndërmarrjen e veprimeve vijuese.

Të kontribuojë në objektivat e një prej katër sektorëve në fokus të Fondi i Hapur Rajonal (FHR)

Lidhur me plotësimin e objektivit që ka të bëjë me burimet e ripërtëritshme, strategjia parasheh ndërmarrjen e veprimeve vijuese

Vazhdimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe Planit Kombëtar për Eficiencë të Energjisë, me qëllim të arritjes së cakut të përcaktuar 25% BRE dhe Kursim të Energjisë 11% të konsumit të përgjithshëm fundor, duke u bazuar në objektivat strategjike të përcaktuara në dokumentet strategjike për kapacitetet e reja prodhuese të energjisë elektrike nga BRE-të;

1.1.2. KUADRI LIGJOR DHE POLITIK

Hapat e parë drejt krijimit të Politikave Energjetike të Kosovës janë bërë në vitin 2004 me përshtatjen e tri ligjeve bazike për energjinë, Ligji mbi Energjinë, Ligji mbi Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Një progres substancial drejt krijimit të një kornize të qëndrueshme ligjore për energjinë është arritur pas nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore në vitin 2005. Gjatë dekadës së kaluar disa dokumente ligjore janë miratuar dhe ndryshuar në mënyrë që legjislacioni për energjinë të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-s. Korniza ligjore për energjinë në Republikën e Kosovës përbëhet prej dokumenteve strategjike, ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve administrative.

LIGJI I RI PËR ENERGJINË (LIGJI Nr. 05/L -081) - Neni 9- Roli i qeverisjes lokale thotë se Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë dhe Programin për Zbatimin e Strategjisë, si dhe bilanceve të energjisë.

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) Nr. 09/2017, datë 6 shtator 2017, PËR ZYRAT E ENERGJISË KOMUNALE - përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave komunale të energjisë për të adresuar çështjet e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave energjetike në nivel lokal. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të Zyrave Komunale të Energjisë më poshtë janë shënuar përgjegjësitë kryesore:

- Të krijojë një bazë të dhënash dhe të mbajë një sistem informacioni për grumbullimin e rregullt të të dhënave për konsumin e energjisë në baza periodike, shpenzimet e energjisë dhe të dhëna të tjera relevante duke mbajtur një regjistër që mundëson përzgjedhjen e indikatorëve potencial të eficiencës së energjisë për ndërtesat komunale energjetike,
- Të raportojë për zbatimin e PVKEK, dhe zhvillimet e pritshme në pjesën e mbetur të Programit,
- Të zhvilloj aktivitetet e planifikimit të sektorit të energjisë, bazuar në Strategjinë e Energjisë, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komunave,
- Të sigurojë të dhënat e nevojshme për Ministrinë përkatëse për përgatitjen e PVKEK-it, rishikimin dhe përgatitjen e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për tre (3) vjet në pajtim me Ligjin për Energjinë,
- Të monitorojë vazhdimisht zbatimin e PVKEK në nivelin komunal dhe t'i raportojë Ministrisë për zbatimin e tij

Baza ligjore e Republikës së Kosovës e cila rregullon fushën e energjisë përkatësisht EE përbëhet nga ligjet, udhëzimet administrative (UA) dhe rregulloret specifike. Në këtë kontekst, aktet kryesore ligjore janë si vijon:

- Ligji për Energjinë 05 / L-081
- Ligji për Energjinë Elektrike 05 / L-085
- Ligji për Rregullatorin e Energjisë 05 / L-084
- Ligji për Eficiencën e Energjisë 06 / L-079
- Ligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa 05/L-101
- Ligji për Ngrohje Qendrore 03 / L-116
- Ligji për Ndërtime 04 / L-110

- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2017 për caqet e energjisë nga burimet e Ripërtëritshme
- Udhëzimi administrativ Nr. 06/2017 për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme
- Udhëzimi administrativ Nr. 03/2019 për përmbajtjen e energjisë së lëndëve djegëse të përcaktuara për përdorim fundor
- Udhëzimi administrativ Nr. 03/2020 lidhur me kërkesat për eficiencën e energjisë për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror
- Udhëzimi administrativ Nr. 10/2020 për metodat dhe parimet e përbashkëta për llogaritjen e ndikimit të eficiencës së energjisë
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2020 për potencialin e eficiencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje
- Udhëzimi administrativ Nr. 06/2020 për llogaritjen e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2020 për kushtet e përgjithshme për analizën e kosto përfitimit në lidhje me masat për promovimin e eficiencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2020 për metodologjinë lidhur me përcaktimin e eficiencës nga procesi i bashkëprodhimit
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2021 për kornizën e përgjithshme të raportimit për eficiencën e energjisë
- Udhëzimi administrativ Nr. 06/2021 për shërbimet e energjisë (ESCO)
- Rregullorja e MMPH Nr. 01/2018 për inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe sistemeve për kondicionim të ajrit
- Rregullorja e MMPH Nr. 02/2018 për metodologjinë kombëtare për kalkulimin e performancës së integruar energjetike të ndërtesave
- Rregullorja e MMPH Nr. 03/2018 për procedurën e certifikimit të performancës energjetike në ndërtesë
- Rregullorja e MMPH Nr. 04/2018 për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave
- Rregullorja për kushtet e përgjithshme të operimit të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE), 2019
- Rregullorja Nr. 01/2020 për kriteret minimale për auditorët e energjisë përfshirë ato të kryera si pjesë e sistemeve të menaxhimit të energjisë
- Rregullorja Nr. 02/2020 për kërkesat minimale për faturimin dhe informacionin e faturimit bazuar në konsumin aktual

- Rregullorja Nr. 05/2020 për sistemet e ofruesve të shërbimit energjetik dhe kriteret minimale për auditimin energjetik

Me qëllim të mbështetjes së vendeve anëtare për të kaluar nga shfrytëzimi i burimeve energjetike fosile drejt formave të pastra të energjisë si dhe me qëllim të realizimit të zotimeve të dhëna në kuadër të marrëveshjes së Parisit të aprovuar në 2015, BE në vitin 2019 ka rishikuar kornizën e vet ligjore lidhur me energjinë dhe klimën. Korniza e re ligjore e BE-së parashihet që do të ofroj përparësi të shumta për konsumatorët, mjedisin dhe ekonominë e vendeve përkatëse. Në këtë kuadër, direktivat kryesore në kuadër të kornizës së rishikuar ligjore e BE-së janë si vijon:

- Direktiva lidhur me performancën energjetike të ndërtesave (EU 2018/844)
- Direktiva për burimet e ripërtëritshme të energjisë (2018/2001/EU)
- Direktiva për eficiencën e energjisë (EU 2018/2002)
- Rregullorja për Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimit për Klimën (EU 2018/1999)
- Rregullorja për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (EU 2019/943)

1.1.3. AKTIVITETET DHE PROCESI PËRGATITOR

PKVEK është dokument gjithpërfshirës i cili hartohet me qëllim të ndryshimit të ekosistemit komunal sa i përket fushës së energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Si të tilla, janë dokumente komplekse, për zbatimin e të cilave kërkohet përkushtim i strukturave më të larta komunale, gjithpërfshirje dhe konsistencë e cila duhet të përcillet me masa përkatëse në domenin e burimeve njerëzore, rregullimit institucional dhe komunikimit me qytetarët. Disa prej veprimeve konkrete të cilat janë të nevojshme të ndërmerren me qëllim të krijimit të parakushteve të nevojshme për hartimin dhe zbatimin me sukses të PKVEK janë si vijon:

- Integrimi i objektivave dhe masave të PKVEK në strategjinë e përgjithshme të zhvillimit të Komunës;
- Emërimi i stafit profesional për planifikimin dhe zbatimin e projekteve të kursimit të energjisë, aplikimin e masave të eficiencës së energjisë, aplikimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme dhe lëndëve djegëse ekologjike të pranueshme;
- Vlerësimi i mjeteve financiare për zbatimin e PKVEK;
- Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të masave të kursimit të energjisë dhe kursimeve financiare, si dhe monitorimi i reduktimit të gazrave serrë;

- Mbështet zbatimin e masave të parashikuara në të gjithë periudhën e parashikuar të zbatimit të PKVEK, deri në vitin 2030;
- Monitorimi dhe raportimi mbi dinamikën e zbatimit të PKVEK deri në vitin 2030;
- Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve në lidhje me shkallën e zbatimit të PKVEK;
- Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të të gjithë aktorëve kryesorë dhe qytetarëve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të PKVEK.

1.1.4. ZHVILLIMI I PKVEK

PKVEK përbëhet nga 9 aktivitete të rëndësishme:

- Përcaktimi i afatit kohor për zbatimin e PKVEK përmes përzgjedhjes së vitit bazë (referent);
- Klasifikimi i konsumatorëve të energjisë në Komunën e Rahovecit sipas sektorëve;
- Analizimi i konsumit të energjisë sipas sektorëve;
- Përcaktimi i sektorëve me prioritet për veprim, bazuar në rezultatet e analizës të konsumit të energjisë;
- Zhvillimi i inventarit të emisioneve bazë të CO₂ (IEB);
- Zhvillimi i PKVEK i cili synon arritjen e zvogëlimin të emisioneve të CO₂ për së paku 40% gjer në vitin 2030;
- Përcaktimi i orarit dhe programit të zbatimit të PKVEK-s;
- Përcaktimi i mekanizmave të financimit për zbatimin e PKVEK-s;
- Krijimi i kornizës ligjore për zbatimin e PKVEK-s

Veprimi i parë që duhet bërë për zhvillimin e PKVEK të Komunës së Rahovecit është përcaktimi vitit referent (viti bazë), për të cilën do të përgatitet Inventari referent i Emisioneve të CO₂. Afati kohor për implementimin e PKVEK, është periudha mes vitit referent dhe vitit 2030. Zbatimi i PKVEK duhet të bëhet brenda kësaj periudhe, dhe si rezultat duhet të arrihet zvogëlimi i emitimit të CO₂ për së paku 40 % deri në vitin 2030, krahasuar me emitimin CO₂ në vitin referent.

Komisioni Evropian rekomandon që viti 1990 duhet të merret si vit referent, nëse komuna e ka informacionin e kërkuar mbi konsumin e energjisë dhe emisionet e CO₂. Nëse komuna nuk i ka të dhënat e kërkuara për vitin 1990, rekomandohet që si vit referent të merret viti për të cilin Komuna i ka në dispozicion të dhënat e kërkuara.

Në rastin aktual, si vit referent për hartimin e PKVEK për komunën e Rahovecit është marrë viti 2019, meqë për atë vit ekzistojnë të dhëna të cilat janë prezantuar edhe në Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2019-2022.

Sa i përket konsumatorëve të energjisë në Komunën e Rahovecit , në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian, të njëjtit janë të kategorizuar në tre sektorë:

- Ndërtesat;
- Transporti;
- Ndriçimi publik.

Me qëllim të trajtimit më të detajuar, sektori i ndërtesave më tej është ndarë në tre nënsektorët e mëposhtëm:

- Ndërtesat në pronësi të Komunës së Rahovecit ;
- Ndërtesat e sektorit komercial dhe të shërbimeve (zyrat e kompanive private, bankave, veprimtarive tregtare, shkollave private, shërbimeve mjekësore private etj.);
- Ndërtesat e banimit.
- Bujqësia

Ndërsa sektori i transportit është ndarë në tre nënsektorët vijues:

- Flota e veturave në pronësi të Komunës së Rahovecit ;
- Transporti publik në Komunën e Rahovecit ;
- Automjete private dhe komerciale.

Sektori i ndriçimit publik nuk ka nevojë të ndahet në nënsektor, për shkak të thjeshtësisë së tij.

Një hap tjetër i rëndësishëm për analizimin e konsumit të energjisë në sektorët dhe nënsektorët e përcaktuar është procesi i mbledhjes së të dhënave. Të dhënat e besueshme janë parakusht i një analize të mirëfilltë të konsumit të energjisë në të gjithë sektorët dhe nënsektorët dhe bazuar në rezultatet e një analize të tillë do të mund të përcaktohet Inventari i Emisioneve të CO₂ në vitin referent. Rrjedhimisht grumbullimi dhe përpunimi sistematik i të dhënave të mbledhura është një nga aktivitetet më komplekse dhe më të rëndësishme në procesin e zhvillimit të PKVEK.

Me qëllim të analizimit të konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave, përkatësisht në të gjithë nënsektorët e ndërtesave, nevojitet grumbullimi i të dhënave vijuese për vitin 2019:

- Numri i ndërtesave dhe karakteristikat e tyre;
- Konsumi energjisë elektrike;
- Konsumi i energjisë për ngrohje nga sistemi i ngrohjes në largësi (ngrohjes nga qyteti);
- Konsumi i lëndëve të tjera djegëse për ngrohje (dru zjarri, nafta, qymyri etj.).

Në anën tjetër, të dhënat të cilat nevojitet për të analizuar konsumin e energjisë në sektorin e transportit, për vitin 2019 janë:

- Struktura e flotës të automjeteve në pronësi të Komunës së Rahovecit , sipas llojit të karburantit;
- Struktura dhe karakteristikat e transportit publik në Komunën e Rahovecit ;
- Numri dhe lloji i automjeteve të udhëtarëve dhe atyre komerciale (automjeteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive biznesore);
- Konsumi i llojeve të ndryshme të karburantit për flotën e automjeteve në pronësi të Komunës së Rahovecit ;
- Konsumi i llojeve të ndryshme të karburanteve për transport me autobus në Komunën e Rahovecit .

Bazuar në numrin dhe llojin e lloji i automjeteve të udhëtarëve dhe atyre komerciale (automjeteve në pronësi private), do të vlerësohet kilometrazhi dhe konsumi i llojeve të ndryshme të karburantit.

Për dallim nga dy sektorët paraprak, analiza e konsumit të energjisë në sektorin të ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit është më e thjeshtë. Për këtë lloj analize janë të nevojshme të dhënat e mëposhtme:

- Struktura dhe karakteristikat e rrjetit të ndriçimit publik (numri i llambave, lloji dhe karakteristikat, distanca midis shtyllave të ndriçimit etj.);
- Konsumi i energjisë elektrike në komunë në vitin referent.

Bazuar në të dhënat e emisioneve të CO₂ për sektorë përkatësisht nënsektorë të ndryshëm të konsumit të energjisë në komunë, analizat e energjisë për vitin 2019, bilancet kombëtare të konsumit të viteve të kaluara, parashikimin e konsumit të energjisë për periudhën gjer me 2030 si dhe bazuar në dokumentet zyrtare të Komunës së Rahovecit , duhet të identifikohen masat dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren për rritjen e eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë me qëllim të zvogëlimit të emisioneve të CO₂ për më shumë se 32% gjer në vitin 2031.

Për të identifikuar masat dhe aktivitetet, zbatimi i të cilave rezulton në reduktim të ndjeshëm të emisioneve të CO₂ gjer në vitin 2030 me parametra të kënaqshëm ekonomik dhe energjetik, do të përpunohen parametrat e mëposhtëm lidhur me masat e propozuara për kursimin e energjisë:

- Kursimet e mundshme të energjisë gjer në vitin 2030;
- Afati dhe orari i zbatimit;
- Mundësitë e financimit;
- Kostot e zbatimit;
- Reduktimi potencial i emisioneve të CO₂ gjer në vitin 2030.

Duhet theksuar se një nga aspektet më të rëndësishme të PKVEK është harmonizimi i tij me kornizën ligjore. Të gjitha masat dhe aktivitetet e propozuara duhet të harmonizohet me legjislacionin përkatës të Komunës së Rahovecit , të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

1.1.5. ZBATIMI I PKVEK DHE PËRFITIMET E PRITSHME

Zbatimi i masave të identifikuara për përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe BRE-ve, aktivitet ky që do të rezultojë në zvogëlimin e emisioneve të CO₂ së paku 32% gjer në vitin 2030, është faza më e vështirë e procesit të zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të PKVEK-s, aktivitet ky që kërkon kohë dhe përpjekje, si dhe burime të konsiderueshëm financiare. Miratimi i PKVEK-s si dokument zyrtar shënon fillimin e zbatimit të tij, proces ky shumë kompleks që varet nga faktorë të ndryshëm ekonomik, social dhe teknik si dhe që kërkon organizim dhe bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë ndërmjet shumë palëve të interesuara në komunë.

Hapi i parë i zbatimit të PKVEK, është krijimi i grupit punues për zbatimin e PKVEK (në tekstin në vijim grupi punues) dhe emërimi i koordinatorit të grupit. Detyra kryesore e grupit punues është që të koordinojë procesin e implementimit të PKVEK. Parakusht i koordinimit të suksesshëm është hartimi dhe zbatimi i një strategjie efektive të komunikimit në dy nivele. Në nivelin e parë është shkëmbimi i vazhdueshëm i informatave që duhet të sigurohet ndërmjet zyrave të ndryshëm të Komunës, shërbimeve dhe departamenteve, pra në mes të gjitha subjekteve të përfshira në zbatimin e projekteve të eficiencës së energjisë dhe personave përgjegjës për zbatimin e projekteve (projektantëve, ndërtuesve, etj.). Në nivelin e dytë, informatat lidhur me të gjitha aktivitetet gjatë implementimit të PKVEK duhet t'iu komunikohen qytetarëve dhe grupeve të interesit. Komunikimi i mirë si dhe përvoja e duhur profesionale dhe aftësitë e anëtarëve të grupit punues, janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të PKVEK.

1.1.6. MIRATIMI SI DOKUMENT ZBATUES

Pranimi i PKVEK si dokument zyrtar detyruet në Komunën e Rahovecit është elementi kyç për zbatimin e tij të suksesshëm dhe në fund, arritjen e zvogëlimit të emisioneve të CO₂ gjer në vitin 2030. Për këtë arsye, është e rëndësishme që njerëzit kryesor nga ekzekutivi i Komunës të janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të PKVEK. Për më tepër, është gjithashtu shumë e rëndësishme që të krijohet zyret për energji sipas udhëzimit administrativ (qrk) nr. 09/ 2017 për zyrat komunale të energjisë si organ këshillëdhënës që do të monitoroj dhe vlerësoj të gjitha fazat e realizimit të PKVEK. Pasi Kuvendi i Komunës ta miraton PKVEK si dokument teknikisht të qëndrueshëm dhe praktikisht të obligueshëm, administrata e Komunës/Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë/ duhet të shpall atë dokument si zyrtar dhe të obligueshëm, gjë që është një parakusht për zbatimin e tij.

1.1.7. MONITORIMI DHE KONTROLLI I ZBATIMIT DHE RAPORTIMI

Faza e monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të PKVEK-s duhet të kaloj nëpër disa nivele njëkohësisht:

- Monitorimi i afatit të zbatimit për secilën masë të identifikuar;
- Monitorimi i performancës së zbatimit për secilën masë të identifikuar;
- Monitorimi dhe kontrolli i kursimit të energjisë të arritur për secilën masë të identifikuar;
- Monitorimi dhe kontrolli i kursimeve të energjisë i arritur në sektorët dhe nënsektorët e konsumit të energjisë;
- Monitorimi dhe kontrolli i kursimit të përgjithshëm të energjisë i arritur në për të gjitha masat e zbatuara;
- Monitorimi dhe kontrolli i zvogëlimin të emisioneve të CO₂ të arritur për secilën masë të identifikuar;
- Monitorimi dhe kontrolli i zvogëlimin të emisioneve të CO₂ të arritur nëpër sektorët dhe nënsektorët e konsumit të energjisë;
- Monitorimi dhe kontrolli i zvogëlimet total të arritur të emisioneve të CO₂ për të gjitha masat e zbatuara.

Njëra nga metodat për monitorimin e suksesshëm të kursimeve të arritura energjisë në sektorët dhe nënsektorët e ndryshëm, si dhe zvogëlimet e arritura të emisioneve të CO₂, për çdo masave individuale dhe për PKVEK-n në përgjithësi, është përcaktimi i Inventarit të ri të Emisionit të CO₂. Rezultatet më të mira nga i gjithë procesi i zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të PKVEK-s në Komunë do të arrihen në qoftë se Inventar i ri i Emisioneve të CO₂ është përcaktuar çdo katër vjet. Është e rëndësishme të theksohet se metodologjia duhet të jetë e njëjtë me atë të përdorur për

Inventarin e Emisioneve referente të CO2 për vitin 2019. Vetëm përdorimi i një metodologjie të njëjtë, e bën të mundur krahasimin dhe i përgjigjet pyetjes nëse objektivat për vogëlimin e emisioneve të vendosura për CO2 janë duke u përmbushur.

2. PËRMBLEDHJE E PLOTË

PKVEK paraqet informacionin lidhur me konsumin e energjisë në ndërtesat publike komunale, në ndriçimit publik, ndërtesat e banimit, ato komerciale, sektorin e bujqësisë, Transporti dhe flotës te automjeteve komunale.

Plani Komunal i Veprimit për Energji dhe Klimë paraqet gjetjet dhe rekomandimet kryesore për të gjithë sektorët e konsumit të energjisë në komunën e Rahovecit , sidomos për dy sektorët që nuk janë trajtuar deri tash atë të Banimit dhe Komercial.

Përmes, PKVEK në komunën e Rahovecit promovon një planifikim afatmesëm për arritjen e objektivave mjedisore dhe ekonomike. Në kuadër të këtij plani, rëndësi të veçantë i është kushtuar potencialit të kursimit të energjisë, reduktimit të CO2 dhe përdorimit të BRE gjithashtu edhe identifikimit të prioriteteve për investime në periudhën afatmesme.

Në vazhdim janë paraqitur të gjithë sektorët e konsumit të energjisë në komunën e Rahovecit , të ndara në tabela sipas sektorëve

SEKTORI I NDERTESAVE KOMUNALE

Tabela 1 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim të energjisë në ndërtesat komunale .

Sektori	Konsumi [MWh/vit]	Potenciali për kursim [kWh /vit]	Reduktimi i [tCO2 vit]
Administratë	435.45	67,789.28	107.00
Arsim	3,532.64	476,507.37	228.55
Shëndetësi	880.92	371,729.67	202.78
Kulturë sport	53.13	-	31.15
Total	4,902.14	916,026.32	569.48

NDRIÇIMI PUBLIK

Tabela 2 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndriçimit publik

<i>Raporti i shpenzimeve para zbatimit te masave te EE</i>	
Konsumi i energjisë elektrike [kWh/vite]	1,045,012.19
Çmimi i energjisë elektrike [€/kWh]	0.11
Kostoja vjetore e energjisë elektrike [€]	114,951.34 €
Shpenzimet ne mirëmbajtje [€]	150,000.00
Emitimi i tCO2	1,494.37
<i>Raporti i shpenzimeve pas zbatimit te masave të EE</i>	
Konsumi vjetor i energjisë elektrike [kWh]	627,007.31
Kursimi vjetor i energjisë elektrike [kWh]	418,004.88
Çmimi i energjisë elektrike [€/kWh]	0.11
Kostoja vjetore e energjisë pas zbatimit te masave te EE [€]	68,970.80 €
Kursimi vjetor në mirëmbajtje [€]	150,000.00 €
Reduktimi i Emetimit te tCO2	896.62

Siç shihet në tab. shpenzimet vjetore aktualisht janë **1,045,012.19 kwh/vite** ose **114,951.34 €** ku ne çmim nuk është përfshirë dhe mirëmbajtja, kurse me zbatimin e masave te eficiencës se energjisë do te reduktohet fatura e energjisë elektrike ne **68,970.80 €**, ndërsa do të kursehet energji elektrike në **418,004.88 kwh/vit** ose **45,980.54 €**.

Për shkak se trupat ndriçues janë me kualitet te dobët dhe sistemi i vjetër i rrjetit, shpenzimet ne mirëmbajtje janë te larta ku arrin deri ne **150,000.00 €** ne vit dhe nëse i shtohet edhe shpenzimet e konsumit te energjisë qe është **114,951.34 €** bazuar ne kapacitetin instalues do te arrin deri ne **264,951.34 €** .Potenciali i kursimit te energjisë elektrike është mjaft i lart, nëse zbatohen masat te EE, do te arri deri ne **45,980.54 €** qe përfshin edhe kursimin ne mirëmbajtje.

Në këtë llogaritje të potencialit për kursim te energjisë është përfshire i tërë sistemi i ndriçimit publik.

SEKTORI I BANIMIT

Tabela 3 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin Banimit

Sektori	Konsumi [MWh/vit]	Emetimi i t CO2/vit	Potenciali për kursim [MWh /vit]	Reduktimi i emetimit [tCO2 vit]
Sektori i banimit	69,755.73	38,775.20	153,274.40	153,274.41

Bazuar në të dhënat e konsumit të energjisë elektrike për vitin 2019, të cilat janë marrë nga zyra e KEDS, kemi analizën të specifikuar si në tab. 3, ku % e kursimit dhe reduktimit të CO2 është 30% .

SEKTORI KOMERCIAL

Tabela 4 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin Komercial

Sektori	Konsumi [MWh/vit]	Emetimi i [tCO2 vit]	Potenciali për kursim [MWh /vit]	Reduktimi i emetimit [tCO2 vit]
Komercial	20,868.05	6,092.48	35,761.41	1,828.74

Sektori i komercial si konsumatori i dytë pas sektorit të banimit, del të jetë me potenciali të kursimit të energjisë me **20,868.05MWh/vit** dhe reduktim të emetimit të **CO2 1,828.74t/vit**.

SEKTORI BUJQËSISË

Ne baze të regjistrimit të bujqësisë në vitin 2022 nga QRA, në komunën e Rahovecit janë gjithsejtë 10 makineri në bujqësore që konsumojnë nafta, në vlerë 72,000.00 litra/vit. Potenciali i kursimit të energjisë në bujqësi është 584 MWh/vit .

Tabela 5 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e bujqësisë

Sektori	Konsumi i energjisë nafta [MWh/vit]	Emetimi i [tCO2 vit] nga nafta	Kursim i energjisë [MWh /vit]	Reduktimi i emetimit [tCO2 vit]
Sektori -i bujqësisë	584	158.85	508.08	138.2

Të dhënat për sektorin e bujqësisë tregojnë se konsumi i energjisë nga lënda djegëse e naftës për aktivitete bujqësore del të jetë 584 [MWh/vit] shifër e marrë nga qendra e regjistrimit të automjeteve në komune .

SEKTORI TRANSPORTIT

Transporti në komunën e Rahovecit për të gjithë sektorët, Publik, Komercial dhe Individual.

Tabela 6 Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e transportit

Sektori	Konsumi i energjisë nafta [MWh/vit]	Emetimi i [tCO2 vit] nga nafta	Kursim [MWh /vit]	Reduktimi i emetimit [tCO2 vit]
Transporti në komunën e Rahovecit	279,867.40	76,123.93	243,484.64	66,227.82

Në këtë sektor janë mbledhur të dhënat e të gjithë transportit në komunën e Rahovecit . Të dhënat janë siguruar nga qendra e regjistrimit të automjeteve dhe nga zyrtarët komunal për sektorët publik.

1 litër naftë = 8kwh/litër. Faktori i emisionit CO2 kg/kwh për naftë është 0.272 kg/kwh.

POTENCIALI I KURSIMIT SIPAS PKVEK


Dokumenti identifikon masat për ngritje kapacitetesh dhe vetëdijesim të banorëve të Komunës së Rahovecit për rëndësinë e kursimit të Energjisë, masat për renovime të stokut të ndërtesave publike sipas radhës së përcaktuara në bazë të kriterëve të përvetësuar, masat elementare të EE në sektor të ,ndërtesat komunale ,banimit ,komercial ,bujqësi ,transport dhe ndriçim publik.

Efektet e masave të rekomanduara rezultojnë me vlerat sikur në tabelën në vijim.

Tabela 7 Të dhënat përmbledhëse

Sektori	Kursimet i energjisë	Investime për tri vite [EUR]	Reduktimi i
	[MWh/ vit]		[tCO ₂ vit]
Politika komunale, promovim	/	150,000.00	/
Ndërtesat komunale	4,902.14	2,039,170.50	569.48
Ndriçim publik	418.00	2,800,000.00	896.62
Banimit	153,274.41	31,179,942.40	11,632.56
Komercial	35,761.41	8,123,048.80	1,827.74
Transporti	243,484.64	260,000.00	66,227.82
Gjithsej	437,840.60	44,552,161.70	81,154.22

Figura 1 Potenciali i kursimit të energjisë sipas sektorëve



Në kuadër të këtij plani, në komunën e Rahovecit pritet të arrihet caku i kursimit të energjisë prej 437,840.60 MWh/v. Për më shumë shih diagramin në vazhdim si potencial i kursimit të energjisë sipas sektorëve.

3. INFORMACIONI BAZË PËR KOMUNËN

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione. E këto janë: rrafshi-luginor, kodrinor dhe malor. Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.5 km². Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distance rreth 45 km, në VL me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në JL me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në J me Komunën e Prizrenit 25 km, dhënë P me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km . Në Komunën e Rahovecit temperaturat mesatare vjetore janë 11,680C. Maksimumi absolute paraqitet në muajin Korrik prej 38,50C, ndërsa minimum në muajin shkurt me -14,50C. Reshjet maksimale në Rahovec janë 1.047,2 mm, ndërsa minimale janë 609,9 mm. Mesatarja e reshjeve është 707.7mm. Të reshurat e dëborës janë më të mëdha në Rahovec dhe atë në muajin Janar. Ditë me borë në Rahovec janë mesatarisht 15,7ditë. Rahoveci ka mesataren vjetore me mjegull prej 19. 7 ditë apo 5,4 %. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes : 1.Manastiri i Zoqishtit, Zoqishtë, dhe 2.Fshati Hoçë e Madhe, Hoçë e Madhe.

Sipërfaqja	278 Km ²
Numri i popullsisë rezidente	56,208 banorë

3.1. POZICIONI DHE TOPOGRAFIA

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikroregjione e këto janë: rrafshinë-luginore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës shtrihet në hemisferën veriore të Ekuadorit me shkallë 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjerësisë veriore gjeografike dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë lindore gjeografike. Vendbanimet në komunën e Rahovecit janë të koncentruar në lartësitë mbidetare prej 310 m. (Krusha e Madhe pjesa e re e vendbanimit pjesa lindore të bregut të lumit Drini i Bardhë) deri në 920 m. lartësi mbidetare që është i koncentruar vendbanimi i Zatriqit. Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshinë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshina janë këto : (310 - 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Drinasi, Dejani, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 - 600 m që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë : Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshinave).Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 - 1.000 m. e këto janë : Zatriqi, Kazniku dhe Guri i Kuq

3.2. KLIMA LOKALE

Faktorët më të rëndësishëm të cilët ndikojnë në klimën e kësaj hapësire janë: pozita e përshtatshme gjeografike, largësia e vogël e Rahovecit nga Deti Adriatik (102 km deri te gryka e derdhjes së lumit Drinit të Bardhë në detin Adriatik), lartësia mesatare mbidetare (rreth 308 në luginën e lumit të Drinit të Bardhë te Krusha e Madhe dhe 1.039 në majën e Zatriqit, që do të thotë mesatarja 550 m në tërë sipërfaqen e komunës),barriera e malit të Shkozës, Zatriqit dhe Koznikut, zhvillimi i mirë i botës bimë dhe shtazore (livadhet, kullosat, të mbjellurat dhe pyjet) etj. Klima me tipare të mesme mesdhetare ndihet rreth lumit Drini i Bardhë si dhe në këto vendbanime: Krushë e Madhe, Celinë, Fortesë, Xërxë, Gexhë, Ratkoc dhe Çifllak. Ndikimet vërehen gjithashtu edhe rreth luginave të lumenjve, tarracave liqenore, lumore dhe të cilat kodrat i mbrojnë prej erërave dimrore të veriut, ndërsa këto vendbanime janë: Reti, Apterushë, Hoçë e Madhe, Hoçë e Vogël, Brestoc, Rahovec, Bratotin, Dejnë, Pataqan i Epërm dhe i Ulët. Këto janë edhe pjesët më të ngrohta të Anadrinit.

Klima me ndikim kontinental ndikon në malet e Koznikut, Zatriqit dhe Shkozës.

Pasqyra e shkurtër e të dhënave meteorologjike për komunën e Rahovecit

Në Komunën e Rahovecit temperaturat mesatare vjetore janë 11,68 0C. Maksimumi absolut paraqitet në muajin Korrik prej 38,5 0C, ndërsa minimumi në muajin shkurt me -14,50C.

Reshjet maksimale në Rahovec janë 1.047,2 mm, ndërsa minimale janë 609,9 mm.

Mesatarja e reshjeve është 707.7mm. Të reshurat e dëborës janë më të mëdha në Rahovec

dhe atë në muajin Janar. Ditë me borë në Rahovec janë mesatarisht 15,7 ditë. Rahoveci ka

mesataren vjetore me mjegull prej 19. 7 ditë apo 5,4 %.

3.3. POPULLSIA DHE VENDBANIMET

Regjistrimi i vitit 2011 tregoi se komuna e Rahovecit kishte një popullsi prej 56.208, prej të cilëve 55,166 ishin shqiptarë, 404 ashkali, 299 egjiptianë të Ballkanit, 134 serbë, 10 boshnjakë dhe 2 turq. Komuna e Rahovecit ka këta fshatra:

- Bellacërka (Rahovec)
- Bërnjaku (Rahovec)
- Bratotini
- Brestoci (Rahovec)
- Celina
- Çifllaku (Rahovec)
- Dabidoli
- Dejna
- Drenoci (Rahovec)
- Gexha
- Hoça e Madhe
- Hoça e Vogël
- Kazniku
- Kramoviku
- Krusha e Madhe
- Mrasori
- Nagaci
- Nushpali
- Opterusha
- Pastasella
- Pataçani i Epërm
- Pataçani i Poshtëm

- Petkoviqi
- Polluzha (Rahovec)
- Radosta
- Retia
- Retia e Poshtme
- Sapniqi
- Saroshi
- Senoci
- Vrajkëa
- Xërxa (Rahovec)
- Zatriqi
- Zoqishti

Tabela 8 Lista e popullsisë etnike në komunën e Rahovecit

Përbërja etnike							
Viti/Etnia	Shqiptar	%	Serb	%	Të tjerë	%	Total
1991 regj.	55,119	92	3,938	7	885	1	59,942
Jan-99	52,500	92	4,000	7	800	1	57,300
dhjetor 1999	58,772	89	5,008	8	2116	3	65,896
maj 2001	69,019	97.6	1,350	1.9	350	0.5	70,719
nëntor 2002	71,834	97.7	1,300	1.8	420	0.5	73,554
gusht 2003	72,853	97,1	1300	1,7	849	1,1	75002
Tani (2005)	76,577		1,300përaf.	1,7përaf.	420përaf.	1,1	76,577

3.4. STRUKTURA ADMINISTRATIVE LOKALE DHE AJO ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E VEPRIMIT TË ENERGJISË DHE TË KLIMËS (NECP)

Komuna e Rahovecit funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), Statutit të saj dhe akteve të tjera nënligjore. Ky ligj ka për qëllim ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike në të gjitha komunat në Republikën e Kosovës. Neni 2.1 i këtij ligji përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda-komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e

zbatueshëm. Kuvendi i Komunës së Rahovecit është organi më i lartë në komunë, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale. Kuvendi i Komunës ka 31 anëtarë, miraton Statutin dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme.

Administrata komunale e Komunës së Rahovecit është e organizuar në 12 drejtori, të cilat menaxhohen nga drejtorët komunalë, në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

Administrata komunale është organ i kuvendit komunal dhe implementon vendimet e kuvendit. Administrata Komunale është përgjegjëse për implementimin e të gjitha detyrave ekzekutive të caktuara me statut dhe me aktet e tjera normative.

Shërbimet e Komunës së Rahovecit për qytetarët janë të ndryshme dhe të shumta, duke filluar nga rregullimi i dokumenteve të statusit civil deri në projektet kapitale. Struktura organizative e komunës së Rahovecit është e paraqitur në organogramin, si me poshtë:




Figura 2 Struktura organizative

3.5. TREGUESIT EKONOMIKË DHE FINANCIARË

Komuna e Rahovecit me prodhim të verës dhe token pjellore ka potenciale të mëdha për zhvillime në të ardhmen. Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është i orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perimekulturë. Afro 65% e popullatës është vlerësuar së sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2500 deri 3000 €. Komuna e Rahovecit disponon me rreth 50 % të sipërfaqeve të vreshtave të Kosovës si dhe kapaciteteve përpunuese.

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike, puna në bujqësi, vreshtari dhe verëtari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec, në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.

Sipas shënimeve të Entit Statistikorë, Komuna e Rahovecit disponon me 13600 hektar tokë bujqësore, sipërfaqet e tokës bujqësore të cilat gjenden përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë në lartësi mbidetare prej 310 - 350 m, është tokë me pjellori të lartë në të cilat kultivohen kulturat bujqësore intensive, siç janë perimet (speci, domate, patate, tranguj, shalqiri, karota e tjera) dhe kulturat lavërtarë (gruri, misri). Në tokat kodrinore, në lartësi mbidetare prej 350 - 600 m. gjendet toka e tipit Smonicë ku kultivohen kulturat lavërtare pranverore dhe vjeshtore dhe kulturat shumëvjeçare kullosat. Më kulturat lavërtare vjeshtore mbillen rreth 2.400 hektar, ku kryesisht mbillet gruri. Në bazë të dhënave, rendimenti mesatar i grurit është 3,5 t/ha.

Në komunën e Rahovecit ekziston sistemi i ujitjes me të cilin menaxhon Kompania Regjionale e Ujitjes (KRU)-Radoniqi, me seli në Gjakovë. Me këtë sistem ujiten 2,658.63 hektar tokë të punueshme bujqësore. Sipërfaqja e përgjithshme e vreshtave në komunën e Rahovecit është 2168 Ha, me trend të rritjes.

Sektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjive për ngrohje dhe ftohje, artizanale ,tregti, shërbime etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorrit dhe argjilës.

Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare

duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazuar në ekonomin e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore.

Në komunën e Rahovecit veprojnë 1000 biznese private, dhe veprimtaria e tyre është prodhuese, industriale, shërbyese dhe tregtare. Problemi i nivelit të lartë të papunësisë në nivel të Kosovës, reflektohet edhe në Komunën e Rahovecit.

Tabela 9 Buxheti i Komunës për vitin 2023

Rahoveci	2023
Buxheti total	€ 15,813,281.00
Të hyrat vetanake	€ 1,458,405.00
Grandi qeveritar	€ 14,354,876.00
Grandi i përgjithshëm	€ 6,016,947.00
Grandi për shëndetësi	€ 2,048,600.00
Grandi për Arsim	€ 6,264,176.00
Këshilli i Hoçës së Madhe	€ 15,813,281.00

3.6. RËNDËSIA ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE TË TJERA PËRFSHIRJA E AUTORITETEVE LOKALE

Zhvillimi i planit të eficiencës së energjisë është bazuar në analizën e të dhënave komunale për energjinë, për periudhën 2016-2018 dhe parashikon një periudhë zbatimi nga 2019 deri në 2021. PKVEE ndërlidhet edhe me një numër të dokumenteve tjera si:

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021- në kuadër të këtij dokumenti, Shtylla 4 përfshin: infrastrukturën me 4 masa prioritare, masa 3 - ulja e konsumit të energjisë përmes masave të eficiencës së energjisë.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2021- masa e pestë- Plotësimi i caceve dhe obligimeve për eficiencë të energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë, në kuadër të së cilës theksohet: Kosova është zotuar në përmbushjen e caktit të kursimit prej 9% nga konsumi i gjithmbarshëm i energjisë, cak i vendosur sipas Direktivës 2006/32/EC të BE-së. Gjithashtu ka marrë obligimet për zbatimin e politikave të reja të BE-së që burojnë nga Direktiva Evropiane 2012/27/EC për eficiencën e energjisë.

Programi i Kosovës për Reforma në Ekonomi-masa 2- Ulja e konsumit të energjisë nëpërmjet masave të eficiencës së energjisë - kjo masë synon të kontribuojë në arritjen e caktit të kursimit të energjisë për 9%, nëpërmjet zbatimit të masave të EE dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë në sektorin publik dhe rezidencial, dhe duke vendosur kornizën ligjore për eficiencë të energjisë në sektorin privat. Kjo masë është e ndërlidhur me

rekomandimin e politikave nga Dialogu Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, 23 maj 2017.

Plani Zhvillimor Komunal - Rahovec – Plani zhvillimor është dokument, i hartuar për territorin e komunës për periudhën kohore deri në vitin 2020 dhe jep udhëzime konkrete për veprimet që duhet të ndërmerren në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës së Rahovecit, duke ndikuar në ngritjen e kualitetit social, ekonomik dhe fizik të hapësirës përkatëse.

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2015 -2020- është përgatitur sipas Ligjit për Eficiencën e Energjisë 04 / L-016 dhe paraqet dokumentin e Komunës i cili është përqendruar në adresimin e eficiencës së energjisë në nivelin komunal. Sipas këtij plani, Komuna e Rahovecit i ka vënë vetës si qëllim një kursim prej 27% të konsumit total të energjisë deri në vitin 2020 në stokun e ndërtesave publike dhe ndriçim publik, sektorë nën menaxhimin e drejtpërdrejt të Komunës, dhe ky plan, i pari i llojit të vet për komunën e Rahovecit, ka shërbye si udhëzues për arritjen e këtij qëllimi. Gjithashtu, ky plan adreson konsumin energjetik në stokun e ndërtesave dhe ndriçimin publik në pronësinë dhe nën menaxhimin e Komunës së Rahovecit.

3.7. PËRVOJA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIKASITETIT TË ENERGJISË

Në vitet e fundit, komuna e Rahovecit ka zbatuar një numër të madh të projekteve në fushën e EE. Kjo dëshmon se stafi i komunës ka përvojë mjaft të mirë në zbatimin e masave të EE. Përvoja e tyre lidhet, sidomos në

përgatitjen e TeR/specifikacionit teknik, tenderimit, mbikëqyrjes, monitorimit dhe raportimit lidhur me rezultatet e arritura.

Komuna e Rahovecit e ka të caktuar zyrtarin për energji, mirëpo edhe më tej nuk ka zyre për energji sipas Udhëzimit Administrativ nr. 09/2017, e cila do koordinojë aktivitetet me sektorë të tjerë në proces të realizimit të projekteve. Me krijimin dhe funksionalizimin e sistemit komunal për menaxhimin e energjisë dhe me vendosjen e të dhënave në softuerin SME, zyrtari komunal i energjisë do të ketë më të lehtë menaxhimin e të dhënave nga terreni për ndërtesat publike komunale dhe ndriçimin publik, si dhe në krijimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE). Ky softuer është një mjet i cili do të lehtësojë procesin e planifikimit, monitorimit dhe raportimit lidhur me projektet në fushën e EE.

Tabela 10 Projektet e zbatuara në fushën e EE

Masat kryesore të Eficiencës së Energjisë	Kostoja në (€) nëpër vite		
	2016	2017	2018
• Instalimi i ngrohjes qendrore • Ndërrimi i dritareve dhe izolimi i kulmit • Ndërrimi i dyshemesë • Hidroizolimi dhe termoizolimi i dyshemeve të klasave • Ndërrimi i dritareve dhe masa termoizoluse • Ndërrimi i trupave ndriçues nga ata të natriumit në trupa ndriçues me llamba LED • Ndriçim i ri • Ndërrimi i dritareve nga druri me dritare nga PVC me dy shtresa xhami	194.571,10€	165.779,52€	291.396,70€

3.7.1. AFTËSIA PËR TË ZBATUAR PROJEKTE

Administrata komunale është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha detyrave ekzekutive të caktuara nga statuti dhe aktet e tjera normative komunale. Vendimet merren në Asamblenë komunale. Komuna e Rahovecit ka themeluar Zyrën për Menaxhim të Energjisë që do të shërbejë si koordinatorë me sektorët përkatës varësisht prej sektorin në të cilin realizohet projekti. Me krijimin dhe funksionalizimin e Sistemit komunal për menaxhimin e energjisë dhe me vendosjen e të dhënave në softuerin për menaxhim komunal të energjisë SMKE, Menaxheri komunal i energjisë do të ketë më të lehtë menaxhimin e të dhënave nga terreni për ndërtesat komunale dhe ndriçimin publik, si dhe në krijimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK).

Ky është një mjet lehtësimi për realizimin e projekteve për EE nëpërmjet identifikimit më të lehtë të potencialit të kursimit si dhe përdorimit të këtyre të dhënave me sektorët tjerë relevantë.

4. TREGUESIT E ENERGJISË KOMUNALE (FURNIZIMI DHE PRODHIMI I ENERGJISË KOMUNALE)

4.1. FURNIZIMI ME ENERGJI

Furnizimi me energji elektrike, bëhet përmes linjës Prishtinë 220 kv prej 30.67km (Kosova B-Podujeve) dhe linjës 35kv Mazgit-Rahovec prej 25.88km.

Sa i përket objekteve në pronësi komunale, komuna ka përgjegjësinë për ngrohje, ndriçim dhe pajisje administrative. Sektori i banimit është shumë i rëndësishëm dhe jetësor për komunën, megjithatë komunat nuk kanë përgjegjësi për menaxhimin e energjisë në këto ndërtesa. Kompania për furnizimin e shpërndarjes së energjisë elektrike (KEDS) është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të energjisë elektrike në këtë komunë, megjithatë, konsumi i energjisë dhe shërbimet e tjera të lidhura me energji janë jashtë juridiksionit komunal.

Një sistem i mundshëm i ngrohjes qendrore në qytet do të zvogëlonte dukshëm konsumin e energjisë si në sektorin publike dhe privat në komunë.

Sektori i energjisë elektrike i ekonomive familjare dhe ndërtesave publike është një nga sektorët e rëndësishëm të konsumimit të energjisë në Komunën e Rahovecit . Rëndësia e saj është theksuar nga fakti se konsumon sasi të mëdha të energjisë elektrike dhe lëndës djegëse, e cila ka kontribuar në krizën aktuale të rëndë të energjisë në vend.

Komuna e Rahovecit është një nga rajonet më të ftohta të Kosovës. Të gjitha këto argumente do të thotë se rajoni ka nevojë për konsum më të lartë të energjisë sesa pjesët e tjera të Kosovës, në sektorët e ekonomive familjare dhe publike.

Përdorimi në rritje i pajisjeve elektrike, mungesa e lëndës djegëse të drurit dhe çështje të tjera të lidhura, si qasja dhe çmimet, janë shqetësuese dhe mund të shkaktojnë probleme të mëtejshme në të ardhmen. Situata shkon e përkeqësohet nga prerjet e pakontrolluara të lëndës djegëse në zonat rurale. Kjo ndikon në nivelin dhe strukturën e furnizimit total të energjisë për këtë rajon.

Tani për tani, popullsia në Komunën e Rahovecit ka përdorur më së shumti lëndën djegëse për ngrohjen e hapësirës.

Optimizmi i burimeve për energji, ujë dhe lëndë të tjera të papërpunuara do të ishte e nevojshme me rritjen e konsumit nga konsumatorë individualë dhe kolektivë siç janë komunat. Për administratën e komunave në veçanti, optimizmi i burimeve në fushat e energjisë, ujit, mbeturinave dhe mjedisit do të jetë me rëndësi të madhe.

4.1.1. ELEKTRICITET

4.1.1.1. FURNIZIMI ME ELEKTRICITET

Problemi i furnizimit me energji elektrike në Kosovë e ka gjenezën në shkatërrimin e qëllimshëm të sistemit të energjisë elektrike, në të gjitha elementet e tij, nga regjimi pushtues, veçanërisht në vitet e 90-ta. Që nga viti 1984 nuk ka pasur ndërtime të kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, me përjashtim të disa kapaciteteve të vogla hidrike, por që nuk kanë pasur ndikim në zgjidhjen e problemit të sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Aktualisht shumica e blloqeve të termocentraleve janë në fundin e jetës së tyre teknike. Sikur të kishte pasur një zhvillim në kushte stabile të furnizimit me energji elektrike, praktikisht të gjitha kapacitetet gjeneruese të TC “Kosova A” do të duhej të ishin ose të dekomisionuara ose të rehabilituara (siç ka ndodhur në shumicën e rasteve të ngjashme në vendet e Evropës Jug-Lindore(EJL)).


Me gjithë problemet dhe vështirësitë me të cilat është përballur sistemi i prodhimit të energjisë elektrike, në 15 vitet e fundit ka pasur rritje të vazhdueshme në prodhimin e energjisë elektrike.

Konsumi total i energjisë elektrike për vitin 2022 në territorin e Komunës së Rahovecit për sektorin Publik, Rezident, Afarizëm dhe ndriçim publik është paraqitur.

Tabela 11 Konsumi i energjisë elektrike në Komunën e Rahovecit

Sektori i konsumit	Konsumi i energjisë elektrike (kWh/vite)
Ndërtesa Publike	941,588.29
Ndërtesat Rezidenciale	64,977,968.42
Ndërtesat Komerciale	19,282,537.51
Ndriçim Publik	1,045,012.19
Totali	86,247,106.41

Figura 3 Konsumi i energjisë elektrike në territorin e Komunës së Rahovecit .



4.1.1.2. SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Mbulimi i kërkesave për energji elektrike bëhet nga prodhimi vendor dhe një pjesë nga importi. Prej vitit 2000 deri në vitin 2015 janë shpenzuar 538.25 milionë euro për importin e energjisë elektrike. Në disa raste ka pasur ndërhyrje të Qeverisë për subvencionimin e importit, që nga viti 2012 janë ndërprerë subvencionimet për import.

Pas privatizimit të kompanisë për shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike, kostoja e importit të energjisë elektrike ka rënë ndjeshëm, veç tjerash edhe si pasojë e procedurave më efikase të blerjes së energjisë elektrike. Kapacitetet infrastrukturore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike nuk kanë mundur të përcjellin në masën e duhur rritjen e kërkesës, si pasojë, në radhë të parë, e investimeve të pakta në rrjetin

shpërndarës. Për pasojë sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike është tej ngarkuar vazhdimisht, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit.

Në maj të vitit 2013 sistemi i shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike ka kaluar në pronësi private. Në fund të vitit 2014 ka përfunduar procesi i shthurjes ligjore të OSSH-së nga aktiviteti i furnizimit. Në vitet e fundit, sidomos pas privatizimit të rrjetit të shpërndarjes, janë bërë investime mjaft të mëdha në rrjetin e shpërndarjes (rreth 20 milionë euro në vit) dhe vazhdohet të investohet në projekte të planifikuara nga OSSH-ja.

Rrjeti elektroenergjik në Komunën e Rahovecit është përmirësuar pas përfundimit të projektit për ndërtimin e TS 110/35/10(20)kV i cili ndodhet në dalje të Rahovecit në drejtimin e Xërxës, dhe linja 110 kV nga Theranda në Rahovec. Linja kabllorike 35kV fillon nga TS 110/35/10(20)kV - Rahovec dhe furnizon trafo stacionet ekzistuese: TS 35/10(20)kV - Rahovec dhe TS 35/10(20)kV - Xërxë. Gjithashtu edhe linjat kabllorike të reja nga TS i RI 110/35/10(20) kV deri te 35/10(20) kV kanë ndihmuar në përmirësimin e situatës elektroenergjike.

Pra rrjeti i energjisë elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm në komunën e Rahovecit është mjaft mire i mbuluar, shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, edhe pse në disa pjesë të caktuara të komunës nevojitet shtimi i kapaciteteve, pra transformatorë për përmirësim të mëtejshëm të rrjetit elektrik në komunë. Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetik në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kV në 20 kV. Përveç shtimit të transformatorëve nevojitet edhe përmirësimi i rrjetit elektrik të tensionit 10(20)kV si dhe 0.4kV. Në zonat rurale duhet të bëhet ndërrimi i shtyllave elektrike të drurit me ato të betonit, kurse në zonën e qytetit një pjesë e rrjetit është e përmirësuar me vendosjen e kanaleve nëntokësore të kabllorëve 10(20) kV që lidh nënstacionin elektrik 35kV me nënstacionet 10/0.4 kV.

Zëvendësimi i përçuesve të zhveshur me kablo ajrore në zonat rurale dhe me kablo nëntokësore në zonat urbane gjithashtu duhet të kryhet brenda një periudhe sa më të shkurtër. Rrjeti primarë dhe sekondarë i energjisë elektrike në Komunën e Rahovecit është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Figura 4 Rrjeti i energjisë elektrike

4.1.2. FOSILET DJEGËSE

4.1.2.1. DIESEL

Në bazë të dhënave, derivati i naftës në komunën e Rahovecit nuk përdoret për ngrohje ndërsa për transport të flotës Komunale nafta është shpenzuar me **107,123.50/vit**. Ndërsa konsumi i naftës në sektorin e bujqësisë është **73,000.00 l/vit**.

Tabela 12 Konsumi i naftës sipas sektorëve në komunën e Rahovecit

Sektori	Konsumi i naftës l/Vit
Ndërtesat Komunale	/
Transporti-Flota Komunale	107,123.50
Bujqësi	73,000.00
Gjithsej	180,123.50

4.1.2.2. GASOLINË

Në komunën e Rahovecit nuk është raportuar që ka konsume të Gazolinës

4.1.2.3. NAFTË E RËNDË

Ne komunën e Rahovecit nuk është raportuar që ka konsume të Naftës së Rend.

4.1.2.4. LPG

Ne komunën e Rahovecit nuk është raportuar që ka konsume të LPG

4.1.2.5. QYMYR - LINJIT

Kosova ka rreth 12.5 miliardë ton të linjtit si rezerva gjeologjike, duke vendosur Kosovën në vendin e dytë në Evropë dhe në vendin e pestë në botë me këto rezerva. Linjiti është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon 97% të prodhimit total të energjisë elektrike (TC "Kosova A" dhe TC "Kosova B").

Hulumtimet e para të qymyrit në Kosovë kanë filluar në fillim të shekullit XX, ku është konstatuar se në Kosovë ekzistojnë rezerva të mëdha të qymyrit. Në vitin 1922 fillon shfrytëzimi nëntokësor në minierën e Hadës e më vonë edhe në Babush të Lipjanit. Hulumtimet sistematike gjeologjike të qymyrit në basenin e Kosovës kanë filluar në periudhën kohore 1952-1957. Gjatë kësaj periudhe është bërë përgatitja për kalimin e shfrytëzimit të qymyrit në basenin e Kosovës, nga shfrytëzimi nëntokësor në atë sipërfaqësor duke shqyrtuar mundësitë e shfrytëzimit masiv për nevojat e termocentraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe përpunimin industrial të qymyrit.

Tabela 13 Rezervat e qymyrit në Republikën e Kosovës

Basenet qymyrmbytëse	REZERVAT (t)		
	Gjeologjike	Bilance*	Jo bilance**
Kosovës	10, 091, 000,000	8,772,000,000	1,319,000,000
Dukagjinit	2, 244, 830,000	2,047,700,000	197,130,000
Drenicës (f. Skenderaj)	106, 631,000	73,188,000	33,443,000
Gjithsej	12,442,461,000	10,892,888,000	1,549,573,000

** Rezervat bilance janë ato rezerva ku fuqia kalorike e qymyrit është mbi 5.450 kJ/kg

*** Rezervat jashtë bilance janë ato rezerva ku fuqia kalorike e qymyrit është nën 5.450 kJ/kg




Figura 5 Basenet qymyrmbytëse të Kosovës

Vlen te theksohet se në **bazë të Vendimit të Qeverisë Nr.06/74 të dt.06.11.2018 i ndalohet përdorimi i thëngjillit për ngrohje të objekteve të institucioneve publike**, ne komunën Rahovecit nuk është raportuar konsum i thëngjillit sa i përket sektorit publik.

4.1.3. BIOMASA

Biomasa zakonisht nuk përdoret drejtpërdrejtë si burim energjie për kryerjen e ndonjë procesi por shërben si lëndë e parë për përfitimin e produkteve energjetike respektivisht biolëndëve djegëse të cilat mund të përdoren në fusha të ndryshme. Varësisht nga gjendja agregate, produktet energjetike të fituara nga biomasa mund të ndahen në:

- Lëndë djegëse drusore,
- Biolëndët djegëse të lëngëta,
- Biolëndët djegëse të gazta.

Përfitimi i produkteve energjetike respektivisht biolëndëve djegëse mund të bëhet në bazë të operacioneve mekanike, siç janë: prerja, imtësimi, dendësimi dhe presimi (për prodhimin e lëndëve djegëse drusore), Proceseve biokimike siç janë fermentimi dhe degradimi(shpërbërja) anaerob (për prodhimin e biogazit dhe biodizelit).

Lëndët djegëse drusore janë produkti energjetik që fitohet nga përpunimi i biomasës drusore të fituar nga drunjtë e zakonshëm, nga drunjtë energjetik, nga mbeturinat pyjore ose ato që rezultojnë nga industria e përpunimit të drurit. Lëndët djegëse drusore mund të ndahen në: drunj, zjarri, briket, pelet.

4.1.3.1. DRU ZJARRI

Sa i përket biomase druri në Rahovec përdoret më së shumti dru zjarri me 81% të konsumit të përgjithshëm në ndërtesat komunale duke përfshi edhe energjinë elektrike. Drutë e zjarrit janë burimi më i përdorshëm nga të gjitha burimet e tjera të energjisë. Në sasi të vogël përdoret edhe peleti. Në bazë të dhënave konsumi i peletit rezulton me 152 t/vit duke marrë pjesë me 8% në konsumin e përgjithshëm për ndërtesa komunale.

Në mungesë të hapësirës për deponim dhe tharje të druve, ata përdoren të sapo prerë. Djegia e drurit të sapo prerë, i cili ka përmbajtje të lartë lagështie, ka disa aspekte negative të cilat ndikojnë në parametrat operativë të sistemit të ngrohjes¹:

- **Aspekte teknologjike** - lagështia në dru pakëson temperaturën e procesit të djegies, gjë që bënë kushte të favorshme për formimin e përtërish së karbonizuar. Kjo masë tenton të vendoset në sipërfaqet e shkëmbimit të nxehtësisë, gjë që redukton efikasitetin e bojlerit;
- **Aspektet mjedisore** - ekziston rreziku i lartë i formimit të benzopirenit kancerogjenik në furrë, i cili nëpërmjet ajrit mund të hyjë në sistemin respirator të njeriut. Kjo mund të ndodhë në rastin e mjegullës ose nëse rezervuari është me diametër shumë të madh dhe shkarkimet nuk mund të shpërndahen në shtresat më të larta të atmosferës;
- **Aspekti ekonomik** - gjithë përmbajtja e lagështirës e cila është në dru, duhet të avullohet para se të fillojë procesi i djegies. Për të zhdukur 1 kg ujë, ajo merr rreth 2500 kJ energji të ngrohjes, e cila më pas ka kaluar në mjedis. Për të avulluar lagështinë nga druri, nevojitet energji shtesë e cila është humbje e burimeve.

Prandaj, një nga aspektet që ndikon në masë të madhe në fazën e prodhimit të energjisë së ngrohjes është përcaktimi i kërkesës së kualitetit adekuat për biomasë gjatë procedurës së prokurimit.

Për shembull kriteret minimale për copë druri duhet të jenë;

- përmbajtja e hirit nën 7%;
- përmbajtja e lagështirës nën 12%;
- grimca të imta nën 1%.

Parametri më i rëndësishëm i cilësisë së drurit është përmbajtja e lagështisë. Sa më i ulët është përmbajtja e lagështisë, prodhimi i energjisë për ngrohje do të jetë më i lartë, e që është për shkak të faktit, se më pak energji duhet të harxhohet për të tretur lagështinë e panevojshme. Prandaj është më se e rëndësishme të bëhet zgjidhje adekuate për ruajtjen e drurit. Opsioni i dytë

¹ PVKEE Rahovec 2014-2020

është të sigurohet biomase duke u bërë matja jo me m³ ose t, por me përmbajtjen e saj energjetike MWh / t.

Tabela 14 Vlerat kalorike të drurit

Biomasë	Njësi a	Kj	Kgoe	Toe	Ktoe
Druri (20 % - lagës	m3	6,155,095.80	147.17	1.47E-01	1.47E-04
Druri (40 % - lagës	m3	3,596,585.77	85.9	8.59E-02	8.59E-05
Druri (45 % - lagës	m3	3,507,670.18	83.77	8.38E-02	8.38E-05

4.1.3.2. PELET

Peleti është produkt energjetik që prodhohet në mënyrë të ngjashme me briketin, ka formë afërsisht të njëjtë por dallon për nga dimensionet. Pra, peleti paraqet një lloj briketi por me dimensione dukshëm më të vogla. Diametri i peletit sillet rreth 6-12 mm kurse gjatësi a tij 5-45 mm. Dendësia e peletit të hedhur (grumbullit të peletit duke përfshirë zbrazëtirat) sillet rreth 650 kg/m³, përmbajtja e lagështisë nga 8-10 % kurse nxehtësia e djegies 4.9-5.4 kWh/kg . Pra edhe gjatë djegies së 2 kg peleti, mund të fitohet energji afërsisht e njëjtë me atë që mund të fitohet gjatë djegies së 1 l lënde djegëse diesel.

Peleti përdoret në sasi të vogël. Është burimi me përqindje më të vogël përdorimi nga burimet tjera të energjisë në komunën e Rahovecit , në sektorin publik përdoret rreth 10% .

4.2. GJENERIMI I ENERGJISË

Në përgjithësi, gjenerimi i energjisë është procesi i prodhimit të energjisë nga burime të ndryshme siç janë burimet e ngrohtësisë, uji, era, dielli, dhe burimet e tjera të energjisë. Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar furnizimin e energjisë për të mbuluar nevojat tona të ndryshme, si për të prodhuar energji elektrike, të ngritim ngrohtësi, dhe për të ushqyer industrinë dhe transportin.

Burimet e energjisë mund të jenë të përjetshme (si dielli dhe era) ose të pakënaqshme (si nafta dhe gazet natyror), dhe ndryshojnë nga një vend në tjetrin në varësi të burimeve natyrore të disponueshme. Këto burime përdoren pastaj për të prodhuar energji elektrike përmes teknologjive të ndryshme si turbina, panelë diellorë, anije diellore, etj.

Gjenerimi i energjisë është një aspekt kyç i infrastrukturës së një vendi dhe zhvillimit ekonomik, dhe është në qendër të diskutimeve mbi trajtën e burimeve të energjisë dhe impaktin mjedisor. Një qasje e qëndrueshme ndaj gjenerimit të energjisë përfshin përdorimin e burimeve të përjetshme dhe teknologjive të pastër për të zvogëluar ndikimin negativ mbi mjedisin.

Në komunën e Rahovecit nuk ekzistojnë centrale të cilat prodhojnë energji elektrike .

Përndryshe ,sipas informacionit nuk ka ndonjë kapacitet tjetër nga BRE për tu konsideruar.

4.2.1. NGA BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË (HEC, PV DIELLORE, TERMIKE DIELLORE, POMPË NXEHTËSIE, ERË, GJEOTERMALE)

Energjia nga burime të Ripërtëritshme i takon të ardhmes. Shumë të rralla janë rastet kur në shtëpi individuale instalohen panelet solare që përdoren për ngrohje qendrore si dhe ngrohje të ujit sanitar. Në auditimet e bëra, sidomos në shkolla rekomandohen si masë për kursim të energjisë për ngrohje. Po ashtu edhe nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare Panelet solare do të ndikojnë në reduktimin e përdorimit të energjisë elektrike ose të burimeve tjera më pak të pastra për ngrohje.

Komuna e Rahovecit tani është në fazën e zbatimit të një projekti me Fotovoltaik në ndërtim publike me rreth 260kWh kapacitet instalues.

4.2.2. NGROHJA QENDRORE

Komuna e Rahovecit nuk ka sistem qendror për ngrohje në nivel të qytetit. Ngrohja në ndërtesat komunale si edhe në ndërtesat private është individuale ose qendrore në nivel të ndërtesës.

4.3. PRODHIMI I ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

4.3.1. PRODHIMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E NDËRTIMIT (BANESA, NDËRTESA PUBLIKE)

Në sektorin rezidencial të komunës së Rahovecit nuk ekzistojnë centrale (impiante) të cilat prodhojnë energji elektrike, mund të ketë gjeneratorë të cilët shfrytëzojnë karburantet e lëngëta për prodhimin e energjisë elektrike. Këta gjeneratorë kryesisht përdoren në kohën kur ka mungesë të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi publik.

Gjithashtu, në sektorin rezidencial, ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar.

5. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Burimi i të dhënave relevante për analizën e konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave të Komunës së Rahovecit janë të mbledhura nga burimet e mëposhtme:

- Zyrtarët e Komunës,
- Agjencia e Statistikave të Kosovës: "Banesat dhe ndërtesat sipas komunave" 2013
- Banka Botërore: "Studimi Nacional për Eficiencën e Energjisë në ndërtesa për Kosovën" 2013
- Shpërndarja Elektrike në Kosovë dhe Kompania e Furnizimit (KEDS): Të dhënat mbi Konsumin e Energjisë Elektrike për vitin 2019
- Banka Botërore: "Studimi i sektorit energjetik të ngrohjes në Kosovë" 2007
- EPTISA: "Konsumi mesatar i energjisë për m² të amvisërive"
- PKEE 2014-2020
- Plan i veprimit për energji të qëndrueshme për komunën e Rahovecit (PVKEQ)
- Ueb faqja e Komunës
- PVKEE Komuna e Rahovec 2019-2021

Për nevojat e analizës së konsumit të energjisë, sektori i ndërtesave në Komunën e Rahovecit është i ndarë në nën sektorët e mëposhtme:

- Ndërtesat në pronësi të komunës dhe të kompanive publike;

- Ndërtesat e banimit (amvisëritë);
- Ndërtesat komerciale dhe të shërbimeve

Në bazë të dhënave të mbledhura, për të gjithë nënsektorët e sektorit të ndërtesave në Komunën e Rahovecit janë dhënë parametrat e mëposhtëm:

- Informacionet e përgjithshme për nënsektorin;
- Sipërfaqja totale e nënsektorit (m²);
- Numri i ndërtesave në nënsektor;
- Konsumi total i energjisë elektrike në nënsektor (kWh);
- Konsumi specifik i energjisë elektrike në nënsektor (kWh/m²);
- Konsumi i energjisë elektrike për ngrohje në nënsektor (kWh);
- Konsumi i druve të zjarrit për ngrohje në nënsektor (kWh)
- Konsumi i naftës për ngrohje në nënsektor (kWh)
- Konsumi i gazit për ngrohje në nënsektor (kWh)
- Konsumi i linjitit për ngrohje në nënsektor (kWh)
- Konsumi specifik i energjisë për nevoja tjera nga ato të ngrohjes (kWh/m²)
- Konsumi specifik i energjisë për ngrohje (kWh/m²)

5.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESA

Të dhënat e nevojshme lidhur me konsumin e energjisë në të gjitha ndërtesat e komunës së Rahovecit janë siguruar nga komuna përmes menaxherit për energji dhe nga terreni, me rastin e incizimit që i është bërë secilit objekt. Përgjatë incizimit të secilit objekt janë bërë matjet e duhura si dhe janë intervistuar personat përgjegjës për të marrë të dhënat e nevojshme për analizën e konsumit dhe nevojave energjetike të objektit përkatës. Janë dy sektorë të cilët janë analizuar në mënyrë të detajuar: sektori i ndërtesave dhe i ndriçimit të rrugëve.

- Analiza e mëtejshme përfshinë:
- Sektorin e ndërtesave publike komunale;
- Sektorin e ndriçimit të rrugëve dhe
- Flotën komunale.

Tabela 15 Konsumi i energjisë elektrike dhe termike në të gjitha sektorët

Nësektori	Sipërfaqja totale e dyshemesë së ngrohur (m ²)	Konsumi i energjisë termike (kwh)	Konsumi i energjisë elektrike (kwh)	Konsumi total i energjisë (kwh)
Ndërtesat komunale				
Institucionet arsimore	33,109.20	3,264,029.12	268,608.64	3,532,637.76
Ndërtesat shëndetësore	4,538.00	508,797.00	372,125.47	880,922.47
Ndërtesat administrative	2,757.00	134,593.92	300,854.18	435,448.10
Ndërtesat kulturore	5,865.00	53,131.53		53,131.53
Totali	46,269.20	3,960,551.57	941,588.29	4,902,139.86
Ndërtesa rezidenciale	2,435,933.00		69,755,725.72	69,755,725.72
Ndërtesat komerciale	597,283.00		20,868,048.34	20,868,048.34
Totali	3,079,485.20	3,960,551.57	91,565,362.35	95,525,913.92

5.1.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTHESAT E BANIMIT

Te dhënat na vazhdim janë marrë ne konsideratë vetëm për vitin 2022 si vit bazë ne stabilitet te konsumit te energjisë për shkak te pandemisë, masat e marra për vitin 2020 dhe 2021. Te dhënat e zyrës se tatimit ne pronë del te jene 15,866.0 ekonomi familjare. Konsumi i energjisë elektrike për vitin 2022 është 69,755.73 MWh/vit te dhënat e KEDS-se.

Tabela 16 Konsumi i energjisë për ngrohje

Lloji i konsumit	Vlera	Njësia	Pjesëmarrja
Konsumi total për ngrohje	510,914,695	kWh/vit	%
Konsumi total për ngrohje, me energji elektrike	16,289,104	kWh/vit	3.2%
Konsumi për ngrohje me dru dhe pelet (lëndët tjera për ngrohje konsiderohet nuk janë përdorur)	494,625,591	kWh/vit	96.8%



Figura 6 Konsumi i energjisë elektrike i shprehur ne %

5.1.2. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT NË PRONËSI KOMUNALE

Ndërtesat në pronësi të Komunës kanë nënndarje si mëposhtme:

- Administrata
- Arsimi
- Shëndetësia
- Kultura dhe Sporti

Ndarjet e tilla nëpër kategori janë bërë në mënyrë që të mund të këtë një pasqyrë me të mirë dhe më të saktë të konsumit aktual të energjisë në ndërtesat.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara, Nën-seksionet e ndërtesave komunale kanë treguar parametrat si më në vazhdim:

- Informacione të përgjithshme në lidhje me nën-sektorët;
- Sipërfaqja e përgjithshme e nën-sektorit (m²);
- Numri i ndërtesave për nën-sektorit;

- Konsumi i përgjithshëm i energjisë termike dhe elektrike për nën-sektor (kWh);
- Konsumi specifik i energjisë termike dhe elektrike për nën-sektor (kWh/m²);
- Konsumi total i karburantit

Duhet theksuar se të gjitha të dhënat e dhëna mbi analizën e konsumit të energjisë dhe të mbledhura nga departamenti përkatës administrativ, janë krejtësisht të sakta dhe plotësisht të besueshme.

Bazuar në analizën e kryer të të dhënave, ka rezultuar një konkluzion shumë i rëndësishëm ku janë intervistuar (menaxherët e ndërtesës së shëndetësisë) mendojnë se renovimi i termoizolimit në ndërtesat e tyre dhe standardet e reja energjetike të ndërtimit do të ndihmojnë kursimin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Analiza e të dhënave për konsum specifik të energjisë të ndërtesave tregon se konsumi i energjisë i raportuar me nivel më të lartë është në nën sektorin e Arsimit pasuar nga ndërtesat e Administratës. Ndërtesat e Kulturës e sportit janë me konsum të ulët.

5.1.2.1. NDËRTESAT ADMINISTRATIVE

Ndërtesat të cilat përfshihen tek nën sektori i administratës janë: ndërtesat komunale që ofrojnë shërbime për qytetarët, ndërtesat komunale për administratën lokale, zjarrfikësit, zyrat e komunitetit etj.


Ndërtesa që u shërbejnë qytetarëve dhe komunale për administratën lokale janë 9 ndërtesa me sipërfaqe që ngrohet 2,757.00m² me konsum total të energjisë 454.99MWh/vite dhe me energji specifike për ngrohje 76.28 kWh/m²

Tabela 17 Konsumi i energjisë në ndërtesat administrative

Nr.	Emri i ndërtesës	Sipërfaqes që ngrohet	Konsumi i energjisë elektrike (kwh)	Konsumi i energjisë termike (kwh)	Konsumi total (kwh)	Konsumi specifik i energjisë ë
		m ²	kWh/vite	kWh/vite	kWh/vite	kwh/m ²

1	Zyra e vendit Drenoc	20.00	482.60	7,569.00	8,051.60	71.13
2	Zyra e vendit Xërxë	25.00	2,087.00	7,621.20	9,708.20	78.19
3	Zyra e vendit Ratkoc	25.00	1,301.00	7,830.00	9,131.00	47.09
4	Zyra e vendit Hoçë e Vogël	20.00	1,916.00	7,830.00	9,746.00	86.10
5	Zyra e vendit Opterushë	20.00	1,933.00	7,830.00	9,763.00	86.25
6	Zyra e vendit Hoçë e madhe	32.00	15,213.00	7,830.00	23,043.00	58.34
7	Komuna objekti i ri	1,895.00	78,243.39	126,402.79	204,646.18	67.37
8	Komuna objekti i vjetër	700.00	31,697.93	120,372.19	152,070.12	113.80
9	Zyra e vendit Çifllak	20.00	1,720.00	7,569.00	9,289.00	93.89
	Gjithsej	2,757.00	134,593.92	300,854.18	435,448.10	702.13

Figura 7 Konsumi i specifik i energjisë në ndërtesat administrative



5.1.2.2. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTE SAT E ARSIMIT

Në total janë 35 ndërtesa që janë nën përgjegjësinë e drejtorisë së arsimit. Shumica e këtyre shkollave kanë sistem të ngrohjes qendrorë; prej tyre 41 shkolla kanë kaldaja me ngrohje qendrore, 36 kaldaja me dru, 9 kaldaja me pelet dhe vetëm 13 shkolla ngrohen me stufa individuale me dru.

Vlen të theksohet se nga gjithsej 35 shkolla 14 shkolla kanë konsum specifik më të ulët se 80 kwh/m²* vit dhe si të tilla nuk japin potencial për kursim të energjisë. Arsyet për këtë konsum specifik të ulët janë të ndryshme, filluar nga pandemia, kur dihet se në kohën e pikut ka pasur ndërprerje të procesit mësimor, zbatimin e masave të EE, reduktimi i hapësirave ngrohëse për arsye të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe mos furnizimit të rregullt.

Tabela 18 Konsumi i energjisë në ndërtesat e arsimit

Nr .	Emri i ndërtesës	Sipërfaqja e përgjithshme	Konsumi i energjisë elektrike (kwh)	Konsumi i energjisë termike (kwh)	Konsumi total (kwh)	Konsumi i specifik i energjisë
		m ²	kWh/vite	kWh/vite	kWh/vite	kwh/m ²
1	SHFMU "Milaim Krasniqi"-Kaznik	87.48	4,320.36	15,660.00	19,980.36	228.40
2	SHML "SERBE"	680.82	8,644.91	67,041.67	75,686.58	111.17
3	SHFMU "31 Marsi"-Guri i kuq	586.26	3,493.73	58,980.33	62,474.06	106.56
4	SHML "Ukshin Hoti"-Krushë e madhe	1,721.10	8,213.45	159,249.33	167,462.78	97.30
5	SHFMU "Rudolf Walther"-Dobidol	404.30	6,927.64	31,320.00	38,247.64	94.60
6	SHFMU "SADEDIN HAJDA"-Rahovec	794.34	909.55	75,388.00	76,297.55	96.05
7	SHFMU "Liria" -Fortesë	1,087.00	4,410.09	108,169.67	112,579.76	103.57
8	SHFMU "Rilindja" - Çollak	1,392.00	3,570.91	59,508.00	63,078.91	45.32
9	SHFMU "Haki Stërmilli" - Retije e Poshtme	162.86	5,050.36	19,314.00	24,364.36	149.60
10	SHFMU "Sakip Bellaqa" - Pataqan i Epërm	393.93	2,476.09	56,006.33	58,482.42	148.46
11	SHFMU "GËZIM HAMZA-PIKTORI"-Rahovec	1,496.00	11,878.82	105,579.33	117,458.15	78.51
12	SHFMU "Haki Stërmilli" - Zoqishtë	325.20	5,050.36	42,112.67	47,163.03	145.03
13	SHFMU "Dëshmorët e Lirisë"-Pataqan i Ulët	920.36	4,207.18	84,558.33	88,765.51	96.45
14	SHFMU "Sylejman Vokshi" - Polluzhë	907.75	1,808.55	61,627.00	63,435.55	69.88
15	SHFMU "Vellezerit Frasheri" -Drenoc	906.60	3,289.00	78,923.50	82,212.50	90.68
16	SHFMU "Mustaf Ibishi" - Mrasor	131.22	2,572.73	15,660.00	18,232.73	138.95
17	SHFMU "Dëshmoret e Zatriqit"- Zatriq	420.78	3,909.09	67,047.33	70,956.42	168.63
18	SHFMU "Hamez Thaqi"-Xerxe	1,197.80	4,980.55	113,796.00	118,776.55	99.16
19	SHFMU "Tre Dëshmoret" - Vrajakë-Bratotin	544.75	5,044.45	72,431.00	77,475.45	142.22
20	SHFMU "Nesim Elshani" - Nagavc	1,358.74	2,766.91	61,003.33	63,770.24	46.93
21	SHFMU "Heronjtë e Kosovës"- Hoçë e Vogël	1,016.90	2,007.55	117,142.33	119,149.88	117.17
22	SHFMU "Lidhja e Prizrenit" - Apterushë	1,678.87	3,470.00	128,917.00	132,387.00	78.85
23	SHFMU "Skender Kastrati" - Radost	697.50	20,409.36	46,980.00	67,389.36	96.62
24	SHFMU "Isa Boletini" - Rahovec	2,620.85	24,799.73	147,322.00	172,121.73	65.67
25	SHFMU "Sfetozar Maroviq" - Hoçë e Madhe	962.70	13,569.00	42,087.24	55,656.24	57.81
26	SHFMU "Sopniqi"-Sapniq	536.04	2,377.27	76,195.00	78,572.27	146.58
27	SHML "12 Maj"-Ratkoc	2,815.40	10,583.18	181,464.00	192,047.18	68.21

28	SHFMU "Katër Deshmoret"-Ratkoc	3,632.40	5,667.55	211,802.00	217,469.55	59.87
29	SHFMU "Faik Konica" - Celine	1,073.51	7,158.64	104,668.00	111,826.64	104.17
30	SHFMU "Bajram Curri" - Krusha e Madhe	1,902.84	10,797.73	96,680.00	107,477.73	56.48
31	Qerdhja e Fëmijëve "Tulipanët" - Rahovec	234.10	14,650.45	59,589.06	74,239.51	317.13
32	SHFMU "Vuk Karaxhiq" - Rahovec	583.10	11,382.45	22,968.00	34,350.45	58.91
33	SHFMU "Bekim Sylka" - Rahovec	2,347.15	14,708.64	127,368.00	142,076.64	60.53
34	SHMLP "Selajdin Mullabazi - Mici" - Rahovec	6,418.45	18,115.91	268,200.67	286,316.58	44.61
35	SHML "Xhelal Hajda-Toni" - Rahovec	4,050.50	15,386.45	279,270.00	294,656.45	72.75
	Totali	46,089.60	268,608.64	3,264,029.12	3,532,637.76	3,662.85




Figura 8 Konsumi specifik i energjisë në sektorin e arsimit

Konsumi energjisë për të gjitha llojet e energjisë primare të përdorur për ngrohje në sektorin e Arsimit. Nga 59 shkolla 3 nga to përdorin naftën për ngrohje

Tabela 19 Konsumi i energjisë në sektorin e Arsimit

Burimi kryesor i energjisë	Konsumi total i energjisë për ngrohje (kwh/vite)
Dru	3,264,029.12
Elektricitet	268,608.64
Totali	3,532,637.76

5.1.2.3. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTE SAT E KUJDESIT SHËNDETËSOR

Komuna e Rahovecit si qeverisje lokale është përgjegjëse vetëm për sistemin e kujdesit shëndetësor parësor, i cili përfshin qendrën kryesore të kujdesit shëndetësor familjar, qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat. Tabela më poshtë tregon tërësinë e këtyre objekteve në komunën e Rahovecit .

Tabela 20 Konsumi i energjisë në ndërtesat e nen sektorit të shëndetësisë

Nr.	Emri i ndërtesës	Sipërfaqe që ngrohet m ²	Konsumi i energjisë elektrike (kwh) kWh/vite	Konsumi i energjisë termike (kwh) kWh/vite	Konsumi total (kwh) kWh/vite	Konsumi specifik i energjisë kwh/m2
1	AMF-Malësi e Vogël	110.00	914.33	3,400.00	4,314.33	27.11
2	AMF - Brestoc	115.00	906.83	5,100.00	6,006.83	34.79
3	QMF - Opterushë	85.00	2,090.67	10,320.00	12,410.67	51.42
4	AMF - Hoçë e Madhe	135.00	4,357.00	15,660.00	20,017.00	107.55
5	QMF - Drenoc	280.00	5,170.30	12,990.00	18,160.30	48.86
6	QMF - Rahovec	98.00	3,872.67	6,800.00	10,672.67	73.30
7	QMF- Çifllak	25.00	4,350.67	15,138.00	19,488.67	170.64
8	AMF - Xërxë	175.00	4,993.67	6,800.00	11,793.67	50.50
9	Ambulanta Shëndetësore - Rahovec	120.00	6,857.00	9,918.00	16,775.00	56.19
10	QMF - Fortesë	220.00	8,631.00	26,450.00	35,081.00	119.38
11	QMF - Krushe e Madhe	400.00	14,339.53	47,610.00	61,949.53	122.58
12	QMF- Ratkoc	510.00	14,572.33	47,610.00	62,182.33	97.74
13	QKMF - Rahovec	2,120.00	291,390.80	275,080.00	566,470.80	209.87
14	QPS - Rahovec	145.00	9,678.67	25,921.00	35,599.67	115.77

				0	7	
	Gjithsej	4,538.00	372,125.47	508,797.00	880,922.47	1,285.70

Bazuar në të dhënat për konsumin e energjisë, këto ndërtesa gjithsej konsumojnë energji 880.92 MWh / vit.

Në vitin 2018 është vënë në funksion edhe reparti i maternitetit i cili ka të përbashkët sistemin e ngrohjes qendrorë me repartet tjera brenda QKMF-së. Sa i përket sistemit të ngrohjes qendrore, 10 ndërtesa kanë kaldaja për ngrohje qendrore. Konsumi specifik i tyre dallon edhe për nga koha e shfrytëzimit të ndërtesës, ngase objektet që ndodhen në zonat rurale kanë kohë të shfrytëzimi ditor më të shkurtër krahasuar me ato të QKMF-ve të cilat shfrytëzohen 24 orë në ditë.




Figura 9 Konsumi i energjisë ne sektorin Shëndetësisë

Konsumi i energjisë ne sektorin Shëndetësisë për të gjitha llojet e energjisë primare të përdorur për ngrohje ne. Nga 23 ndërtesa 3 nga to përdorin naftën për ngrohje dhe 7 përdorin paletën.

Tabela 21 Konsumi total i energjisë për ngrohje

Burimi kryesor i energjisë	Konsumi total i energjisë për ngrohje (kWh/vit)
Dru	508,797.00
Elektricitet	372,125.47
Totali	880,922.47

5.1.2.4. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESET E KULTURËS DHE SPORTIT

Janë vetëm dy ndërtesa të kulturës dhe sportit: Teatri dhe Palestra e sporteve. Tabela poshtë prezanton konsumin e energjisë në këto ndërtesa e që është mjaft i ulët.

Tabela 22 Konsumi i energjisë në ndërtesat për kulturë e sport

N r.	Emri i ndërtesës	Sipërfaqe qe ngrohet m ²	Konsumi i energjisë elektrike (kwh) kWh/vite	Konsumi total (kwh) kWh/vite	Konsumi specifik i energjisë kwh/m2
1	Shtëpia e Kulturës "Muhamet Malesori - Krushë e Madhe	54.00	3,548.67	3,548.67	6.98
2	Bibloteka Sylejman Krasniqi - Rahovec	230.00	18,161.00	18,161.00	29.44
3	Qendra Kulturore "Mensur Zyberaj" - Rahovec	35.00	17,670.87	17,670.87	16.15
4	Shtëpia e Veres -Bernjake	110.00	3,312.33	3,312.33	10.28
5	Shtëpia-muze - Ukshin Hoti Krushë e Madhe	16.00	907.33	907.33	6.70
6	Shtëpia e kulturës - Xërxë	430.00	1,014.67	1,014.67	1.65
7	Palestra Sportive "Mezahir Isma" - Rahovec	4,640.00	2,342.00	2,342.00	0.43
8	Shtëpia e Kulturës "Feim Gashi" - Drenoc	350.00	-	-	-
9	Shtëpia e Kulturës "Jahja Hoti" - Ratkoc	-	271.33	271.33	
10	Stadiumi i qytetit "Jahja Danuza" - Rahovec	-	5,903.33	5,903.33	
	Gjithsej:	5,865.00	53,131.53	53,131.53	71.64

Konsumi i ulët specifik vjen si rezultat i mosngrohjes të kësaj ndërtese gjatë gjithë kohës, sepse nuk ka shfrytëzim të vazhdueshëm dhe masiv.

5.1.2.5. KONSUMI I ENERGJISË NË NDRIÇIMIN PUBLIK TË RRUGËVE

Ndriçimi publik ne Komunën e Rahovecit është shumë i vjetër dhe i mbingarkuar, i cili çon shpesh në defekte të tilla si djegia të transformerëve dhe instalimeve elektrike si dhe trupave ndriçues. Kjo është sidomos e shprehur në zonat ku shtëpitë janë më të dendura. Në vendbanimet me ndërtim të ri, ka një numër të konsiderueshëm të rrugëve që nuk kanë ndriçim rrugor pra nuk ofrojnë komunikim të duhur dhe të sigurt. I gjithë ndriçimi i rrugëve në Rahovec është pronë e vetme e autoriteteve lokale, gjë që ka mundësuar të dhëna të sakta për konsumimin e energjisë.

Komuna e Rahovecit 90% e trupave ndriçues tëni i ka instaluar ndriçues LED duke i zëvendësuar me CFL dhe Na, por sistemi i ndriçimit publik i vendosur LED nuk është kualitet, nga i cili ka vazhdimisht defekte dhe janë rrit shpenzimet në mirëmbajtje, prandaj efienca është 90lm/w deri sa teknologjia e LED është avancuar dhe ka arrit deri në 200lm/w, që do të thotë se nëse zëvendësohet trupat ndriçues LED në LED me efienca të lartë do të ketë kursim deri në 50% por nëse vendoset edhe sistemi i menaxhimit të ndriçimit do të ketë kursim deri në 70%.

Te dhënat e konsumit të energjisë janë vendosur në tabelën në vazhdim.

Tabela 23 Llojet e llambave dhe kapaciteti i instaluar

Lloji i ndriçuesit	Nr. I trupave ndriçues	Fuqia
	[copë]	[W]
<i>Natrium</i>	4	125
<i>Halogen</i>	392	125

<i>CFL</i>	352	65
<i>Zhive</i>	155	125
<i>LED</i>	2803	80
<i>LED</i>	294	65
<i>LED</i>	262	50
<i>LED</i>	11	35
Totali	4,273.00	670.00

5.1.3. KONSUMI I ENERGJISË NË SHËRBIMET PUBLIKE

Te dhënat e siguruar nga Komuna e Rahovecit për ndërmarrjet publike janë siguruar vetëm për ndërtesën e zjarrfikës me sipërfaqe 1063m² me konsum të energjisë elektrike 3.1MWh/vit.

5.1.3.1. KONSUMI I ENERGJISË NË FURNIZIMIN ME UJË DHE SEKTORIN E UJËRAVE TË ZEZA

Me që komuna e Rahovecit përfshin sipërfaqe mjaft të madhe paraqiten pothuajse të gjitha llojet e ujërave. Edhe pse Rahoveci është e pasur me ujëra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë furnizimi me ujë bëhet nga Kompania Rajonale Ujësjetësi “Prishtina”. Komuna e Rahovecit nuk posedon me të dhëna për konsum të energjisë për furnizim me ujë si edhe për sektorin e ujërave të zeza.

Megjithatë shkarkimi i ujërave të zeza prej amvisërisë, bizneseve dhe industrisë, jo vetëm në këtë komunë paraqet problem serioz. Teknologjia e shtrenjtë për trajtim të ujërave të zeza ka ndikuar që edhe me këto pakë veprimtari industriale e biznese tjera të kemi probleme serioze në degradimin e natyrës e sidomos të ujërave. Në komunën e Rahovecit operojnë 2921 biznese aktive me veprimtari të ndryshme që shkarkojnë ujërat e zeza të pa trajtuara në shtratin e lumenjve. Në bazë të dhënave komunale në Rahovec janë 78 vendbanime me 12,315 shtëpi banimi, ku jetojnë 122,179 banorë, ndërsa as një nga këto objekte banimi nuk i trajton ujërat e zeza. Të gjitha këto familje me sasi të ndryshme përdorin mjete për mirëmbajtjen e higjienës (acide, sapun, shampo etj) për amvisëri dhe shkarkimi i tyre është i drejtpërdrejt në lumenj.

5.1.3.2. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E MBLEDHJES SË MBETURINAVE

Mbledhja e mbeturinave në Komunën e Rahovecit , sikur edhe furnizimi me ujë dhe menaxhimi i sektorit të ujërave të zeza bëhet nga një Kompani Rajonale edhe atë “Pastrimi”. Andaj edhe për këtë sektorë Komuna e Rahovecit nuk ka prezantuar të dhëna për konsum të energjisë.

5.2. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E BUJQËSISË

Komuna e Rahovecit është komunë kryesisht rurale pasi mbi 70% e popullsisë jetojnë në zonat rurale. Komuna e Rahovecit ka resurse të konsiderueshme që mundësojnë zhvillimin e bujqësisë. Komuna e Rahovecit ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore.

Informata mbi konsumin e energjisë për këtë sektor mungojnë derisa vetëm për korrje-shirat në Komunën e Rahovecit kanë operuar 100 kombajna. Mjetet motorike për punët në bujqësi janë kryesisht të vjetra sikur edhe automjetet andaj subvencionimi i mjeteve motorike eficiencë do të kontribuonte në uljen e konsumit të energjisë si dhe uljen e ndotjes së ajrit.

Pasi bujqësia ka qenë gjithmonë degë e rëndësishme e ekonomisë së komunës së Rahovecit, vërehet se ende ka interesim për t`u angazhuar në këtë veprimtari, edhe sipas kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare dhe prodhues të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

4. Informimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve: Është e rëndësishme të edukohen qytetarët dhe të ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të energjisë në mënyrë të qëndrueshme.

Komunitetet komunale mund të organizojnë fushata të ndërgjegjësimit publik, trajnime dhe ofrimin e informacionit në lidhje me praktikat e përdorimit të energjisë së qëndrueshme dhe përfitimet që sjell ky lloj përdorimi.

Për të arritur një menaxhim të suksesshëm të energjisë në nivel komunal, është e rëndësishme të ketë bashkëpunim dhe koordinim midis autoriteteve komunale, kompanive lokale të energjisë, organizatave joqeveritare dhe qytetarëve. Politikat dhe masat e ndërmarra duhet të jenë të përshtatshme për karakteristikat dhe nevojat e specifika të komunitetit në fjalë.

10.3.2 RAPORTIMI TE QEVERIA QENDRORE AKEE

Për të raportuar masat e eficiencës së energjisë në nivelin e komunave në krahasim me qendrën, është e rëndësishme të ketë një qasje standarde për të matur dhe raportuar të dhënat. Ky koordinim do të mundësohet/lehtësohet përmes emërimit të zyrtarëve përgjegjës për menaxhim të energjisë bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 09/2017, dhe formimin e zyra komunale të energjisë.

Për të bërë një raport të masave të eficiencës së energjisë në nivelin e komunave, mund të ndiqni hapat e mëposhtëm:

1. Identifikoni masat e eficiencës së energjisë që dëshironi të raportoni për secilën komunë. Këto masa mund të përfshijnë:
 - Konsumin e energjisë elektrike në ndërtesa publike dhe private.
 - Shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë (solar, era, hidro, etj.).
2. Për secilën masë të eficiencës së energjisë, vendosni një sistem për të matur dhe monitoruar të dhënat. Ky sistem mund të përfshijë partneritetin me kompanitë e energjisë, monitorimin e konsumit të energjisë dhe vlerësimin e eficiencës së ndërtesave në komunë.
3. Përpiloni një raport periodik të masave të eficiencës së energjisë për secilën komunë. Kjo mund të bëhet në formë të tabelave ose grafikëve që tregojnë zhvillimin e masave të energjisë në një periudhë kohore të caktuar.
4. Në nivelin qendror, konsolidoni raportet nga të gjitha komunat dhe hartoni një raport të përgjithshëm të masave të eficiencës së energjisë për të gjithë vendin. Kjo do të ofrojë një panoramë më të gjerë të situatës së energjisë dhe do të ndihmojë në identifikimin e zonave me potencial të lartë për përmirësimin e eficiencës së energjisë.

11. MODELI DHE BURIMET E FINANCIMIT TË ZBATIMIT TË MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË - SECAP DHE MEEAP

Komunat kanë mundësi të financojnë masat dhe aktivitetet e propozuara sipas planit nga të ardhurat e veta, në formën e granteve nga niveli i qeverisë qendrore dhe përmes mekanizmave të huamarrjes, donatorëve dhe granteve përmes instrumenteve të ndryshme financiare ndërkombëtare.

11.1 FINANCIMI ME BUXHETIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet mjetet e financimit të projekteve me buxhetin e komunës.

Buxheti i Komunës zakonisht përbëhet nga të hyrat vetjake, grantet qeveritare dhe potencialisht huamarrja nga bankat komerciale.

Buxheti i përgjithshëm komunal zakonisht mbledhet nga burimet e mëposhtme:

- Taksat dhe tatimet komunale, lejet e ndërtesave/lejet e ndërtimit;
- Taksat komunale, licencat dhe lejet, certifikatat dhe dokumentet e tjera zyrtare, taksat e automjeteve, etj
- Taksat dhe tarifat komunale për aktivitetet ekonomike të biznesit të vogël, të ardhurat nga qiraja, restorantet, kafenetë dhe shërbimet e tjera;
- Taksat dhe detyrimet e tjera të parashikuara me ligj.

11.2 FINANCIMI NGA BUXHETI I QEVERISË QENDRORE

Instrumentet kryesore për financimin e projekteve nga buxheti i qeverisë janë si më poshtë:

- Huamarrja dhe Angazhimet Komunale (Huamarrja Komunale dhe Angazhimet Afatgjata)
- Instrumentet financiare kombëtare - Transfertat qeveritare
- Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

11.3 FINANCIMI NGA DONATORËT

Disa nga donatorët potencialë nga të cilët mund të kërkohet financimi i projektit janë:

- Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor- WBIF
- Lehtësimi i financimit të drejtpërdrejtë të energjisë nga Ballkani Perëndimor (WeBSEDF);
- GIZ - Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore (ORF)
- Banka Evropiane e Investimeve (EIB)
- Banka Gjermane për Rindërtim (KfW)

- Banka Botërore
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
- USAID,
- Millennium Foundation Kosova (MFK)
- Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë etj.
-

11.4 FINANCIMI NGA BE-SË

Disa nga donatorët potencialë nga të cilët mund të kërkohet financimi i projektit janë:

- Fondet IPA (Instrumentet për Ndihmën e Paraanëtarësimit), janë mjetet me të cilat BE mbështet vendet partnere me ndihmë financiare dhe teknike
- TAIEK (Ndihma Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit) është një instrument i BE-së që ndihmon vendet partnere të familjarizohen me ligjet e BE-së, t'i zbatojnë dhe t'i jetësojnë ato, si dhe të monitorojnë përparimin e tyre. TAIEK financon ndihmë teknike afatshkurtër nga kolegët përmes këshillimit dhe trajnimit, kryesisht në 3 mënyra:
 - punëtori të ndjekura nga zyrtarë të administratave përfituese;
 - misione ekspertësh që japin këshilla të hollësishme për administratat përfituese;
 - vizita studimore në administratat e vendeve të BE-së.

12. PËRMBYLLJE

Qëllimi kryesor i Planit të Energjisë dhe Klimës të Komunës është identifikimi i masave të mundshme për zvogëlimin e konsumit të energjisë në nivel komunal, zvogëlimin e emetimit të CO₂ për të përmbushur objektivat kombëtare, si dhe zbatimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Sektorët e konsumit të menjëhershëm të energjisë në nivel komunal, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian, përfshijnë: ndërtesat, transportin dhe ndriçimin publik. Analizat e detajuara të energjisë përkatëse dhe Inventarit të Emisioneve Bazë (IEB) për vitin 2019, janë zhvilluar për secilin sektor. Për më tepër, IEB i Komunës së Rahovecit është bërë në përputhje me Protokollin e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimin e Klimës (PPNNK).

Në mënyrë që të kryhet analiza e detajuar e energjisë, sektori i ndërtesave është ndarë në tri nënsektorët e mëposhtme:

- Ndërtesat në pronësi të Komunës së Rahovecit ;
- Objektet e banimit (amvisëritë);
- Objektet komerciale dhe të shërbimeve në Rahovecit .

Sektori i transportit ka tre nënsektorë:

- Autoparku në pronësi të Komunës së Rahovecit ;
- Transporti publik në Komunë;
- Automjetet personale dhe komerciale.

Sektori ndriçimi publik nuk ka nënsektorë.

Sektori	Kursimet i energjisë	Investime për tri vite [EUR]	Reduktimi i
	[MWh/ vit]		[tCO ₂ vit]
Politika komunale, promovim	/	150,000.00	/
Ndërtesat komunale	4,902.14	2,039,170.50	569.48
Ndriçim publik	418.00	2,800,000.00	896.62
Banimit	153,274.41	31,179,942.40	11,632.56
Komercial	35,761.41	8,123,048.80	1,827.74
Transporti	243,484.64	260,000.00	66,227.82
Gjithsej	437,840.60	44,552,161.70	81,154.22

13. REFERENCA

Referencat përkatëse për mbledhjen e të dhënave dhe përfundimin e raportit që do të paraqiten në këtë kapitull:

- Zyrtarët e Komunës,
- Agjencia e Statistikave të Kosovës: "Banesat dhe ndërtesat sipas komunave" 2013
- Banka Botërore: "Studimi Nacional për Eficiencën e Energjisë në ndërtesa për Kosovën" 2013
- Shpërndarja Elektrike në Kosovë dhe Kompania e Furnizimit (KEDS): Të dhënat mbi Konsumin e Energjisë Elektrike për vitin 2019
- Banka Botërore: " Studimi i sektorit energjetik të ngrohjes në Kosovë" 2007
- EPTISA: "Konsumi mesatar i energjisë për m² të amvisërive"
- PKEE 2014-2020
- Ueb faqja e Komunës
- PVKEE Komuna e Rahovec 2019-2021
- Plani Zhvillimor i Komunës
- Plani Kombëtar për Eficiencë të Energjisë
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2020-2024
- Ueb ME

- Ueb ASK
- Burimi i të dhënave : 1. Drejtorati për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural ,
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024
- Agjencioni i Statistikave të Kosovës - ASK(Regjistrimi i Bujqësisë 2014)
- Doracaku i statistikave Bujqësore Komunale 2004 .

14. SHTOJCAT -

Lista e ndërtesave publike me konsumin e energjisë në situatën aktuale dhe me potencialin e kursimit të energjisë, përfshi tregues të ndryshëm.

Objekti të ndahet sipas sektorëve dhe i ranguar sipas konsumit të energjisë.

Tabela 42 Konsumi i energjisë dhe potenciali i kursimit në ndërtesat të cilat kanë nevojë për intervenim në sektorin e arsimit .

N r.	Emri i ndërtesës	Sipërfaqja e përgjithshme	Konsumi total (kwh)	Konsumi specifik i energjisë	Potenciali i kursimit specifik	Potenciali I kursimit	Investimet 2023-2025
		m ²	kWh/vite	kwh/m2	kwh/m2	kwh/vite	Euro (€)
1	SHFMU "Milaim Krasniqi"-Kaznik	87.48	19,980.36	228.40	148.40	12,981.96	€ 7,873.20
2	SHML "SERBE"	680.82	75,686.58	111.17	31.17	21,220.98	€ 61,273.80
3	SHFMU "31	586.26	62,474.06	106.56	26.56	15,573.26	€

	Marsi"-Guri i kuq						52,763.40
4	SHML "Ukshin Hoti"-Krushë e madhe	1,721.10	167,462.78	97.30	17.30	29,774.78	€ 154,899.00
5	SHFMU "Rudolf Walter"-Dobidol	404.30	38,247.64	94.60	14.60	5,903.64	€ 36,387.00
6	SHFMU "SADEDIN HAJDA"-Rahovec	794.34	76,297.55	96.05	16.05	12,750.35	€ 71,490.60
7	SHFMU "Liria" - Fortesë	1,087.00	112,579.76	103.57	23.57	25,619.76	€ 97,830.00
8	SHFMU "Haki Stërmilli" - Retije e Poshtme	162.86	24,364.36	149.60	69.60	11,335.56	€ 14,657.40
9	SHFMU "Sakip Bellaqa" - Pataqan i Epërm	393.93	58,482.42	148.46	68.46	26,968.02	€ 35,453.70
10	SHFMU "Haki Stërmilli" - Zoqishtë	325.20	47,163.03	145.03	65.03	21,147.03	€ 29,268.00
11	SHFMU "Dëshmorët e Lirisë"-Pataqan i Ulët	920.36	88,765.51	96.45	16.45	15,136.71	€ 82,832.40
12	SHFMU "Vëllezërit Frashëri" - Drenoc	906.60	82,212.50	90.68	10.68	9,684.50	€ 81,594.00
13	SHFMU "Mustaf Ibishi" - Mrasor	131.22	18,232.73	138.95	58.95	7,735.13	€ 11,809.80
14	SHFMU "Dëshmorët e Zatriqit"-Zatriq	420.78	70,956.42	168.63	88.63	37,294.02	€ 37,870.20
15	SHFMU "Hamëz Thaqi"- Xërxë	1,197.80	118,776.55	99.16	19.16	22,952.55	€ 107,802.00
16	SHFMU "Tre Dëshmoret" - Vrajakë-Bratotin	544.75	77,475.45	142.22	62.22	33,895.45	€ 49,027.50
17	SHFMU "Heronjtë e Kosovës"-Hoçë e Vogël	1,016.90	119,149.88	117.17	37.17	37,797.88	€ 91,521.00
18	SHFMU "Skender Kastrati" - Malësi e Vogël	697.50	67,389.36	96.62	16.62	11,589.36	€ 62,775.00

19	SHFMU "Sopniqi"-Sapniq	536.04	78,572.27	146.58	66.58	35,689.07	€ 48,243.60
20	SHFMU "Faik Konica" - Celinë	1,073.51	111,826.64	104.17	24.17	25,945.84	€ 96,615.90
21	Çerdhja e Fëmijëve "Tulipanët" - Rahovec	234.10	74,239.51	317.13	237.13	55,511.51	€ 21,069.00
		13,922.85	1,590,335.37	2,798.50	1,118.50	476,507.37	1,253,056.50

Tabela 43 Konsumi i energjisë dhe potenciali i kursimit në ndërtesat të cilat kanë nevojë për intervenim në sektorin e shëndetësisë.

Nr.	Emri i ndërtesës	Sipërfaqja e përgjithshme	Konsumi total (kWh)	Konsumi specifik i energjisë	Potenciali i kursimit specifik	Potenciali I kursimit	Investimet 2023-2025
		m ²	kWh/vite	kWh/m ²	kWh/m ²	kWh/vite	Euro (€)
1	AMF - Hoçë e Madhe	186.12	20,017.00	107.55	27.55	5,127.40	€ 16,750.80
2	QMF- Çifllak	114.21	19,488.67	170.64	90.64	10,351.87	€ 10,278.90
3	QMF - Fortesë	293.85	35,081.00	119.38	39.38	11,573.00	€ 26,446.50
4	QMF - Krushë e Madhe	505.40	61,949.53	122.58	42.58	21,517.53	€ 45,486.00
5	QMF- Ratkoc	636.20	62,182.33	97.74	17.74	11,286.33	€ 57,258.00
6	QKMF - Rahovec	2,699.10	566,470.80	209.87	129.87	350,542.80	€ 242,919.00
7	QPS - Rahovec	307.50	35,599.67	115.77	35.77	10,999.67	€ 27,675.00
	Gjithsej	6,364.91	880,922.47	1,285.70	165.70	371,729.67	€ 572,841.90

Tabela 44 Konsumi i energjisë dhe potenciali i kursimit në ndërtesat të cilat kanë nevojë për intervenim në sektorin e administratës.

Nr.	Emri i institucionit	Sipërfaqe që ngrohet	Konsumi specifik	Konsumi energjisë	Kursimi specifik mesatar I energjisë kWh/m ² vit	Potenciali I kursimit MWh/vit	Investimi (Euro)
		[m ²]	kWh/m ² vit	MWh/vit	kWh/m ² vit	MWh/vit	(Euro)
1	Zyra e vendit Hoçë e Vogël	113.20	10,041.00	88.70	8.70	985.00	€ 10,188.00
2	Zyra e vendit Opterushë	113.20	10,916.00	96.43	16.43	1,860.00	€ 10,188.00

3	Komuna objekti i vjetër	1,336.35	171,721.81	128.50	48.50	64,813.81	€ 120,271.50
4	Zyra e vendit Çifllak	98.94	8,045.67	81.32	1.32	130.47	€ 8,904.60
	Gjithsej	1,661.69	200,724.48	394.95	74.95	67,789.28	€ 149,552.10

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.144/23
Me datë:27.10.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.09.2023 (e martë)**, me fillim në orën **10:25**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **zt.Arbër Zenuni**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **zt. Smajl Latifi**, Nënkyetar **zt. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është mbledhja e nëntë (9) për këtë vit kalendarik. Fillimisht me lejen tuaj, para se te fillojmë me mbledhjen e Kuvendit, në shenjë respekti dhe nderimi te mbajmë një minutë heshtje për Policin qe ra dëshmor, Afrim Bunjaku. Lavdi! Në mbledhjen e mbajtur nga Komiteti për Politikë dhe Financa se bashku edhe me zyrën e Kryetarit, kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet ne pyetjet e kuvendareve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P – 01035-0, ne Zonën Kadastrale ne Xërxe;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale P-02302-0, me pronën e institucionit qendror P- 02240-1,per interes publik,Zona Kadastrale ne Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ridestininim te mjeteve;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2024;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënie ne shfrytëzim afatgjate te pronës se Komunës se Rahovecit P-00266-0,Zona Kadastrale ne Hoqe e Madhe;
8. Informate nga DKA-ja për përgatitjet për fillimin e vitit te ri shkollor 2023/2024;
9. Informate për muajin e mërgimtareve prej 15 Korrikut deri me 15 gusht 2023.

PIKE SHITESH

1. Vendim për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.129/23, i datës 30.08.2023 për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore.

Albnor Mullabazi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolege drejtor, anëtar te kuvendit dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Para jush keni kërkesën vendimit për shfuqizimin te vendimit 01 Nr.129/13, i datës 30.08.2023 për dhënies e lejes dhe kushteve ndërtimore për fondacionin „Adrian Orllati,, kjo kërkesë është ardhë nga MAPL-ja me arsyetimin se duhet te zbatohet ligji për ndërtim dhe ligji për planifikim hapësinor. Të nderuar anëtarë te kuvendit, kërkojmë nga ju qe ky vendim te shfuqizohet.

Dëfrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblast dhe gjithë te pranishmit. E kisha lut drejtorin që të na e përcjell edhe arsyen e MAPL-së për shqyrtimin të këtij akti te kuvendit komunal, edhe pse për çështje humanitare e kemi par të arsyeshme që me i dhanë votën pro kësaj çështje, pasi që në fillim është dukur e paarsyeshme pasi që delegimi i kompetencave të kuvendit komunal dhe për këtë unë nuk po besoj që është e arsyeshme përderisa drejtoria e Urbanizmit duhet me krye punën ashtu siç duhet në bazë të legjislacionit në fuqi, nëse në vazhdojmë që lejet dhe kushtet ndërtimore me i sjell në kuvend për miratim atëherë duhet të ekzistoj drejtoria e urbanizmit.

Kryetari – I nderuar kryesues i kuvendit, drejtor të drejtorive, anëtar të kuvendit, përfaqësues të mediave dhe gjithë ju që e mbikëqyrni këtë mbledhje të rregullt të kuvendit. Edhe pse drejtori e dha shpjegimin mirëpo siç e dini ne ende nuk kemi planin zhvillimor komunal dhe hartën zonale kurse plani zhvillimor i vjetri nuk është në fuqi pasi i ka kaluar afati dhe jemi në pritje të pëlqimit nga ministria për PZHK-në. Kështu që në mungese të veprimit atëherë kemi menduar se në rastin konkret si është me fondacionin „Adrian Orllati,, ta ndihmojmë çështjen që së bashku me kuvendin përkundër faktit se na mungojnë këto dokumente strategjike të komunës. Mirëpo MAPL-ja ka parapare ndryshe dhe e ka përcjell tek ministria e planifikimit dhe nuk e kanë aprovu.. Kështu që na kane rikthye për rishqyrtim dhe ne duhet brenda 30 dite, këtë vendim me shfuqizu këtë vendim që kemi marr në mbledhjen e kaluar edhe pse projekti është krejt humanitar dhe dihet qëllimi i ndërtimit të objektit, ndoshta do te kishte pasur mundësi që të na lejojnë të ndërtohet deri sa te miratohen dokumentet strategjike. Në do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme për projektin qe do të jetë zgjidhje për personat e moshuar që janë pa përkujdesje shoqërore dhe institucionale dhe për banoret e tjerë që kanë status të banimit aty. Kështu neve na duhet që ta rishqyrtojmë vendimin tonë, pra ju ftoj që të votoni vendimin për shfuqizimin e këtij projekti edhe pse me PZHK-në janë të parapara që ndërtesat me qene shumëkatëshe mirëpo në situatën që jemi tani kemi menduar pozitivisht mirëpo ministrit e linjës nuk e kane akceptuar dhe tani na duhet që ta shfuqizojmë vendimin e datës 30.08.2023. Gjithashtu e falënderoj asamblastin Defrim Kafexhiu për kontributin pasi që në kuvend nuk jepen as kushte e as leje pasi që është drejtoria përkatëse për këtë çështje mirëpo në jemi munduar dhe kemi bërë përpjekje për shkak të karakterit humanitar dhe tani duhet me veprua në bazë të detyrimeve që na ka dhanë ministria e planifikimit hapësinor mjedisit dhe infrastrukturës.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi diskutime e qesim në votim për futjen e pikës shtese në rendin e ditës. Konstatoj se me shumice të votave edhe kjo pike futet në rendin e ditës.

Të nderuar anëtarë te kuvendit, tani e qesim në votim rendin e ditës se bashku me piken shtese. Atëherë me shumice të votave të anëtarëve te kuvendit aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në piken e parë të rendit te ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka ndonjë diskutim sa i përket procesverbalit, atëherë meqë nuk kemi asnjë diskutim sa i përket procesverbalit, e qesim ne votim. Konstatoj se me shumice të votave aprovohet pika e pare e rendit të ditës. Kalojmë në piken e dyte:

2. Pyetjet dhe përgjigjet ne pyetjet e kuvendareve.

A keni ndonjë pyetje për ekzekutivin?

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegë asamblastë dhe gjithë te pranishmit ne salle. kërkesa ime është e veçantë nga një pjese e komunitetit te fshatit Krushe e Madhe, qe te merret një iniciative qe me vendos një stacion te policisë për sigurinë e qytetareve te

Krushes së Madhe dhe fshatrave përreth pasi që është nevojë shumë imediate. Më gjithë respektin për Policin e Kosovës për angazhimin dhe orarin e stërngarkuar që e kanë, por vizita e policisë dhe patrullimet e tyre janë shumë të rralla dhe kemi probleme me sigurinë e krijuar nga njerëz të pandërgjegjshëm që me veprimet e tyre krijojnë pasiguri për qytetarët e Krushes dhe fshatrat përreth. Kemi pasur kërkesa të vazhdueshme për këtë mirëpo asnjëherë nuk është marr asnjë veprim rreth kësaj dhe është momenti që me marr shumë seriozisht këtë punë dhe me shikuar edhe mundësin ligjore dhe procedurat tjera.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblist, media dhe gjithë ju të pranishëm. Unë kam një kërkesë pasi edhe herën e kaluar kemi folur për rrugën Ali Sokoli kur është asfaltuar, ne kemi vështirësi në rrugën “Permeti” dhe “Kuvendi i Manastirit” pasi gjatë punimeve e sipër janë disa anësore që askush nuk i ka largu nga aty dhe gjithashtu aty është krijuar një gropë e madhe që po krijojnë vështirësi për qytetarët e dy lagjeve për tu kyçur në rrugën kryesore. Kështu që ju kisha lutur që kur të kryhen punimet duhet intervenohet në rregullimin dhe qasjen e qytetareve pa vështirësi në rrugën kryesore.

Fahrie Lushi – I nderuar kryesues, kryetar, kolege këshilltar dhe gjithë të pranishëm. Pyetja ime ka të bëjë me fermerët pasi që nga viti i kaluar kur kishim reshje të mëdha atmosferike dhe ende nuk kanë marr asnjë përgjigje për dëmet e shkaktuara. Kështu që sot në këtë mbledhje drejtori i bujqësisë duhet të na jap një informate që të kemi edhe ndonjë fakt për mbledhjen e kaluar pasi qytetarët duhet ta dinë se kur do të kompensohen për dëmet që u janë shkaktuar dhe nëse ekziston një listë me emrat e përfituesve duhet që drejtoria e bujqësisë ta publikoj nëse deri me sot ende nuk e ka publikuar, pasi pritja e tyre duhet që të bazohet dhe të jetë e arsyeshme që të argumentohet nga drejtoria e bujqësisë me publikimin e listës me emrat e fermerëve që do të përfitojnë për dëmet e shkaktuara.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorisë, kolege asamblist, media dhe gjithë të pranishmit. Pyetja ime ka të bëjë me drejtorin e Shërbimeve Publike, kërkesa ka të bëjë me rrugën kryesore në hyrje të fshatit Polluzhë një pjesë e kësaj rruge është në gjendje të mjerueshme, dhe sigurisht që krijojnë shumë vështirësi për banoret që e frekuentojnë çdo ditë atë rrugë, kështu që ju pyes se kur do të fillojë punimet për rregullimin e asaj rruge. Poashtu edhe kërkesa tjetër ka të bëjë nga banoret e fshatit Brestoc që kërkesa është nga banoret e bashkangjitur me nënshkrime, të lagjes “Dituria” që kërkon urgjentisht të intervenohet në prrocken që kalon në këtë lagje pasi vazhdimisht kundërmon erë të keqe nga kanalizimi që është i bllokuar dhe gjithë ujërat e zeza derdhen në këtë perocke. Kështu që presim përgjigje nga institucionet e komunës se kur do të fillojnë punimet në këtë drejtim.

Defrim Kafexhiu – Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblist, media, monitorues dhe gjithë të pranishmit. Pyetja ime ka të bëjë me Planin Zhvillimor Komunal pasi që me datën 8 shkurt e kemi mbajtur seancën e jashtëzakonshme që me hap konsultimin publik për PZHK për 8 vitet e ardhshme, ku në muajin mars është përmbyllur afati konsultimit publik dhe janë finalizuar afatin e ankesave dhe kërkesave që kanë qenë përgjatë atij muaji ku kemi disa muaj që është përcjellë në ministrin përkatës dhe tani kërkojmë se për çfarë arsye është kthyer PZHK-ja dhe cilat kanë mangësi që nuk është finalizuar dhe sikur të ishte në rregull dhe me afat do të ishte konfirmuar PZHK-ja atëherë nuk kishim pas nevojë si kuvend por edhe si komunë me gjet forma alternative qofte për projekte tjera e qofte edhe për projektin që folëm me herët që ka karakter humanitar. Po ashtu e përgëzoj kryetarin për fillimin e zgjidhjes së problemit të kanalizimit në rrugën “Vëllezërit Frashëri” po ashtu kërkesa tjetër është se kjo rrugë nga fillimi deri mbarim ka shumë pengesa apo kyçe të qytetareve që kanë bërë në rrjetin e ujësjellësit që janë të parregulluara dhe njëherit po e vështirësojnë kalimin në atë rrugë për banoret e lagjes, po ashtu kërkesa tjetër të rruga “Mexhit Mustafa” që është një lagje e madhe në qytet dhe ka probleme të mëdha dhe ka shumë nevojë për ndërhyrje. Pyetje tjetër është për Drejtorin e Urbanizmit, sa i përket sheshit në qendër të qytetit kur po planifikohet me u përfunduar pasi

siç shihet është shuma gabim forma e implementimit të këtij projekti por edhe vet projekti është gabim për shkak të vështirësive që krijohet për me qarkullu lirshëm në atë pjesë, pasi nuk e di a është diskutu edhe ne KKSJB kjo çështje dhe po besoj që edhe Policia duhet me qarkullu me shpesh sidomos në kur ka fluks më të madhë të qytetarëve pasi ka shumë bllokim të rrugës në atë pjese gjë e cila nuk ka ndodh me herët, kështu që duhet ta dimë se a keni me ndryshu planin apo keni me perfundu projektin ashtu si ju keni fillu.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolege asamblastë, media dhe gjithë të pranishmit në sallë. Ne morëm një përgjigje prej drejtorit të Bujqësisë por përgjigja u dha deri te ankesa mirëpo nuk e jep arsyeshmërin pse është refuzu kërkesa e fermerit. Fermerin e njoh edhe personalisht dhe thotë që është përsëritur për të njëjtën gjë edhe ne vitin 2021 kur janë dëmtuar fidanët në serre dhe asnjëherë nuk është kompensuar dhe kjo është një përsëritje. Kështu që e pyes drejtorin se pse i është refuzuar kërkesa për kompensim. Poashtu nga drejtoria e arsimit kërkoj që të a jep sqarime pasi edhe me herët e kemi diskutuar për edukatoret qe janë pranuar në punë çka do të ndodhë me rastin e tyre, tani disa edukatore angazhohen e disa jo, pasi jam në dijeni se çerdhet ende nuk janë lëshuar në funksion për shkak të mungesës së inventarit por në anën tjetër disa edukatore janë angazhuar në Rahovec, Xërxe , Krushe por jo te gjitha. mendoj se angazhimi selektiv nuk është parim dhe është shkelje e të drejtave të njeriut dhe njëherit kërkoj që të angazhohen të gjitha derisa të lëshohen çerdhet në funksion, të kenë mundësi të krijojnë një përvojë secila prej edukatoreve për punën, që me pas mundësi me qenë me e pavarur secila në punën që e bën. Pastaj për Shërbimet Publike, rruga të teqeja e madhe që ka filluar të shtrohet prej qendrës, ka filluar të dëmtohet menjëherë pasi kur shtresa e par priset për shkak të problemit në trupin e rrugës atëherë as shtresa e dytë nuk e stabilizon pasi këtë e them me plot përgjegjësi si inxhinier dhe rruga nuk ka as një muaj që është shtruar dhe menjëherë është dëmtuar. Po ashtu rruga nga rrethi te Viva në hyrje të qytetit dhe deri te rrethi te rrasat është duk u punuar në shenjtore në disa pozicione është shumë shqetësuese pasi përpos mungesës kanalizimit për shkak të grupimeve që janë bere, ka filluar edhe me rrëshqit edhe trupi rrugës dhe gjithashtu ka shkaputje të pjesës së asfaltit nëpër disa vende në anën e djathtë të rrugës në drejtim të Malishevës. Kështu që kërkoj të jeni me serioz në rregullimin e asaj pjese dhe gjithashtu me finalizu mbushjen me zhavorr që mos të kemi rrëshqitje sepse mund me ardhë ndonjë aksident dhe pastaj dikush duhet me dhanë përgjegjësi. Pra ju kërkoj që ta verifikoni gjendjen e tanishme dhe të intervenoni pasi trupi i rrugës ka fillu me rrëshqit dhe ka rrëshqitje të pjesës s asfaltit.

Vlora Vuçitërna – Përshëndetje për të gjithë. Para një muaji është shpallur një konkurs për praktikant me pagës në partneritetin publiko privat ku janë pranuar gjithsej 36 kandidat. Me intereson të di se deri ku ka shkuar procesi dhe pse ende nuk janë ftuar kandidatet për të filluar punën.

Ilir Pallqa- Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, koleg asamblastë dhe gjithë të pranishmit. Para një muaji isha për vizitë në shtëpinë e pëlqeve, mirëpo e pash nga afër se aty pleq nuk ka pasur, edhe pse në Rahovec nuk kemi mungesë të pleqve për fatin e mire, mirëpo ka një problem se për vendqëndrimin e ndërtuar, ata nuk janë aty. Siç e dimë para pak kohe është prerë shiriti i asaj shtepie, mirpo paraprakisht një projekti të tillë duhet të paraprijë një Project tjetër i rëndësishëm që me pas mundësi me qenë i përdorshëm apo me u kriju mundësia e një vendi të qasshëm për ata. Kështu që pasi që është përfunduar ai Project, atëherë ne duhet të bëjmë një projekt tjetër për me i dhanë kuptim shtëpisë së pleqve, pasi një gjë e tillë u deshtë të behet me herët mirëpo edhe tani nuk është vone. Pra duhet me realizu çështjen e autobusëve urban, pasi si shkas e gjeta shembullin shtëpinë e pleqve për me tregu domosdoshmërinë e autobusëve urban në komunën tone, pasi krijon lehtësira për banoret e komunës, lehtësi në qarkullim, kursim të kohës por edhe gjallëri ekonomike. Poashtu do ishte lehtësi edhe për nxënësit e shkollave te mesme që vijojnë mësimin në qytet apo edhe në fshatrat respektive dhe kjo do të ishte shumë e mirëseardhur për qytetaret e komunës tonë dhe njëherit komuna ka mekanizma ka mundësi për me nis një projekt të tillë e sigurisht edhe realizimin e tij.

Kështu që ne si parti e kemi bërë një studim të fizibilitetit por edhe realizimit të tij dhe kemi ardhë në përfundim se në komunën tonë kemi nevojë për 5 linja të autobusëve me një kosto vjetore që do të ishte 133,000 euro që përfshin personelin dhe karburantin dhe për sigurimin e autobusëve mund të marrim shembullin e komunës së Prishtinës. Pra këtë projekt ne mund të ju dhurojmë por ndoshta nuk keni nevojë pasi mund ta bëni edhe ju pa ndonjë problem, kështu që ju inkurajoj që të merreni me këtë problem pasi po të zgjidhej do i ndihmonte mjaft shumë banoret e komunës tone.

Merisa Sharku – Përhëndetje për të gjithë. Unë dua atë ndërlidhem sa i përket rrugëve të qytetit, pasi punimet në çdo projekt që fillon të lihen në gjysmë dhe të ketë pauza të tej zgjatura deri në vazhdimin e punimeve të këtyre rrugëve dhe pothuajse asnjë projekt nuk është i përfunduar duke lënë shumë gropa që shfaq vështirësi në qarkullimin e lire të qytetareve, ku këto vështirësi i hasim në shumë pjese të rrugëve të lëna në gjysmë apo të papërfunduara.

Edona Kryeziu – Përhëndetje për të gjithë. Pyetja ime i drejtohet drejtorisë së Arsimit, pasi me ligj ju takon të gjithë profesorëve dhe arsimtareve që pas pensionimit të i marrin 3 pagat jubilarë mirëpo është për keqardhje pasi dikujt i kompensohen e dikujt jo, kështu që kërkoj nga kryetari të na jep një sqarim se pse po ndodh ky fenomen.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përhëndetje për ju kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblistë media dhe gjithë të pranishmit në sallë. Pyetja ime ka të bëjë me shqetësimin e qytetareve sa i përket marrjes së lejeve ndërtimore. Pra duhet të behet me shumë sa i përket marrjes së lejeve ndërtimore sidomos nëpër fshatra por fjala është se kushtet që kërkojnë, ka shqetësime rreth kësaj për shkak të procedurave. Kështu që komuna duhet të bëjë me shumë që ti ndihmojë qytetarët që të marrin me lehtë lejen ndërtimore, pasi konkretisht një qytetar është ankuar sa i përket marrjes së lejes pasi që ka më shumë se tre dekada që jeton në vendin e caktuar dhe tash i duhet të ndërtoj shtëpinë e re në vendin e njëjtë mirëpo i kërkojnë procedura tjera sa i përket orës së njëjtë të rrymës. Pra e pash të arsyeshme që kërkesën e qytetarit ta adresoj këtu në kuvend.

Kryetari – Faleminderit për kontributin e juaj, unë do të mundohem që të jap përgjigjet sa i përket pyetjeve të adresuara mirëpo disa përgjigje do ti merrni edhe nga drejtoret e drejtorive rreth shqetësimeve që u paraqiten. Sa i përket kushteve ndërtimore dhe lejeve ndërtimore siç e dimë ka një ligje të ndërtimit që i parasheh disa situata që kërkojnë dokumentacion shtesë dhe nëse nuk plotësohen këto kushte atëherë drejtoria urbanizmit nuk guxon me dhanë leje dhe sigurisht se kemi vështirësi edhe me operatorët tjerë si KRU-Gjakova, KED-si, pastaj agjencinë për menaxhimin e emergjencave për shumë çështje që lidhen. Në kemi memorandume bashkëpunime me këto agjencinë dhe në rastet e tilla ne mundemi me ndiku dhe me i pershpejtu veprimet për rastet e tilla. Pastaj sa i përket pyetjes rreth punimeve në qytet, sigurisht se kemi pasur disa pauza për shkak të reshjeve por sigurisht se do të rikthehen punimet, sigurisht se edhe në rrugën Ali Sokoli do të bëhen edhe disa punë me u krye pasi janë në proces edhe shume punë që priten të behen, pasi kemi pasur shumë intervenime nëntokësore me vendosjen e kabllave dhe sigurisht që ka mundur me pas edhe dëmtime të rrugës për shkak të bazës, por ne do të bëjmë përpjekje që këto punime të stabilizohen me vendosjen e shtresës së dytë dhe rregullimin e pesetave pasi kompania është serioze dhe po mundohet të bëjë punë të mira në të gjitha punimet që janë duke u kryer dhe brenda një periudhe të shkurtër do të kemi rregullimin e pusetave dhe asfaltimin e rrugës. Sa i përket autobusëve urban, unë kisha pas dëshirë me pas atë projekt të studimit të fizibilitetit edhe sigurisht se do ta konsultoj edhe me plot ekspert të komunikacionit e po ashtu edhe drejtorin e kemi të drejtimit të telekomunikacionit edhe sigurisht edhe me grupin e juaj mundemi me planfiniku edhe me buxhet që me ndertu infrastrukturën për trafikun urban. Po ashtu edhe shpija e pleqve është përruar, në kemi projektin për të cilin foli më herët Iliri, por problemi qëndron se ASB-ja si financues për mobile e ka marr mbi vete mundësin që me i krye këto shërbime dhe tani jemi në dilemë që me shpall procedurën e prokurimit për transport të pleqve dhe sigurimin e ndonjë shujte apo me prit përgjigjen e ASB-ja dhe sigurisht se ai projekt merr kuptim

kur vendosen pleqtë aty, pasi ndoshta duhet me ja dhanë në shfrytëzim kuvendi i komunës. Sa i përket pyetjes për praktikantët me pages, ne i kemi shpall rezultatet për 36 që i kanë plotësuar kriteret dhe sa i takon pjesës së komunës jemi gati por procedura kërkon që me shpall thirrje edhe për bizneset që kanë shprehë dëshirë me i marr këta praktikant që me u kompletu si partneritet publik- privat. Poashtu edhe rruga transite sigurisht se do të stabilizohet pasi kompania Mendi-P është kompani shumë përgjegjëse e që nuk është e njëjta situatë edhe me kompanitë e tjera por kemi premtime se këtë vit do të vendoset asfalti dhe do të rregullohet rreth rrotullimi i rri, po ashtu po ka shumë vështirësi pasi kur po behën gërmime po ka shembje. Pastaj sa i përket pagave jubilarë, por problemi qëndron se dikush ka provu me marr përmes avokatit dhe ju ka drejtu gjykatës dhe shumica dërmuese janë duke i marr pasi ju takon sipas kontratës kolektive edhe pse neve si komunë na ka paraqit shumë vështirësi. Pra ka disa linja të komunikimit të realizimit të drejtave të mësimdhënësve për pagat jubilarë. Pastaj çështja e edukatoreve që u paraqit nga Burimi, besoj që e ka të qart ato që janë të pranuar por ato fillojnë me ushtru marrëdhënien me i krye detyrat në momentin kur funksionalizohen plotësisht çerdhet. Por në disa vende për momentin janë të lira edhe duhet të zëvendësohen deri në momentin e funksionalizimit të çerdheve ato mund të ushtrjnë funksionin e tyre edhe në shkolla si zëvendësuese mirëpo për më shumë detaje mund të ju përgjigjet në seancën e ardhshme drejtori i Arsimit. Dhe në momentin e fillimit të punës se tyre, ato do të konsiderohen të rregullta si punonjëse të komunës vetëm atëherë kur funksionalizohen çerdhet. Sa i përket sheshit në qendër të qytetit që u adresua nga dëfrimi, në momentin kur funksionalizohet ky projekt atëherë do të shqyrtojmë mundësin që nëse nuk funksionon mire atëherë mund të bëjmë ndryshime me ndonjë qarkore dhe të shohim si do të jetë situata në momentin kur përfundohet projekti, pasi parkingjet janë ngushtu dhe gjithashtu edhe patrullimet e policisë për shkak të peshës së institucioneve që janë aty si shtëpia e kulturës, teçeja, xhamia dhe po krijon vështirësi në qarkullim, por në momentin kur shënjohet dhe përfundon si projekt do të shohim mundësin e lëvizjes e sigurisht se do të marr edhe mendimin e juaj si kuvend por edhe të eksperteve nëse paraqitet nevoja. Po ashtu edhe sa i përket kanalizimit veç ka fillu edhe jam në dijeni sa vështirësi ka mirëpo paraprakisht i kemi paralajmëru se cilin banor që kyçet aty dhe jemi në një situatë se kanalizimi duhet të behet dhe do të shohim mundësin e rregullimit të rrugës që me hap atë zonë dhe janë në dijeni për të gjitha kërkesat e tyre. Mirëpo njëkohësisht jemi duke punuar edhe për trafo por ende s'po gjendet një lokacion i përshtatshëm që e ofron dikush një parcelë për shpronësim, vetëm për këtë jam i gatshëm me bo përjashtim për shkak të specifikave që ka lagjeje për nevoja të trafos edhe pse do ishte rasti i parë pas 25 vjetësh. Poashtu edhe rruga „Vëllezërit Frashëri” ka fillu me u rregullu me të gjitha problematikat që i ka shkaktu KRU-Gjakova dhe gjithashtu edhe rruga „Agim Qela” që ka disa problematika të ngjashme, shumë shpejt do të riparohen. Sa i përket pyetjes së parashtruar nga Burimi dhe Edona, për fermerin që i janë shkaktuar demet në seren e tij, unë kam pas mundësi që me drejtorin e Bujqësisë me shku në vendngjarje e po ashtu edhe me ministrin e Bujqësisë që me pas mundësi me pa direkt se qysh punon një fermer i komunës tonë. Nëse në vitin 2021 ka pas një dëmshpërblim me një dyfishim të subvencioneve dhe kam kërkuar mirëkuptim për me i dyfishu subvencionet gjatë asaj periudhe. Tek kompensimi i dëmeve si komunë jemi refuzu sikur që janë refuzu edhe komunat e tjera por ne kemi insistuar shumë saçe kemi gjetur mundësi edhe me avokat që mos me heqë dore nga e drejta për kompensim sikur do komuna tjera si Gjakova, Deçani për shkak të situatave komplekse që ka prodhuar udhëzimi i ri administrative dhe kemi marr një pjesë pastaj kemi fillu me FAO-në dhe me ministrinë e bujqësisë i kemi marr edhe një pjesë tjetër që janë financuar, por ende nuk janë kompensuar krejt që realisht mund të jetë ne mesin e tyre edhe fermeri i Vrajakes. Ekziston mundësia që brenda një parcele mbi 5 hektar disa me u pranë e disa jo kurse gjendja është njësoj pasi e gjitha ishte e përmbetur nga uji. Kështu që në këtë foltore e ka thanë edhe kryetari i komisionit për kompensimin e dëmeve Kastriot Lajqi se në fund të shtatorit pritët me u marr vendimi i qeverisë dhe po shpresojmë që shumë shpejt do të merr vendim qeveria për këtë. Mirëpo rreth asaj se kush ka perfitu dhe kush është refuzu mund të

aplikoni në qasje për dokumente zyrtare në procesverbalin e përpiluar nga ministria. Sa i përket stacionit policor në Krushe të Madhe, gjithmonë jemi interesuar që nga paslufta e deri me tani si kryetar I komunes, mirëpo strategjia e ministrisë së punëve të brendshme në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare është që të mos ketë stacione shtese përveç në qendrat komunale dhe të mos ketë objekte shtese, pasi me shume janë bazuar në patrullime dhe pozicionime që qëndrojnë për një kohë dhe në lëvizje të lokacioneve dhe tani për tani nuk plan për stacione të reja në Krushe, Rogov, Ratkoc apo në Xerxe edhe pse plotësisht është e arsyetueshme dhe legjitime nevoja e qytetareve. Kemi pasur kërkesa si nga Krushja Ratkoci Xerxja që me pas një stacion të policisë apo edhe me pas me shume patrullime mirëpo këta I kane zgjedh si pika të caktuara që nëse ka ndonjë shqetësim nga qytetaret me i adresu në ato vende të vendosura si kuti e ankesave. Sa i përket PZHK-se, në i dimë veprimet e komunes dhe të kuvendit të komunes dhe i dimë gjithashtu shqetësimet që kanë lindur në procesin e konsultimit publik. Ne si komune kemi bere përpjekjet tona për krejt ato që është kërkuar i kemi bo gati dhe po shpresojmë që brenda javës do të marrim një përgjigje rreth kësaj. Shpresoj që të marrim përgjigje pozitive dhe mundësit janë reale që të marrim përgjigje pozitive dhe në momentin që na japin përgjigje ,planifikoje me thirr seance të jashtëzakonshme vetëm për PZHK-ne, ne mënyrë që mos me ndodh vonesat për vlerësimin strategjik mjedisor pasi është dokument që kërkon shqyrtim publik dhe ka plot procedura ,që mos me pas vonesa sa i përket hartës zonale. Pra presim përgjigjen pozitive nga ministria e planifikimit hapësinor dhe ministria e bujqësisë me kërkesat që i kemi adresuar.

Drilon Mustafa – Faleminderit kryesues i nderuari kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblastë, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit në salle. Pyetja ime është për drejtorin e shërbimeve publike në lidhje me loton e tret të rrugëve që është i tenderuar dhe dihet kompania fituese, a keni një plan dinamik dhe kur planifikoni me punime dhe propozimi im është të filloni nga Mrasori apo Guri i Kuq sepse ndoshta është nevojë me imediate. Gjithashtu pyetja tjetër është për drejtorin e Kulturës në lidhje me fushën e sportit në shkollën e Gurit të Kuq, së kur do të planifikoni të filloni me punime pasi janë të ndara mjetet e ndara për atë fushe dhe gjithashtu isha ndërlidh edhe për drejtorin e urbanizmit se a është e mundshme fondacionit “Adrian Orllati” të i jepet një leje me kushte të veçantë me mundësi vazhdimi pasi na ndodh në shumë raste që kur marrim leje që ka ndryshu harta zonale apo që në kërkojmë prova që ai objekt i ka themelet për me vazhdu përpjetë. Pra nëse është e mundshme që fondacionit Orllati kjo ti kërkohej me kohe që ta sjellin projektin statik që ti jepet leja për kushte me mundësi vazhdimi.

Perparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë anëtarët e kuvendit. Unë do të përgjigjem për pyetjen e parashtruar nga Bejtullah Deliu, pasi fatkeqësisht ne po varemi me shume prej kompanive publike që po shkaktojnë dëme në ato rruge dhe me qellim është lënë ajo pjese e patrajtuar për shkak se banoret po kërkojnë me e ndryshu gypin e ujit dhe me qellim është lënë ajo grope për shkak të problemeve tjera teknike deri sa behet një zgjidhje me KRU-Gjakova. Por ne do të angazhojmë menaxherin e projektit dhe do te shohim gjendjen në terren dhe besoj që në takimet e tjera që do të kemi do të jap një përgjigje definitive dhe kjo është arsyeja që nuk është bërë lidhja e rrugës “Ali Sokoli” me rrugët e tjera dytësore. Po ashtu edhe në pyetjen e Floridës rreth kanalit në Brestoc, aty në bashkëpunim me drejtorin e urbanizmit vitin e ardhshëm është planifikuar të behet segmenti për shkak se ministria ka dështuar në ndërtimin e kanalit kryesor për trajtimin e ujerave atmosferik por edhe kuadër të këtij kanali do të behet edhe trajtimi i ujerave të zeza pra ndërtimi i kolektorëve që do të jen përskaaj, pra do të trajtohet edhe ky segment dytësor. Sa i përket rrugëve tjera lokale në trajtimin dhe meremetimin rrugëve, ne kemi disa vendbanime që kanë probleme me këto segmente si Plluzha Pastaseli pastaj Fortesa Celina, Vrajaka mirëpo me prioritet e kemi zgjedhur qytetin për shkak se kan qenë rrugët e demoluara dhe i kemi trajtuar e me pastaj do të dalim edhe në pjesë tjera të komunës . Poashtu sa i përket pyetjes se Drilonit, pas tenderimit është lidhur kontrata e re dhe përfitues është kompania KAG-asphalt dhe gjatë kësaj jave pritët të filloj punën në Guri te Kuq dhe do të

vazhdoj sipas renditjes dhe sipas prioriteteve që në këto vendbanime nuk ka pasur investime në këtë segment rrugor.

Bejtullah Deliu – Faleminderit drejtor për përgjigjen mirëpo nuk prite të marr përgjigje vetëm si qëndron situata, pasi që gjendja e tanishme është me e keqe se sa ka qenë para rregullimit dhe gjithashtu e kuptoj brengjen e qytetareve për kyqje dhe sigurisht se do të punohet me vone por deri atëherë duhet të behet diçka në atë drejtim pasi gjendja vërtet nuk është e mire pasi pothuajse është e pakalueshme nga dy lagje. Kështu që nëse nuk ka zgjidhje më afatgjate, atëherë përkohësisht të përmirësohet rruga dhe të behet e kalueshme e ëoashtu duhet të intervenohet edhe në rrugën Përmeti pasi kabëzat janë dëmtuar dhe do të ishte mire të bëni një projekt me të detajuar dhe të vazhdohet me rikuperimin e asaj rruge.

Afrim Dina – Sa i përket pyetjes nga Drilon Mustafa për terrenin sportive në Guri të Kuq, për fushën sportive në Guri të Kuq dhe Malësi të Vogël ka qenë kontratë e kaluar përmes DKA-së mirëpo kompania ka deshtu dhe ne si drejtori kemi marr përsipër që edhe fushën në Guri të Kuq të jetë pjesë e projektit dhe është e planifikuar pasi janë 11 fusha që do të ndërtohen në komunën tonë.

3. Shqyrtimi dhe miratimi propozim vendimit për shpalljen me interesat të përgjithshëm publik P-01035-0, ne Zonën Kadastrale Xërxë.

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtar të kuvendit, media dhe gjithë ju të pranishëm. Para jush keni propozim vendimin e kryetarit për shpalljen me interes e përgjithshëm të parcelës P-01035-0, në zonën kadastrale në Xërxë e cila është me sipërfaqe të përgjithshme prej 2252 m2, në vendin e quajtur Skeja Kulturë, që është kulturë e vendit të tretë, ku sipas certifikatës së pronësisë kjo parcele aktualisht menaxhohet nga AKP-ja. Qëllimi i shpalljes së interesit publik është të zhvillojmë procedurat për shpronësim të kësaj parcele. Ftojë anëtarët e kuvendit që ta votojnë këtë pike të rendit të ditës.

Burim Krasniqi – Disa here po ndodh që po i japim në shfrytëzim parcelat që janë tek Matrexi, por forma e parcelizimit është në pozicion të pjerrët në raport me objektin. Pra nëse jepni sipërfaqe të caktuara atëherë shfrytëzuesi ka mundësi që ka investu që mundet me qenë potencial përsëri për me vazhdu kontratën mundet me ju nda keq. Pra do të ishte më mirë që komuna me trajtu si tërësi me nda sipërfaqen e brendshme në hapësira dhe gjithashtu sipërfaqen e jashtme që me u dhanë drejt në kuptimin e shfrytëzimit që është duke u bërë. Dhe nëse e shohim në ortofoto ,ajo e ka objektin në formën e një trekëndëshi dhe nëse gjejmë mirëkuptimin atëherë po mendoj se është e arsyeshme me pa mundësin e ndarjes si hapësirës së brendshme dhe hapësirës së jashtme që me u nda ashtu si shfrytëzohet dhe jo me shfaq problem pasi ndoshta de-fakto shfrytëzohet ndryshe por nesër me pas një kontest të caktuar mes dy shfrytëzuesve mundet me u shfaq problem mbi bazën të dhënies në shfrytëzim.

Kryetari - Po Burim, saktë e ki, po tash ne në rastin konkret e kemi një situatë interesante, ka qenë gjithmonë kështu, po toka është e AKP-së, objekti është i komunës. Ne me këtë vendim po kërkojmë me shpall interes të përgjithshëm që të filloj procedurat e shpronësimit me ja marrë AKP-së, pra Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sepse një pjesë e tokës, tash të them drejtë më përpara kur ju ka në dhënë shfrytëzim, s'e kanë këqyrë fort. Tani me një vendim veç me ia dhanë shfrytëzim përmes ankandëve, por s'ta japin ligjshmërinë, sepse është pronë e AKP-së. Kemi bisedu me Agjencinë dhe ne po fillojmë procedurat e shpronësimit. Po, a është vetëm kjo parcelë? Vetëm kjo. Pra, të gjitha janë të komunës, këtu e kemi një situatë interesante, por nuk e kane vërejtë, pasi ka qenë edhe me përpara, po s'e kanë hetuar fort, tash s'kemi qare se ka ardhur koha kur duhet me u definu, duhet me shpronësu që atë pjesë ku objekti është i komunës, toka është e AKP-së. Pra, unë po besoj që Kuvendi i Komunës ka arsye ta votoj.

Kryesuesi - Faleminderit, kryetar! Në qoftë se nuk kemi ndonjë diskutim, atëherë këtë pikë e kalojmë në votim. Kush është për, kundër, abstenim, me shumicë votash nga anëtarët e Kuvendit votohet kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e Pronës publike komunale P- 02302-0, me pronën e institucionit qendror P- 02240-1 për interes publik, Zona Kadastrale ne Rahovec.

Afrim Oruqi - Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtare të Kuvendit, Në bazë të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, para jush keni propozim-vendimin për marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës komunale me pronë të Agjencionit Pyjor të Kosovës, të dy parcela janë në zonën kadastrale në Rahovec, konkretisht për një parcelë që do të marrim një hektar prej sipërfaqes së përgjithshme, që është në menaxhim të Agjencionit Pyjor, gjendet aty ku kohën e fundit ka kaluar tashmë i ndjeri profesor Doktor Sabaudin Cena, do të marrim prej parcelës komunale në hapësirë prej një hektar, e cila gjendet në zonën kadastrale të Rahovecit, është e klasit të njëjtë, është diku mbrapa bazenit Shala, prej pjesës së përgjithshme që është mbi nëntëmbëdhjetë hektarësh pronë e komunës. Para jush keni edhe raportin e Komisionit që e ka themelua kryetari i komunës për vlerësimin e pronës dhe Gjeodezia do të kujdeset pas marrjes së vendimit, të njëjtin vendim do ta publikojë në faqe të zyrtare të komunës. Qëllimi i këtij këmbimi është që këtë zonë, në këtë sipërfaqe prej një hektar, ta bëjmë rekreative të interesit të përgjithshëm, pasi për momentin është e Agjencionit Pyjor. Ftoj anëtarët të Kuvendit që të votojnë propozimin, vendimin për marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës komunale me pronë të institucionit qendror.

Rasim Fazliu - Faleminderit kryesues! E falënderoj drejtorin! Unë, thashë ndoshta është një lëshim këtu, se në pikën një, thuhet këmbimi i pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik. Ndërsa, pika dy, qëllimi ku thotë është qëllimi i këmbimit është me pronën private këtu thotë. Pra, qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën një të këtij vendimi. Ndoshta, lëshim është diçka apo unë jam gabim, s'po di. Këta thashë desha, pika dy.

Burim Krasniqi - Drejtor, e kam bërë edhe një herë një pyetje të ngjashme, meqenëse jemi në një fazë tjetër dhe me shpresë që planin zhvillimor komunal ka marrë një pëlqim pozitiv prej institucioneve qendrore. A ekziston mundësia ligjore që në bazë të planit zhvillimor komunal, parcelat të cilët kanë me qenë në interes të zhvillimit të komunës së Rahovecit që i parasheh PZHK-ja, të kalojnë në menaxhim të komunës së Rahovecit me një vendim të qeverisë në të ardhmen, që mos me pas nevojë të lëvizjeve të këmbimit se a është pronë publike në shërbim të qytetarëve a menaxhohet prej nivelit qendror apo prej nivelit lokal, domethënë është prapë pronë e qytetarëve të komunës së Rahovecit si pronë publike, po a ekziston mundësia tash po pyes që në të ardhmen pas kalimit të PZHK-së të gjitha këto prona që dalin që i targeton plani zhvillimor komunal si interes i komunës së Rahovecit, më një vendim me u bë një kërkesë qeverisë dhe me një vendim të caktuar të kalojnë nën menaxhimin e komunës në shërbim të funksionalizimit të PZHK-së.

Afrim Oruqi - Faleminderit kryesues! Në pyetjen e kuvendarit Rrasim Fazliu ka ndodh një gabim teknik në materialin e KPF-së, pasi asamblisti e ka para vetes materialin e KPF-së. Ndërsa, në materialin e Kuvendit në propozim vendimi është i përmirësuar në pikën dy, shkruan këmbimi i pronës komunale me pronë të institucionit qendrorë, e kemi përmirësuar. Në pikën katër ka rrjedhë një gabim i njëjtë që thotë që pronë komunale me pronë private dhe këta lus sekretariatit që ta përmirësojë, pra kujdesemi me sekretariatit që para se ta dergojmë për ligjshmëri. Pra, bëhet fjalë për pronë komunale me pronë të institucioneve qendrorë. Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi, neve klasa e pronës na dikton kjo zonë për të cilën po flasë sipas PZHK-së është zonë për turizëm, është e klasit pestë, nuk është zonë ndërtimore dhe e kmei cekur që e kemi për rekreacion, për turizëm, malor, për nevojë e tjera të qytetarëve, është e pamundur që ta cekë PZHK-në, për shkak se ligjërisht klasa e tokës na dikton neve edhe kjo është njëra prej arsyeve që vazhdimisht PZHK-ja na kthehet, sepse është e pamundur tipin e klasit të llojit një, dy, tre, ta parasheh për zonë ndërtimore, për shkak se këto toka mbrohen me Ligjin e tokës. Nëse mendoni që ka nevojë, lus edhe kryetarin nëse ka shtesë në lidhje me përgjigjen.

Burim Krasniqi - Drejtor, nuk po di as e kam thënë mirë, apo nuk më ke kuptuar drejt. Nuk kërkoja në këtë rast konkret, që ne me parapa zonë ndërtimore ose diçka të ngjashme. Pra, plani zhvillimor komunal i parasheh të gjitha, ku ka me qenë ndërtim, ku ka me qenë turizëm, ku rekreacion, ku bujqësi, ku gjithçka. Po besoj që ka me pas edhe zonat që janë në menaxhimin e agjencionit të pyjeve, që PZHK-ja i jep për një aktivitet të caktuar zhvillimor të komunës së Rahovecit. Unë nuk thashë tash, po në momentin kur PZHK-ja merr pëlqimin pozitiv edhe kalon e bëhet i plotfuqishëm, a ekziston mundësia, meqenëse po ndërlidhen me kërkesat e vazhdueshme që po na vinë të natyrës së ngjashme për shkëmbim të pronave, që këto parcela kur i parasheh PZHK-ja për zhvillim të komunës së Rahovecit me një kërkesë të veçantë, t'i përfshijë të gjitha, ti drejtohem qeverisë që qeveria me marrë vendim, që ti kaloj nën menaxhimin e komunës së Rahovecit, që mos të ketë nevojë të vendimeve të përhershme në asamble komunale por të shkoj tutje si proces.

Kryetari -. Unë e kuptova Burimin, besoj të ka kuptuar edhe drejtori, po situata është kështu, pasi ne ndonjëherë unë mbaj mend që në këtë kuvend të komunës pesëqind e dyzet e katër hektarë të pronave, edhe në kohën time edhe të Qazim Qeskës, në kohën e Idriz Vehapit, edhe në kohën time një herë ka ndodhë në mandatin e parë, se e kemi pa që s'bën. Kemi provuar krejt pronat e AKP-së, me i bo pronat e komunës, madje edhe disa prej pronave të agjencionit pyjor, me i bo pronat e komunës. Mirëpo ata janë shkuar atje, sipas ligjit, na i kanë kthyer mbrapsht vendimet dhe plot komuna e kanë bërë kështu. Ne kemi me PZHK besoj janë parapa shumëçka është parapa, edhe ku do të jenë zonat ndërtimore, zonat turistike, zonat bujqësore, zonat e përziera e tjera e tjera, prandaj unë thashë, ndoshta është më mirë me heshtë, për shkak se po e presim pëlqimin prej ministrisë, sepse edhe një herë ka mundësi të na kthejnë në pikën zero, tani dalin telashe tjera. Tash, pronat të cilat janë të parapara me PZHK, ne do të provojmë që me VSM-në, me Vlerësimin Strategjik Mjedisor, që është një dokument që menjëherë është gati tash veç sapo vetëm të presim pëlqimin, ky dokument ka me dalë në shqyrtim publik edhe Kuvendit të komunës edhe ligjshmërisë pastaj dhe me HZK do të vazhdojmë pastaj me të jemi ma preciz. Domethënë, se harta zonale e Komunës e në këtë rast kuptohet në pajtim me ligjin për planifikim hapësinor dhe ligjet e aplikueshme, po konsiston në precizitet. Harta zonale domethënë thjesht më shumë nënkupton se në qoftë se është zonë turistike, çka, ka me pas një objekt sportiv një stadium, a ka me pas një fushë, a ka qenë me gurë, sa ka me qenë e ngritur, sa a me dru, a me çka e tjera. Tash, ne mundemi me të i drejtohem qeverisë me një kërkesë për zonat të cilat janë të parapara me PZHK, edhe me vlerësimin strategjik mjedisor kur kalon, HZK-ja, mundmi me iu drejtu me një shkresë që këto parcela të kalojnë në menaxhim të komunës. Ata sigurisht se kanë me thanë po, por duhet me i ndjekë rregullat. Pra, cilat janë rregullat? Nuk të jep veç fort mu qenë ndonjë kryeministër shumë i fortë edhe qeveri shumë unike për me ta dhënë një mundësi sikur na kanë dhënë shtatë hektarë për stadium apo të japin diçka ose diçka që qeveria e vlerëson që është interes strategjik, ia japin një komune me vendim, konsultohen me AKP-në e tjera, edhe ndoshta pa kompensim. Mirëpo, ligji parasheh që me pas këmbim, ose me pas shpronësim, ose me pas blerje edhe krejt ato procedura përsëri duhet me i ndjekë. Edhe unë nuk besoj që ka me pas telashe Burim, pesëqind hektarë që i ka parapa PZHK-ja për këto plane për zhvillim të komunës, mirëpo keto pesëqind hektarë ose kemi këmbë, ose kemi me i ble, në qoftë se janë të AKP-së Agjencionit Kosovar me njëzet përqindë që duhet me i shpronësu. Pra, janë disa modele, mirëpo me bo me pas ndonjë qeveri që është e fortë, thotë merrni krejt se s'po na duhen hiç, a na me shkresë nuk pretojmë. Po, e fortë në kuptimin figurativ, po them, nuk po them unë mu rreh me dikën, po e fortë në kuptimin figurativ thotë po i duhen komunës, i ka të parapamë në PZHK, edhe i duhet për zhvillim ekonomik a zhvillim sportiv a zhvillim të komunës, zhvillim të gjithmbarshëm edhe ia japim komunës menaxhim.

Kryesuesi - Faleminderit, kryetar! Në qoftë se nuk kemi ndonjë diskutim tjetër, e kalojmë në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është për, kundër, abstenim, konstatoj se me shumicë votash votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e pestë.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ri-destinim të mjeteve.

Afrim Limani - I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, asamblistë dhe gjithë te pranishmit në salle. ridestinimi i mjeteve financiare është i përcaktuar me Ligjin e financave publike dhe

përgjegjësi dhe ne si komunë do të thotë e kemi shfrytëzuar këtë të drejtë, sepse në mënyrë që të mos rrezikohen në shumën prej 40,722.00 €, edhe 20.000 € do të thotë mjete nga të hyrat vetanake, atëherë e kryejmë këtë proces, do të thotë rrit destinimin në shumën prej 60,722.00 €. Sipas një udhëzimi të ri, do të thotë administrativ, i cili ka dalë në vitin 2022, i cili thotë që ato programe që brenda vitit fiskal kanë përfutur një herë, do të thotë nuk kanë të drejtë dy herë të përfutojnë. Kështu që neve si komuna na kanë mbete vetëm 2 drejtori, Drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Për atë jemi orientuar që këtë ridestitim, do të thotë prej 60,722.00 €. , ta bartim në kuadër të këtyre dy drejtorive. Do të thotë shuma prej 9,988.00 € e kemi bartë në Drejtorinë e Shëndetësisë në kuadër të projektit blerja e auto ambulancës në Krushë të Madhe, sepse realisht ne në shumën prej 100.00 € e kemi paguar një kontratë, mirëpo na kanë ngel edhe 10.000 € pa paguar, atëherë do të thotë e kemi bërë ridestitim në kuadër të këtij projekti. Pastaj, edhe 20.000 € janë të bartur, do të thotë të ridestitume në projektin renovimi i objektit të vjetër të QMF-së që e kemi në kontratë, do të thotë në mënyrë që të paktën ta zvogëlojmë kontratën. Dhe shuma prej 30,724.00 € është në ndërtimin e rrugëve fushore në Kramavik, Xërxe, Drenoc, Opterush, do të thotë në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë. Të nderuar, asamblistë kërkoj nga ju që ta votoni këtë pike të rendit të ditës.

Rasim Fazliu. Faleminderit, kryesues! E falënderoj drejtorin për prezantimin e kësaj pike. Jam i vetëdijshëm që komuna ka dëshirë ti kryej krejt punët, po nuk ka buxhet, as mjete, krejt ti përfundoj, përherë nevojat janë të mëdha, mirëpo ndoshta është më mirë që kryetari dhe ekzekutivi, bashkë me neve, ta bëjë njëfarë shpërndarje, si me thanë pakës si të barabartë për qytetarët, se të gjithë janë qytetarë të Komunës së Rahovecit. Konkretisht po flas për fshatin nga vij unë, jo pse jam prej Celine, po e vërteta është që asnjë objekt shoqëror në fshatin Celinë nuk e kemi, nuk kemi AMF, as QMF, as çerdhe, as stazë për ecje, as shtëpi të kulturës, asgjë. Është mirë mu u interesu edhe me bërë diçka në këtë drejtim, ta zëmë një stazë për ecje. Kështu që unë konkretisht po propozoj është një rrugë që lidhet prej varrezave të dëshmorëve që i kemi, e keni hap para dy vitesh pasi që keni punuar atë rrugë që del te rruga Fortesë te Mella, e cila është asfaltuar nëpër vreshta. Ky segment të lidhet diqysh, qoftë një herë të shtrohet me zhavorr me diçka e më pastaj, edhe kur të vjen rëndi edhe me kubëza, apo asfalt, por së paku të jetë e kalueshme për qytetarët e komunës e konkretisht të fshatit Celinë. Prandaj, kisha propozuar që këtu tek pika dy 2.2, ku është prej shërbimeve publike që këto mjete që barten që po transferohen në programin Bujqësi pylltari zhvillim rural, domethënë projekti o ndërtimi i rrugëve fushore Kramavikë, Xërxe, Drenoc, Opterushe, Krushë e Madhe, është mirë që me të futet kjo rrugë, pra të barten mjeteve edhe mundësisht me u bo diçka në këtë drejtim, se me të vërtetë jemi shumë keq. Domethënë, nuk kemi kah me lëvizë, nuk kemi kah me ecë. Edhe kështu që disa vite asnjë rrugë s'u bë fushore, që të jemi të qartë, pa dashur me mohu diçka. Kështu që mos e merrni për të keq, por realiteti është ky.

Kryetari - Faleminderit, Rasim! Faleminderit, ndërkohë drejtori i financave e qartësoi se ku kemi mundësi me bo lëvizje të mjeteve dhe cilat drejtori, në cilat drejtori janë dy drejtori që s'kanë përfutur dhe ligji udhëzimi i ri administrativ e parasheh që në ato drejtori mund të ketë lëvizje. Njëra prej tyre është Drejtoria e Bujqësisë, e unë ju kam thanë këtu që në rrugë fushore kemi pas ngecje sidomos në këtë zonën që lidhet me dy kompani të cilat nuk kanë tregu mjaftueshëm përgjegjësi me i krye punë të veta në rrugë fushore prej Krushës, Nagavcit, Hoçës Vogël, Brestocit, Celinës pastaj Opterushe, Zoqisht, Reti e poshtme, Reti e epërme. Tash te shpërndarja e buxhetit unë besoj që jo vetëm që është në mënyrë proporcionale, po edhe në mënyrë racionale, kështu që bukur mirë është i shpërndarë buxheti dhe projektet unë nuk dua me hy me tregu se çka po ndodh në Celinë, ose çka ka ndodh me një zonë tjetër të banuar, po mundem me thanë që rrugët fushore ne i kemi prioritet edhe rrugët në përgjithësi poashtu edhe Rrugicat i kemi prioritet, po në këtë rast është vështirë me bo lëvizje tjera, përveç kësaj çka e kemi çka ka paraqit drejtori financave. Në Celinë, bie fjala është ndërtuar një shtrat i proit, janë varrezat krejt më para e komunës, pa participim, është e fusha sportive, është efienca e energjisë në shkollë, janë disa projekte ndriçimi publik tash me drita digjitale nga ESKO, që janë drita standarde, janë disa zona që po përfutojnë, qyteti ka filluar të përfutoj, po ndërrohen dritat edhe në qytet. E kështu që po mendoj që nuk është e arsyeshme dhe nuk është e mundshme me bo ndonjë lëvizje në ridestitim të mjeteve. Unë i ftoj

anëtarët e Kuvendit që këto 60,000 € që janë propozimi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtorit Afrim Limani të ja miratoni, sepse do të ishte mirë ndoshta po të kishim pasur më shumë mjete dhe mundësi, ndoshta kishte me qenë edhe e arsyeshme me bo ndonjë lëvizje dhe ndryshe. Tash ne në fakt po hyjmë në pikën për buxhet edhe aty flasim ma konkretisht për detaje. Ndërsa, i ftoj anëtarët e Kuvendit me që ta votojnë ridestinim e mjeteve, po ashtu Shpija e Kulturës, po ma rikujtoj, Afrimi, veç që s'ua lidh kontrata ndoshta edhe u shpall fituesin. Pra, nuk është që s'po investojmë diku e po investojmë tani shumë diku tjetër. Unë besoj që Celina është njëri prej vendbanimit që ka përfituar më shumë në investime kapitale. Unë kam shumë miq në Celinë, njërin prej tyre e kam edhe Rasimin, po Celina vetëm këtë vit i ka tri-katër projekte kapitale që ndoshta nuk i ka ndonjë vendbanim tjetër që i ka ra hise që është kështu.

Merisa Sharku - Faleminderit, kryesues! Unë s'e kam shumë të qartë. Një pikë këtu që po e shohim të ri destinimi është ë bartja e ridestiniimi i mjeteve nga programi i shërbime publike, mbrojtje civile në programi Infrastrukturë Publike, kodi XX, fondi burimor nga investimet kapitale, krijimi i parkingjeve në rrugë Xhelal Hajda, Gëzim Hamza në Rahovec, shuma prej 20.000 € i transferohet programit për shëndetësi shërbimet të shëndetësisë primare, rinovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec, shuma prej 20.000 € i transferohet. Nuk e kam të qartë, janë ndërtuar parkingjet edhe ju kanë ë tepruar këto mjete apo nuk kanë filluar fare parkingjet me u ndërtu edhe ë ka mungesë te rinovimi i objektit të vjetër të QKMF-së edhe po i dërgoni atje paret apo qysh është çështja? Faleminderit!

Burim Krasniqi - Kryetar, ngjashëm e tha Merisa, që Ridestiniimi i mjeteve është nevojë, të ndodhë. Nuk ka arsye që sidomos granti qeveritar të shkoj në suficit, po duhet me mbet, kurse tek pjesa 20,000-euro të hyre vetanake munden me u bartë edhe për vitin e ardhshëm dhe nuk është diçka që rrezikon shumë financiarisht Komunën. Po, atë që e tha Merisa, po pojtohna diçka me thonë prej fillimit, nuk ka një arsyeshmëri kur thua që këto mjete dua m'i hekë prej këtu atëherë duhet të tregoni një arsyeshmëri se pse po i heqni nga aty? Edhe Objekti i QKMF-së është përruar sa e di unë. Kam pa që u pre shiriti i përrurimit të objektit të QKMF-së. Unë them, ok. Më mirë me thonë, janë obligime që duhet të i kompensojmë, e ngjashëm është edhe te kanali i ujërave atmosferik për ujërat në rrugën “Xhelal Hajda-Toni” edhe tek dëshmori “Sheh Myhedini”, 40.000 €, pra edhe aty, në qoftë se është bo një punë, nuk po mbërri me shku tutje, ka nevojë për me u zhvendosë këto mjete financiare me i ridestenu që të vazhdoni me mjete tjera në vitin e ardhshëm si projekt në vazhdim edhe tek rrugët fushore, unë e kuptoj se me 30.000 € s'bëhen krejt këto rrugë, por është kodë buxhetor që të obligon me përdorë të njëjtin titull, pasi që sa bëhen me 30.000 € rrugë fushorë , po ta lexon dikush në Kramovik, Xërxe, Drenovcë, Opterushe , Krushë e Madhe, thotë koka dy centë kubik i zhavorrit për me muajt me bo këtë punë. Pra kërkoj mirëkuptimin tuaj që kur të vjen një propozim që me na ardhë me një arsyeshmeri se pse po e bëjmë këtë.

Kryetari - E qartësoj edhe Burimi, por unë dua ta provoj me i dhënë përgjigje Merisë. Por nuk kanë ndodhë me parkingjet. Pra, diçka që s'po kryhet në këtë rast, parkingjet e reja, për shkak se po ndërtohen tek sheshi, ku parasheh dyqind e sa parkingje, dhe nuk ka hapësira mjaftueshëm aty ku është planifikuar dikur, është provuar edhe më herët, kemi provuar në rrugën, një drejtimeshe te shkolla Isa Boletini, por nuk kanë lejuar banorët me bë shtrimin e rrugës, edhe jemi pajtuar veç rrugën njëkahëshe po janë krijuar edhe disa parkingje aty. Aty nuk janë shpenzuar mjete, sepse veç u bo shënjim. Në rrugën “Xhelal Hajda” janë parapa po ashtu parkingje në këtë pjesën, po nuk parashihet me ndodhë një ndërtim aty edhe nuk ka nevojë për parkingje, sepse parkingjet po le të themi po koncentrohen në sheshin qendror. Prandaj këto mjete pse të shkojnë në suficit edhe i ri destinon, kur i destinon, në riparimin edhe të brendshëm, po edhe të jashtëm të QKMF-së. Objekti i QKMF-së është riparuar brenda, që është e mundshme me pas edhe borxhe, po është edhe faza e dytë riparimi i jashtëm i objekt që është tu ndodhë, e që na natyrisht hyjmë në obligime, sepse është kontratë. Ato mjete, prej kategorisë së infrastrukturës publike, shërbimin publik i çojmë në QKMF ose në Drejtorinë e Shëndetësisë. Në rrugën Xhelal Hajda -Toni është kryer projekti. A është ideja se këto mjete ne duhet me i destinu aty ku shpenzohen, jo aty ku shkojnë në suficit. Dhe ligji na ka lejuar. Do të ishte mirë me pasë edhe rishikim të buxhetit, po s'ka pas rishikim, për shkak se s'na ka lejuar Qeveria, pasi se ka bo as vetë rishikimin. Tash ridestiniimi është pika e

fundit, pika e kthesës, ku ti mundesh me operacionalizu buxhetin, ose me riorganiz buxhetin aty ku s'ke mundësi të veprsh. Janë edhe do mjete tjera aty që i keni pa edhe vetë. Tash në disa drejtori na s'mund të qesim mjete, sepse kanë përfutur një herë me bartje të hyrave. E tash s'ke drejtë në të njëjtat drejtori, por në drejtori ku ki mundësi me bo shpërndarje. Realisht edhe një herë po ju them, ne mundemi me bo debat shumë, po këto 60.000 € unë ju ftoj me votu, për shkak se janë të arsyeshme, po unë jam dakord që duhet me bo arsyetime më shumë, dhe kur ka vendosë me i ridestinu drejtorja e financave ekzekutivi, duhet me i pas edhe këto argumentet shoqëruese për me ditë ku dhe pse po ndodh kjo

Hasan Përboqi - Faleminderit, kryesues! Përsëndetje, kryetar kryesues, nënkryetarë, kolegë e asamblistë, drejtorë të drejtorive, qytetarë të pranishëm, media e monitorues të kësaj seance. Në emër të grupit, unë e mora fjalën sqaroj dhe të japë kontribut më shumë këtij diskutimi. Ne i kuptojmë kërkesat, kërkesat dhe nevojat që vijnë nga të gjithë, por duhet kuptuar edhe fakti që këtu bëhet fjalë 60.000 € edhe ata pak që kanë përvojë me investimet publike e dinë që me 60.000 € tash s'ki kah i çon, me thanë ë popullorçe. Por, në anën tjetër duhet ta kuptojmë faktin që ma mirë këto 60.000 € me i ridistinu nëpër këto projekte, se besoj që drejtori i financave e din më mirë ku i ka ë punët më ngushtë në projekte kapitale. Pra, edhe një herë besoj që është më mirë këto 60.000 €, me i ridistinu, sepse nëse shkojnë në suficit janë shumë, ndërsa nëse i shpenzojmë ndoshta edhe nuk na dalin për arsye se janë vetëm 60.000 €. Pas kësaj pike e kemi buxhetin, i ftoj më gjithë edhe në buxhet me i paraqitë kërkesat e shqetësimeve që i kanë. I fotjë të gjithë asamblistët, Aleanca do ta përkrahë këtë ë ridistribimin të mjeteve, por i kisha ftuar edhe asamblistët e partive tjera që të veprojnë kështu.

Bejtullah Deliu - Faleminderit! Unë pajtohem paraprakisht se duhet të kemi material shtesë për sqarime, po njëkohësisht nuk pajtona me shëfin e Grupit të Aleancës që thotë janë vetëm 60.000 €. Do të thotë, në vlera nominale besoj edhe një euro që është i buxhetit ka peshën e vet. Nuk mund të bazohemi, janë pak e hajde t'i votojmë e mos të shkojnë atje. Do të thotë, ne kërkuam vetëm sqarime shtesë se ku do të shkojnë dhe pse ndodhin këto ndryshime, a janë borxhe, a janë kryer punë apo po kryen punë. Do të thotë, sqarimi rreth bartjes së mjeteve, po asnjëherë nuk duhet në taksat komunale të thuhet vetëm 60.000 € apo janë gjashtë milion apo gjashtë euro. Vetëm kjo është.

Vlora Vuçitërna - Përsëndetje! E kam një pyetje. Meqenëse këto mjete duhet të ri destinohen prej një kodi, në kod tjetër, a mund të ri destinohen për renovim të ndonjë AMF ose QMF tjetër në komunën tonë, ma konkretisht gjendja në AMF të Xërxe-së ishte e mjerueshme.

Afrim Limani - E thashë që në fillim, do të thotë kur e prezantova këtë pikë të ri-destinimit për shkak të një udhëzimi të ri administrativ që ka dalë në vitin 2022, ato programe, tash në këtë rast, drejtoritë të cilët kanë përfutur gjatë vitit fiskal, nuk kanë të drejtë dy herë brenda vitit. Të gjitha drejtoritë tjera, me bartjen e mjeteve, e dini edhe ju që keni votuar, kenë përfutur. Do të thotë, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Urbanizmi, Kultura, pra kane ngelë bujqësia edhe shëndetësia. Atëherë, më e logjikshme ka qenë që mjetet që janë nga Drejtorja e Shërbimeve Publike. Pse m'i bartë na në drejtori tjera, megjithëse ky ka plot shteget që duhet me m'i mbyll. Mirëpo, ky s'ka të drejtë, tash në këtë rast të përfutoj, na ka ngelë do të thotë shëndetësia edhe bujqësia. Për AMF, ne kemi konsideruar do të thotë bashkë me Drejtoreshën e Shëndetësisë, se paraprakisht unë i pyes edhe drejtorët, do të thotë më i nevojshëm është ky projekt me financu. Renovimi i AMF-ve do të thotë e kemi në kontratë, me sa e di unë u lidh edhe do ta filloj punën. Do të thotë janë të gjitha AMF-të që janë në kuadër të Komunës së Rahovecit. Po, tash duhet ta shfrytëzojmë rastin edhe me dhënë edhe përgjigje. Do të thotë të gjitha këto mjete, 60.000 €, janë në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Unë konsideroj që e dhashë arsyetimin shumë mire Bejtë, vetëm harrova me thënë pse janë marrë nga Drejtorja e shërbimeve Publik këto mjete. Do të thotë këtu i kemi 40.000 €, këtu rrezikohemi pasi që njëzet mijë euro janë nga të hyra vetanake. Nëse nuk shfrytëzohen atëherë barten vitin e ardhshëm. Në mënyrë mos me u rreziku, do të thotë e kemi bërë këtë proces ridistribimit që e kemi shfrytëzuar Ligjin e financave publike dhe përgjegjësi, pasi këto mjete janë nga ndërtimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik në qytet. Ky kod, si kod, do të thotë unë nga viti 2021, ne e kemi realizuar një projekt në kuadër të këtij kodi. Vitin e kaluar nëse ju kujtohet, e kemi buxhetuar që me ruajte si kod që eventualisht drejtori ka parapa edhe disa punë. Mirëpo, në këtë rast, fati jonë i mirë e

kemi përfituar një projekt ndërtimi i rrugëve nga Ministria e Infrastrukturës edhe për atë atëherë këto mjete kanë mbetë. Pse të rrezikojmë ne, atëherë po i ri destinojmë. Procesi i ridestinimit prej një programi në program tjetër në total të buxhetit tonë është 15%. Sikur të kishte qenë në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, do të thotë qind për qind. Po, ne e kemi llogarit ato edhe vlera e cila do të ri destinohet e kap atë përfshirjen e mundshme. Pra na kanë ngelë dy drejtori, do të thotë bujqësia edhe shëndetësia. Për atë unë kërkoj edhe një herë që ta votoni këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi - Faleminderit, drejtor! Në qoftë se nuk kemi diskutime tjera, e kalojmë në votim këtë pikë. Atëherë, kush është për, kundër, abstenim, me shumicë votash votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e gjashtë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2024.

Kryetari – E di që të gjitha veprimet aktivitetet, hapat në pajtim me ligjin janë ndërmarrë dhe kemi ardhë në një pikë ku sot buxhetin për vitin 2024, projektbuxhetin për vitin 2024 e keni pikë të rendit të ditës në Kuvend. Sot është data njëzet e gjashtë, e kemi kaluar qarkoren e parë buxhetore që është dokument që ka ardhur prej Ministrisë së Financave, është diskutuar qarkorja e parë këtu edhe në Kuvend. Informacion është dhënë, është diskutuar edhe këtu. Pastaj ka ardhur qarkorja e dytë, qarkorja e dytë ka parapa disa lëvizje, ju e dini çka janë qarkoret buxhetore, ato prodhohen nga Ministria e Financave dhe i caktojnë kufizimet ose tavanet buxhetore edhe sa ka buxhet një komunë, sa një komunë tjetër, sa ka grante një komunë, cilat janë projektet e asaj komune, sa ka të hyra vetanake një komunë, sa planifikohen të hyra vetanake, sa ka mallra shërbime, sa subvencione, sa shërbime komunale e tjera. Sipas qarkores së dytë buxhetore, buxheti për vitin 2024, sipas Ministrisë së Financave për Komunën e Rahovecit parashihet me qenë 19,840,786.00 €. Pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë euro prej tyre janë investime ose projekte kapitale, tetëqind e nëntëdhjetë mijë euro janë subvencione, treqind e nëntëdhjetë mijë euro janë shërbime komunale, dy milionë e katërqind e gjashtë mijë e treqind e katërdhjetë euro janë mallra dhe shërbime dhe dhjetë milionë e katërqind e shtatë mijë e treqind e katërmëdhjetë euro janë paga. Buxheti është diku nëntëdhjetë milionë e tetëqind e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë euro. Mirëpo, për atë e thashë se kjo qarkorja e dytë buxhetore është të themi ai dokumenti që e precizon, këtë nuk na keni ikë para, po këto shërbimet rezidenciale, se këto terma forte unë nuk i marr vesh, edhe po më duket i kem të importuara nga jashtë, këto domethënë diku i kanë kalkuluar ndryshe, i kanë fut në buxhet, por ne nuk kemi rrënje të buxhetit, po kemi atë buxhet, po tash i përkthyer në këto kategori është qysh e thashë ma herët ndërsa në total është 19,840,786.00 €. Ju po e shihni që mbi gjysma e buxhetit shkon paga, dhjetë milionë e katërqind e shtatë mijë e treqind e katërmëdhjetë euro. Po ashtu, unë e kam edhe një raport nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projektbuxhetin e komunës për vitin 2024, nga njëqind e dy dyzet e katër kërkesa, nevoja, interesa të shprehura në këto dëgjime buxhetore, njëqind e njëzet e pesë janë të pranuar, që i bie 86.81%. Të pranuar pjesërisht janë dymbëdhjetë që i bie 8.33% dhe të papranuara janë shtatë që i bie 4.86%. Cilat janë kërkesat e papranuara? Kërkesat e papranuara nga dëgjimet buxhetore janë kryesisht kërkesat të cilat lidhen me përgjegjësitë ose detyrat e detyrimet që i kanë operatorët tjerë, në këtë rast KRU Gjakova, Si ndërmarrje Publike, KEDS-i apo diçka i gjashtë. Pra, ne nuk mundemi të konsiderojmë të mirëqenë e të pranuar një kërkesë kur nuk varet prej neve edhe kur s'ka as në kapacitetet tona vendimmarrëse e as buxhetore s'është. Në këto raste duhet të jenë të pranuar këto kërkesa, në qoftë se ne jemi më insistues edhe ua mbushim mendjen atyre që janë kompetentë me që ti kryen këto punë, në rast KEDS-it e KRU-së apo IPKO-s, VAL-s, mund të ketë edhe kërkesat e kësaj natyre. Por, kryesisht janë dy që e kanë dominuar. Kërkesat që lidhen me ujë edhe me energji elektrike, qoftë ndaj trafo, qoftë ndaj diçka e ngjashëm. Me KRU- Gjakovën kërkesat të cilat munden me qenë në ndërlidhje me KRU- Gjakovën, na kemi edhe memorandum mirëkuptimi edhe marrim pjesë, participojmë me 49%. Ndërsa, ajo që s'është konsideruar e pranuar një nga kërkesat që ka dominuar nga dy-tre persona ndoshta i keni edhe në raport të paraqitura, janë rrethojat e shkollave. Për këtë projekt ne sivjet nuk kemi të parapamë ndaj kontratë, po me bartje të hyrave mundemi diku nga shkurti i vitit dy mijë e njëzet e katër, mund me parapa hapjen e një kodi, që ka të bëjë me rrethojat e objekteve shkollore. Pra, disa shkolla kërkojnë oborret e tyre të i rrethojnë, edhe tash ne nuk kemi

mundësi sivjet dhe nuk mund me qenë joserioz sa me pranë ose me bo kategori të projekteve të buxhetuar në këtë vit. Po, mundet të fillojë me ba të buxhetuar nga viti i ardhshëm. Ku konsiston buxheti, konsiston në përmbushjen e prioriteteve të cilat janë të komunës së Rahovecit në këtë periudhë katërvjeçare. Çka synojmë me bo me këtë buxhet për vitin dy mijë e njëzet e katër? Synojmë m'i dobësu, jo m'i zvogëlu ma mirë me thanë, m'i zvogëlu obligimet të cilat i kemi kontraktuale, obligimet financiare që krijohen në vazhdimësi të i përfundojmë kontratat të cilat janë më të hershme dhe synimi i një pjesë të madhe të mjeteve buxhetore i marrin projektet e mëdha. Cilat janë projektet e mëdha prioritare? Është sheshi qendror në qytet, janë shtretërit e lumenjve, janë rrugët e rrugicat, janë kanalet e kullimit të tokave bujqësore, janë shkollat ose ndërtimet e objekteve shkollore në komunën tonë, që i kemi dy në këtë rast, po dy po janë kërkojnë shumë buxhet, një në Xerxë dhe një në Ratkoc. Pra synimi është të mbulohen kontratat të cilat i kemi me projekte që kanë kosto më të lartë financiare. Synim tjetër është m'i të i zvogëlojmë obligimet që i kemi në ato kontrata. Synim tjetër është ti paguajmë shpenzimet ose borxhet të cilat i kemi ose obligimet të cilat janë krijuar si pasojë e lidhjes së kontratave me këtë komunë. Pra, ky buxhet parasheh edhe projektet të reja, po parasheh edhe ato që e thashë deri tash. Unë shpresoj që ky buxhet, nuk është i mjaftueshëm, fatkeqësisht nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë prej nevojave, kërkesave që kanë qytetarët, po gjithsesi është buxhet i cili konsiston në ruajtjen e qëndrueshmërisë së komunës tonë, po edhe njëkohësisht mundësive të reja për zhvillimin e plotë aktiviteteve që i dedikohen investimeve publike në komunën tonë. Nuk është ë buxhet i cili kryen të gjitha nevojat, siç e thashë edhe i plotëson të gjitha kërkesat, mirëpo nga dëgjimet buxhetore ne kemi marrë plotë prej shqetësimeve të cilat i kemi dëgjuar aty për aty, i kemi përfshi në këtë buxhet edhe besoj që ky buxhet ë ka me qenë është pak më i madh sesa i këtij viti edhe po shpresojmë që edhe me ndihmën e granteve të tjera, projekteve shtesë, edhe donatorëve ne mund të kemi edhe aktivitete të cilat nuk janë të parapara me buxhetin e vitit 2024. Sikurse e patë më herët në pikën e ri-destinimit të mjeteve financiare, ju e patë që ne kemi fituar një grant me ministrinë dhe duhet me i heqë nga dyzet mijë, për shkak se janë pjesë e një projekti që e kemi fituar me ministrinë. Ne mund të kemi kësi situata të cilat i kontribuojnë zhvillimit edhe përballimit më të lehtë të sfidave që ka komuna jonë në procesin e zhvillimit edhe ndërtimit të vet. Unë e di që debati duhet të zhvillohet edhe do të jetë konstruktiv, e di që edhe plot prej përgjigjeve më interesante, më të sakta, më të detajuara keni me marrë edhe prej drejtorit të financave, po sigurisht në dispozicion janë edhe drejtorët e drejtorive të tjera që mund t'i specifikojnë pse këto mjete janë kaq në këtë projekt, e pse kaq në këtë kod e kaq në kohët e tjera, për secilin ne kemi përgjigje edhe besoj që krejt në fund unë tash po ju them që do të ishte tepër e rëndësishme që bashkë nga kjo sallë ë të dalim me lajmin që është miratuar buxheti i komunës së Rahovecit, pikërisht me datën njëzet e gjashtë, se i kemi edhe pak ditë kur na mbetet që ti kompletojmë edhe disa shënimet e fundit, tej regjistrimit e fundit që i bën Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe mu harmonizu me Ministrinë e Financave dhe Departamentin të Buxhetit për Buxhete Komunale, që është mekanizëm në kuadër të Ministrisë së Financave. Do të ishte mirë me pas buxhetin edhe dy herë më të madh sesa e kemi tash, mirëpo kjo është pozita e financiare e Kosovës, pozita buxhetore e Republikës së Kosovës dhe sipas ligjit edhe sipas formulës neve kaq na takon, kaq na ka ra hise për vitin 2024 nga granti dhe sigurisht që edhe unë po besoj që e kemi edhe një mundësi që ju e dini që jemi fort mirë me të hyra vetanake sivjet dhe jemi në prag të lajmit të që ta marrim lajmin për fitimin e grantit që mund të jemi pasi po konkurrojmë për të parin ose të dytin vend në Republikën e Kosovës, kemi dorëzuar aplikacionin për grant dhe ai grant mund të jetë ndoshta diku mbi dy milionë euro, që shpresojmë që do të përdoret për lehtësimin buxhetor për vitin dy mijë e njëzet e katër duke i marrë edhe për bazë edhe rritjen e të hyrave, tejkalimin e planit të hyrave, po edhe grantin që po e presim, mezi po presim që ta fitojmë nga donatorët që janë Qeveria Suedeze, Norvegjeze, Zvicëranë dhe Ministria e Administratës, sikurse edhe Ministria e Administrimit Pushteti Lokal, sikurse edhe komisioni evropian që janë pjesë këtij le të themi konglomeratit të donatorëve që ju japin mundësi komunave që i plotësojnë kriteret dhe kushtet për performancë.

Afrim Limani - Dua mu lidh vetëm te një rast, do të thotë dallimi i buxhetit në mes të dy qarkoreve buxhetore, do të thotë se ne sipas qarkores së parë buxhetore e kemi deklaruar se buxheti është e njëzet milion e tridhjetë

mijë euro, po faktikisht në qarkoren e dytë buxhetore situata ka ndërruar, sepse shërbimet rezidenciale të cilët janë me një faqe tjetër, që janë parapa për Komunën e Rahovecit, ne kemi menduar që ato mjete do t'i financon apo do t'i buxheton Ministria e Financave, por realisht ajo situata ka dalë ndryshe dhe ajo shumë do të thotë e ka zvogëluar buxhetin në shumën prej dyqind e tridhjetë mijë euro, që realisht tani buxheti është nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind e katërmëdhjetë mijë euro. Çka përmban ai projekt? Ai është një projekt kapital, që parashihet për persona nëpër nevoja të veçanta. Do të thotë, fjala është diçka në ndërtim, por tash e tutje ne do ta shohim si është gjendje atje dhe do të thotë do t'i marrim veprimet e nevojshme. Tjetër, çka desha të them rreth buxhetit, do të thotë buxheti është më i madh në krahasim me vitin e kaluar dhe ky ndryshim është kryesisht në pozicionin e pagave, ndërsa në investime kapitale është e njëjtë. Ajo çka është ma kryesore është sepse të gjitha kërkesat e qytetarëve, edhe që vetë kam qenë do të thotë pjesëmarrës në dëgjime buxhetore, të gjitha ato kërkesa janë të involvuara do të thotë në kuadër të investimeve kapitale, me përjashtim disa kërkesa të cilat nuk janë në kompetencë tonë dhe fjala ke edhe tek rrethojat e shkollave që parashihen që me bartjen e mjeteve të vitit 2024 do të thotë të futet edhe ajo kërkesë. Desha t'ju them edhe një informatë me rëndësi, sepse çdo kontratë ekzistuese në kuadër të investimeve kapitale është e mbuluar me buxhet, gjithashtu edhe me projeksionet e vitit 2024-2026. Diçka tjetër nuk kamë çfarë të ju them, pres ndonjë pyetje, kërkoj nga ju ta votoni këtë buxhet.

Leonard Morina - Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin drejtorët të drejtorive të gjithë pranishmit. Propozoj që kjo pikë të vazhdojë, pas pauzës, për shkak se tani është koha e drekës edhe po shihet që është krijuar monotoni, kështu që nëse vazhdojmë, besoj që shumica kanë me dalë jashtë edhe keni me mbet pa kuorum. Kështu që po e vazhdojmë drekën, pastaj kthehem për pikë të rendit të ditës, se kjo pikë donë diskutim të gjerë.

Defrim Kafexhiu - Faleminderit, kryesues! Vetëm dua ta japë një këshillë, që pavarësinë e ushtrimit të pozicionit nuk ta jep askush pa e dashtë vetë me fitu ata, pra duhesh me pa se si është disponimi në Kuvend edhe të vazhdosh me pauzë, sado pauzë e vogël që është. Mos u ndiko prej kryetarit, se me lënë për kryetarin deri ne mbrëmje na lenë duke diskutuar për buxhet. Buxheti është një çështje goxha serioze që lyp diskutim të shëndoshë edhe i shkon e udhës që me pas një pauzë paraprakisht. Faleminderit! Se përndryshe ne mundemi edhe të qëndrojmë edhe mos me të qëndrojmë, se me zor nuk po rrimë, por për me pas një diskutim të mirëfilltë mes dy institucioneve është mirë me pas pauzë ndonjë herë kur kërkohet.

Kryetari - E di që është vakti i drekës, edhe e di që jemi njerëz, por diskutimet thelbësore, diskutimet konstruktive, diskutimet serioze, besoj që secili asamblist është i kthjelltë, unë për vete po jam i kthjelltë edhe jam i kthjelltë edhe ju kisha lut, mirë është që të dëgjoni, në qoftë se doni edhe kthehem shaka ose disponim edhe për shaka kam sa doni, në qoftë se doni, kushdo. Si praktikë, mirë është kur dikush e lakon emrin e dikujt mos me dalë jashtë, unë natyrisht që nuk kam nevojë me përdor metoda ndikuese, krejt çka po provoj me i thanë Kryesuesit, veç u mundova me tregu që pa krye ekzekutivi ndoshta s'është mirë me marr fjalën asambleja, sepse unë ju thashë në fillim që është praktikë e shëndoshë, ndërsa të ndikoj s'kam nevojë bash te kurrkush hiç, as që provoj të ndikoj, bile bile as te drejtorët e drejtorive, këtu ishit dëshmitar kur ju thash që ofroni shënime të sakta edhe të mos bëni shumë llafe në Kuvend, se në qoftë se duhet me bo llafe po e bëj unë, drejtorët le t'i kryejnë detyrat e veta, s'po them që s'i kanë krye, por le t'i kryejnë për shkak mos me humb kohë. Unë e di që pauza është njerëzore të kërkohet dikush pauzë, edhe një njësoj njerëz jemi të tanë edhe unë jam njeri, po unë mendova që mirë është të kryhen diskutimet, po në qoftë se dikush është i lodhur, atëherë mundet edhe mos të flas hiç, edhe me vetë vlerësu vetë a me ngritë dorën apo jo. Por, po mendoj që meqenëse është pikërisht diskutimi për buxhetin, duhet të reflektojmë seriozitet më të lartë edhe në Asamble Komunale. Nuk provoj të ndikojë te kryesuesi, ai është i pavarur edhe keni me pa që ka me qenë pikërisht ma i pavarur se sesa që mendon edhe vetë edhe ka menduar dikush tjetër në këtë sallë, unë vetëm e ndihmoj procesin e kam ndihmuar edhe ma përpara, për shkak se dihet kryesuesi mundet të hutohet edhe mos me votu ndonjëherë. Se i thotë Burimi disa herë që edhe ti a ke të drejtë votu, i them edhe unë, se duhet me votu edhe ti se le të dihet kjo punë, se unë s'kam të drejtë votës, se ju keni të drejtë votës. Normalisht se unë mendoj që janë kontribute, unë

s'po kam një vend tjetër, se s'kisha kisha qëndruar hiç aty, po në qoftë se ma bëjnë një vend tek Drejtoria e Administratës, aty kisha qëndruar edhe nga atje kisha fol. Hiç. Ju tregova në pika themelore, ndoshta s'e dëgjova Afrimi që ju ka thënë, në pikat themelore ku konsiston ky buxhet. Mrekulli me këtë buxhet s'bëjmë, po plot sende ky buxhet na mundëson me i bo edhe plot sende tjera me tërheq edhe grande edhe projekte të reja edhe nga donatorët edhe nga Qeveria, nga Ministritë me marrë, sepse dhjetë milionë e diçka po shkon veç në paga, pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë euro në investime, ndërkohë që nevojat janë shumë më të mëdha. Po ju përmend edhe dy mundësi që i kemi, të hyrat po rriten edhe granti, na jep mundësi granti s'mund me përdor për subvencione, por për investime që mund të na shtohen qysh tash ndoshta një tre milionë euro, në qoftë se e fitojmë edhe grantin dy milionë, tre milionë euro i shtohen investimit, sepse edhe të hyrat po tejkalohen deri në fund të vitit ndoshta një milion do të shpërndahen nëpër projekte, të cilat ku kemi nevojë më shumë dhe që janë më prioritet. Unë e di që keni çka të flisni, në fund vendosni ju, po mirë është me ditë secili, unë e di besoj edhe ju e dini që në qoftë se ka ngjarje në një komunë, e ka shumë ngjarje brenda një komune brenda një viti kalendarik e viti fiskal, ngjarja më e rëndësishme për një komunë është buxheti i asaj komunë. Këtë e ka kuptuar me kohë Rasim Fazliu, s'e kam për replikë, po besoj edhe plot tjerë e kanë kuptuar sepse ky buxhet nuk është buxhet për një subjekt politik, as për një individ, as për një familje, është buxhet për qytetarët e komunës që ky që po e shihni e keni para vete, Sqarime jemi për me dhanë, kritika ka vend për kritika, hapësirë për arsyetime për argumentime ka edhe nga Kuvendi edhe nga ekzekutivi, kështu që jemi këtu, e në qoftë se ju doni me dalë, askush nuk e ju ndal kërkon me dalë, edhe unë dal me juve, s'është ndonjë telashe, po ideja është që nuk është mirë të provoj dikush me tregu sikur dikush ka nevojë mu kthjellë. Unë jam i kthjelltë dhe besoj i kthjelltë kam me qene, bile edhe kur të flejë në gjumë jam i kthjelltë, e lejo më kur jam para një përgjegjësi që kam.

Kryesuesi - Atëherë, kthehemi pas një pauze të shkurtër për të vazhduar me pikat e rendit të ditës, me pikën e gjashtë, lidhje me buxhetin për vitin dy mijë e njëzet e katër. Pas prezantimit të kryetarit dhe drejtorit për financa dhe buxhet, tani diskutimi është i hapur në lidhje me këtë pikë.

Burim Krasniqi- Faleminderit, kryesues! Faleminderit të gjithëve. Buxheti për vitin 2024, është i njëjti i vitit 2023. Mund me qenë si vlerë më e madhe, po si ndarje si projekt është i njëjti dhe në disa vende thuhet si projekt i ri që realisht janë projekte që kanë qene në vitin 2023 dhe të gjitha janë në vazhdim për vitin 2024. Në vitin e kaluar e kemi kërkuar që Buxheti me qenë i specifikun sipas projekteve, që secili asamblast, pa marrë parasysh prej cilës parti vjen, me ditë çka me ju thonë qytetarëve? E kam votuar një buxhet në Hoxhë të vogël, Guri të kuq, po aty e kam votuar buxhetin, sepse buxheti parasheh në vendin tonë ku vijmë këtë projekt me bë. Buxheti i vitit kaluar, po edhe ky i vitit 2024 nuk e ka këta. Edhe çka na bind ne si grup i Asamblastit të LDK-së që mos të pajtohemi me këtë buxhet, është që në seancën e viti të kaluar kur është diskutuar për buxhetin, na kanë sjell një listë të projekteve për investime kapitale, në formë fizike. Janë kanë dhjetëra projekte, dhe mos të thotë qindra projekte, po të gjitha kanë qenë vetëm dëshira dhe kërkesa të këshillave të fshatrave dhe të lagjeve dhe jo projekte të cilat ka pasur plan përnjëmend me realizu Komuna e Rahovecit, edhe pjesa dërrmuese e tyre kanë mbete vetëm letër, se s'kanë të bëjnë absolutisht me implementim. E njëjta gjë ndodh edhe me buxhetin e këtij viti. Është në fund tabelë e kërkesave që kanë dalë prej dëgjimeve buxhetore, që fatkeqësisht mungesa e respektit që janë tregu ndaj këshillave dhe fshatrave dhe kërkesave të qytetarëve, kemi ardhur në situatë ku më shumë kanë marrë pjesë përfaqësues të komunës sesa vetë banorët që kanë diskutuar për projektbuxhetin. Si e tillë, e kemi një rrethanë ku thotë po të gjitha pranohen, një numër shumë i vogël i kërkesave thotë nuk pranohen, po pranohen se ka lypë një rrugë atje dhe pranohet sepse ne e kemi një buxhet një kod buxhetor ku thotë ndërtimi i rrugëve dhe rrugicave. Po sa realisht i mbulon ajo? Komuna e Rahovecit, seancën e kaluar kemi diskutuar, ka rreth njëzet e dy milionë obligime kontraktuale dhe borxhe, që nënkupton veç këto kontrata të mbulohen duhen ja tri vite. Në qoftë se shkon plus ka dy milionë grant performancës edhe donacione. Nuk mundemi si grup i LDK-së me votu një buxhet edhe nëse na pyet ndonjë prej qytetarëve me thanë e kemi votuar një buxhet, janë do paret e investimit kapitale, po kah kanë me shkuar nuk e dimë, sepse thotë ndërtimi i rrugëve, po tani mbetet vullnetin e kryetarit cilën rrugë do me bo dhe cilën jo. Sikurse buxheti të kishte qenë i

specifikuar projekt për projekt, në premtim në raport me qytetarët, duke mos dashtë me i ndërhy ekzekutivi, se tek e fundit e ka marrë votën, po me e pa cilin projekt e bën dhe cilin s'e bën dhe me e pa qytetari qartë se a po mbahet fjala apo s'po mbahet fjala e premtimit që janë dhënë në fushatë zgjedhore, për projektet specifike në lagjet të caktuara edhe në fshatrat të caktuara, ne kishim votuar, sepse buxheti nuk është i kryetarit të komunës, është i qytetarëve. Por, kur ky buxheti i qytetarëve jep hapësirë të sjelljes për qejfe të dikujt, ku do ti qoje projektet, nuk është buxheti i qytetarëve. Kanë me u realizuar projektet për disa qytetarë, po ajo barabarësia mbetet në vullnetin e ekzekutivit. Në qoftë se Komuna e Rahovecit ekzekutivi ka vullnet që t'i rishikojë kodet buxhetore, jo në shuma, po në specifikim të projekteve një nga një, pavarësisht sa kemi peshë të votës, na e përkrahim si buxhet. Por, si tillë qysh është sot, grupi I Asamblistëve të LDK-së nuk e përkrah këtë buxhet, sepse është buxhet më shumë i formatit të lënies në vullnet të dikujt shpërndarjen, e jo në vullnetin e vendimmarrjes që e voton buxhetin. Asnjëri prej neve në Asamble, nuk mundet me i thonë një qytetari se ka me bo që kjo rrugë, as unë në Xërxe, as ai në Krushë, as në Celinë. Se tani varet vullneti i ekzekutivit a do me bo a s'do me bo. Nuk mundet me ngrit dorën pro diçkaje, e cila nuk jep përgjegjësi direkte të asaj që unë e votoj. Kështu që si e tillë, Grupi i Asamblistëve të LDK-së nuk e voton këtë format të buxhetit.

Kryetari - Faleminderit për mundësinë! Është e drejtë e secilit ta vlersoj se a do me votu projekt buxhetin për vitin 2024 apo jo. Tek e fundit, është vullnet individual, vullnet politik, po njëkohësisht është edhe vullnet individual, edhe vullnet politik edhe me votu buxhetin, i cili është buxhet i qytetarëve, nuk është as i kryetarit, as i ekzekutivit. E dyta, ne kemi mbajtur dëgjime buxhetore dhe ka ndoshta anëtarë të grupimeve politike që janë të zgjedhur me votë që s'kanë marrë pjesë në dëgjime buxhetore. Madje edhe kur i ka thirrë KPF-ja. vetëm një anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa ka marrë pjesë dhe kjo është përgjegjësi, tash është përgjegjësi publike, domethënë kur flet një shef i partisë në emër të partisë, nuk merr pjesë as nuk e bëj për replikë, të lutem, as vitin e kaluar nuk e ka votuar buxhetin dikush këtu, edhe është normale, mirëpo plot punë e projekte janë krye. As tani mundet mos me votu dikush, por plot punë e projekte kanë mu kry. Jo pse unë dua, por sepse ne kemi obligim. Jo pse unë po dua, si kryetar me ekipin tim, por se ne kemi zotime, kemi qëllime, kemi plane, kemi synime, kemi premtime publike dhe t'jua përkujtoj faktin që GAP-i, instituti që i mat premtimet, nëse mundeni me gjet edhe një komunë të Republikës së Kosovës që ka realizuar premtime për një vit e gjysmë më shumë se Komuna e Rahovecit, unë i jap dorëheqje sot. Pra, nga tetëdhjetë e katër premtime, tridhjetë e nëntë janë të përmbushura, plotësisht, pastaj njëzet e katër janë gjysmë të përmbushura, e njëmbëdhjetë janë të nisura, ndërsa vetëm nëntë janë të pa filluara. Pra, secila forcë politike, le të rezonojë edhe nga kjo pikëpamje, sepse ne kemi marrë mandatin me i përmbushë premtimet tona, të cilat ne kemi vlerësuar që janë premtimet e qytetarëve dhe e kemi marrë mandatin prej qytetarëve. Tash, a ka çka me i thanë dikush publikut e qytetarëve, apo s'ka çka me i thanë unë nuk e di, por unë e di që plot gjëra kam me ju thanë edhe plot vërejtje pres prej qytetarëve, por dikush ka mundësi që s'ka çka me i thanë bash kurrëgjë, për shkak se as që ka votuar buxhetin në 2017-tën, as në 2018-tën, as në 2019-tën, as në 2020-tën, as në 2021-tën, as në 2022-tën dhe as në 2023-tën s'po donë me votu dhe unë kur jam kanë në opozitë, grupit tim politik i kam thanë këqyrni çka të bëni, votoni buxhetin, kërkonin ndonjë send, por votoni buxhetin, sepse buxheti i një komune nuk ka të bëjë me dallime esenciale politike, nuk ka të bëjë me ndryshime përmbajtjesore në qasje, është buxhet për qytetarët, është buxhet për investime publike, e dimë sa është e na nuk jemi tu bo politika qeveritare këtu, nivelet qendrore, edhe megjithëse edhe klasa jonë politike, nuk o që ka shumë dallime, veç dallime shfaqen për konsum të brendshëm. Ai që është në opozitë mundohet me iu tregu diçka qytetarëve qysh unë me u pas kon në pozitë edhe shumë në rregull është, ndërsa ai që është në pozitë mundohet me iu përvetëso krejt ato që i bëjmë. Pra buxheti është mjaft mirë i analizuar, është mjaft mirë i shpërndarë, është buxhet i përgjegjshëm, i shpërndarë në mënyrë të përgjegjshme në bazë të prioriteteve dhe ne nuk mundemi me i ndryshu kodet shpesh. Na kemi biseduar këtu shpesh në sallë të Kuvendit për plot situata të cilat janë sfiduese edhe për projekte të cilat janë sfiduese, bile edhe sot kemi biseduar më herët për këtë temë. Në qoftë se dikush dëshiron me u ballafaqu me argumente, jam shumë i sigurt që, pavarësisht unë shumë e respektoj Afrim Limanin, të gjithë drejtorët, prej nënkryetarit dhe të gjithë juve, po ju siguroj që vetëm këtu 48 orë kurrë pa u ndalë, ju munda me

argumente, jo pse jam ma i fortë, dhe ju sfidojnë cilindo një drejtim, edhe hiç nuk më vjen marre me ju tregu që këtu kemi problem, këtu kemi sfidë, këtu kemi vonesa, edhe një, po du me ja thanë cilido që do me dëgju, pasi ka kohë që merrem me këtë farë pune. Pra, bashkë me Afrim Limanin, me drejtorët e drejtorive e kemi shti edhe në shqyrtim publik, dëgjime buxhetore, takojmë njerëzit e tjerë e të tjerë, takojmë të njëjtat njerëz që i takojnë edhe dikush tjetër, kemi bo analiza, kemi bo vlerësime, kemi nxjerrë përfundime, mos të mendon dikush që për një ditë mundet të ndyshoj buxhetin. Buxheti mundet të mos votohet, asnjë problem s'ka, po nuk mundet të ja ndryshosh mendjen lehtë, bindjen, përcaktimin, synimin specifik pse dikush do me bo për konsum të brendshëm. Nuk mundet për shkak se të gjitha argumentet të mira e të këqija, të gjitha përgjigjet që mundet dikush potencialisht të i kërkoj, ose eventualisht me i kërku i kam në xhep. Nuk po sillem me arrogancë, se kështu kam folur njësoj edhe flas njësoj, s'ka lidhje, i kam votat apo nuk i kam votat. Buxheti duhet mu votu, me vërejtje, me plotësime, me propozime, me ide. Buxheti duhet me ditë çka përmban, cilat janë projektet, specifikat, pra veçantit, cilësitë e projekteve, situatën me projektet dhe nuk besoj që ekipi im s'është i gatshëm t'i dhanë këto përgjigje. Mirëpo, blanko me dalë me tregu dikush a voton a s'voton edhe cilat janë synimet e një grupi politik, në rregull me është legjitime, po mua me ma mbush mendje jo, ai që flet kështu. Jo, besa edhe qytetarëve hiç se hiç, për shkak se thashë nga tetëdhjetë e katër premtime, tridhjetë e nëntë jeni komunave përreth edhe cilës doni komunë në Republikën e Kosovës, që dikush ka shkuar në vijën e premtimeve zgjedhore më mirë sesa komuna e Rahovecit. Dhe, kur jemi në këtë situatë, unë po mendoj kështu, ne do të debatojmë, unë i luta drejtorët, vetëm në qoftë se ka ndonjë pyetje specifike, konkrete, as mos mu përgjigj hiç, e qesim në votim, votohet mirë, s'votohet vazhdojmë, pra jeta vazhdon, nuk perëndon kurrgjë, domethënë nuk fiket askush, as komuna e Rahovecit nuk destabilizohet, edhe në qoftë se s'votohet buxheti. Po ta dini që ky buxhet është analizuar mirë dhe është me shumë kujdes, ndërsa parafolësi, se s'po du me përmend emrin, se e respektoj shumë, për mua s'ka nevojë me marr replikë askush, por ky ë s'ka marrë pjesë në dëgjime buxhetore që e ka e ka thirrur KPF-ja, anëtari i KPF-së, anëtari i një subjekti politik që pretendon me u ba kryetar komuna apo ministra, deputetë, çka pe di, kjo është joserioze. Në qoftë se unë s'kam marrë pjesë në disa dëgjime buxhetore që ato i ka thirrë, i ka organizuar kryetari i komunës, po drejtori për Buxhet dhe Financa, mos harroni, në ato takime ku duhet me qene kryetari, zakonisht marrë pjesë. Dhe tash edhe opozita e ka njëfarë shije, duhet me pas njëfarë që për me pa pas vlerë opozitare, duhet me marrë pjesë në dëgjime buxhetore, me i pa cilat janë kërkesat e qytetarëve, nuk jemi na prej atyre që i mashtrojmë qytetarët, sepse koha e ka dëshmuar edhe vota e ka dëshmuar që s'jemi prej atyre, nuk i takojmë atij koncepti të mashtrimit, ne i tregomë mundësitë buxhetore të cilat i kemi dhe e dimë saktë ku kanë me ndodhë veprimet. Kjo nuk është punë vullneti individual i kryetarit a me shtroj një rruga apo mos shtroj sepse unë nuk jam prej atyre që mua më tepron buxhet, për shkak se i kam bo kalkulime individuale ose kalkulime grupore ose kalkulime klanore ose kalkulime partiake. Jo kam thanë në këtë seancë po ju them edhe sot, nuk ka për mua rrugë e rrugicë te LDK-së, të PDK-së, të VV-së, të Aleancës. Ka rrugë rrugica, parqe e mjedise të bukura, kanalizim për qytetarët me qenë në shërbim të publikut të jenë të interesit të përgjithshëm publik. Nuk ka kurrgjë të përgjithshme, vetëm kodet janë, pasi ka edhe kode të përgjithshme, mirëpo planet edhe kontratat e përcaktojnë qartë cila rrugë do të shtrohet e cila rrugice jo.

Burim Krasniqi - Nuk kam dalë në foltore për me zënë ngushtë askënd edhe nuk ka nevojë me ja bajt derte as Burimit as LDK-së për politikat e tyre, se i dimë punët e veta. A humbim apo fitojmë është çështje jonë, është vendim i joni, nuk kemi nevojë për asnjë këshillë. Përndryshe kryetar, kryesuesin, është mirë me e pyet, dëgjimi buxhetor të KPF-së nuk e ka thirr KPF-ja, e ka thirrë kryesuesi vetë pa konsultë të KPF-së edhe vetëm kur e kam pa në saj të komunës edhe në Facebook. Unë e kuptoj që e keni bo shumicën e asamblistëve edhe të KPF-së ndoshta, po me një organizim ku tentohet injorohet kandidati apo anëtari qoftë i KPF-së, qoftë çfarëdo rrethana, unë nuk marr pjesë, kryesuesi e menaxhon takimin e KPF-së edhe thërret, por nuk cakton dëgjim publik në emër të KPF-së pa u konsultu ma anëtarët e KPF-së. Në qoftë se njërën prej anëtareve të KPF-së, së paku prej neve si opozitë, e ka konsultuar kryesuesi i Asamblesë Komunale, unë ju kam çfarë të dush borxhi. E

të thuhet ndryshe këtu në foltore, nuk qëndron dhe nuk lejoj. Për ata se ku po shkojnë ne LDK edhe sa paralizohemi lëna neve, mos na mbaj dertin.

Kryetari - Nuk pretendoj me i dhanë këshilla askujt, bile pres këshilla prej juve, se jeni edhe ashtu këshilltarë, edhe ai parafolësi është këshilltar, e pres ne këshillë, po nuk pretendoj me i ndërhy. Përndryshe, e din se ku të ndërhyj, tani unë jam buldozer, i kryej punët, edhe me parafolësin i kryej punë në kuptim të mirë të fjalës, po ideja është që vetëm që e di që KPF-ja e ka organizuar, si e ka organizuar nuk e di, po e di që vetëm një anëtar i KPF-së ka marrë pjesë. Po kryesuesi është kryesues i KPF-së, tash unë nuk e di. Njoftimin, tash unë nuk e di, në qoftë se keni pritë me ardhë me ju marrë me taksi nëpër shtëpia, mirë i shkon me pas mundësi, e di që KPF-ja ka pas me organizu një dëgjim buxhetor. Edhe një herë nuk pretendoj me dhanë këshilla, pres këshilla të mira, ama këshilla. Nuk pres me ia bë qejfin dikujt, po unë nuk pretendoj me nxënë ngushtë askend, po ju siguroj që edhe ngushtë nuk keni me me nxënë askënd, për shkak se edhe një herë po them buxheti, është ky që është. Planet janë këto që janë, e përgjegjësinë për zbatimin e këtyre planeve e ka ekzekutivi me kryetarin e komunës, ndërsa korrigjues i këtyre planeve që s'janë të mira e ka Kuvendi i komunës, edhe unë pres prej Kuvendit Komunës, në një propozim interesant, se na kemi obligime, kurrkush s'e ka mohu faktin, mund të krijojmë edhe borxhe, kurrkush s'e ka mohu faktin, mirëpo edhe një herë po ju them, ne mbajmë tash për tash, jemi komuna e parë që e kemi thye rekord në përmbushjen e premtimeve, përcillne nga GAP-in edhe një herë po ju them, edhe shihni komunat që udhëhiqen edhe nga Aleanca, nga PDK-ja, nga LDK-ja, nga VV-ja, edhe këqyrni kur janë me premtime zgjedhore. Pra, unë e di çka punoj, sepse kurrë në jetën time edhe në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare pa vizion s'kam punuar. Munden të më gjykojnë njerëzit, munden të më vlerësojnë nga këndvështrimi i vet, me nxjerrë vendimin nga këndvështrimi i vet veç nuk e di kurrë në kuti të votimit se ajo është vullnet individual që shprehet nga secili. Për analizat e mia, pse, sepse unë nuk bëj kalkulime as tinëzare, as për interesa personale, s'kam bo kurrë edhe në kalkulimet që i bëjmë ne edhe nuk jam vetëm, me ekip, po bashkë me qytetarët, mendojmë që ky është buxheti më i mirë i mundshëm, e shpërndarja e këtij buxheti është më të mirë të mundshme. Ne nuk themi që po bëjmë mrekulli, se kaq është buxheti, këto janë projektet për të cilat folëm dje, sot e para një muaji e kemi me fol prapë, sepse ka edhe ngecje, ka edhe plot. Mirëpo ky buxhet, nuk është buxhet i një partie politike, pasi këtë buxhet na e kemi kalkuluar mire edhe nga vërejtjet që i kemi marrë prej qytetarëve. Nëse plot projekte, edhe një herë po them kanë ndodhë në këtë vit, e janë tu ndodhë përkundër faktit që s'u votu në vitin e kaluar buxheti për këtë vit. Edhe në këtë vit po ju siguroj se as bora e as shiu, nuk ka me muajt me na pengu që ti kryejmë punët tona, sepse jemi njëherë të gjallë edhe ju kemi dediku shërbimit ndaj publikut edhe ju që jeni të zgjedhur, që jeni përballë meje por edhe ne që jemi po ashtu kemi mandat që ti kryejmë punët tona. Prandaj unë e ftoj edhe një herë parafolësin që se paku domethënë mundet mos me votu, po arsye ende nuk dha, sepse specifikat e projekteve ju siguroj që përparimi për shërbime publike prej A deri në ZH, masë ditë me i tregu edhe me pllamë, unë qitu, domethënë këtu jemi. Kështu janë njësoj secilin drejtor është në gjendje me të fol për projektet e veta, sado që janë kode të përgjithshme apo janë projekte specifike. Madje munden me ditë edhe deri ku në ka shkuar përqindja e realizimit, sa janë bërë pagesat, ku kemi mbetur, domethënë unë jam i bindur që e kam një ekip të shkëlqyeshëm, i cili tashme ka fituar një përvojë të bollshme me dhanë shpjegime sa të doni. Prandaj, në qoftë se doni të i dëgjoni ballafaqimet e mu përballë mirë e mirë, unë besoj që qitu në gjithë sallë të Kuvendit edhe t'i kish pas treqind e njëmbëdhjetë vet, e vështirë është me gjet një që me arsye kish ngrit votën kundër këtij buxheti. Vështirë. Tash ata njerëzit vendosin vet, po vështirë në qoftë se nisim në shpjegimet në fushë të fakteve të argumenteve. Në qoftë se neve na kishte mberë buxheti, se nuk jemi të përkushtuar ose kemi dështime në plot vende edhe s'ka zhvillime këtu hiç, unë pajtohem që së pari vetë se kisha votuar buxhetin. Po ne jemi duke biseduar për një situatë krejt reale që është ky buxhet, disa projekte janë bartë prej vitit kaluar në këtë vit, disa prej këtij viti në vitin e ardhshëm, sepse kjo është pozita reale e Kosovës. Kjo është gjendja reale fiskale e Kosovës edhe zhvillimore e Kosovës. Po ne si komunë megjithatë jemi të përkushtuar edhe komuna jonë po besoj që ka arsye edhe anëtarët e kuvendit të Komunës kanë arsye me votu këtë buxhet, i cili është i shpërndarë drejt, përgjegjshëm, proporcional dhe në përputhje me nevojat themelore dhe prioritetet që ka komuna. Pa i harru

projektet që i kemi ekzistuese, pa i harru që kemi projekte ma të vjetra që sajnë kryer ende, pa i harru obligimet kontraktuale, pa i harru edhe borxhet që sot krijohen do, nesër krijohen do pasnesër shlyhen, kjo është proces. Ne nuk jemi njerëz të vdekur, jemi njerëz të gjallë, jemi komunë e gjallë, dinamike. Edhe Qeveria e Komunës është dinamike, edhe kryetari, edhe Asambleja. Unë po besoj që duhet me i pa këto që nuk i kam për fushatë, se për fushatë unë kam sende të tjera.

Kryesuesi - Pa dashur që zgjatem në lidhje me njoftimin në kuadër të dëgjimeve buxhetore dhe anëtarët e KPF-së e kanë ditur që një takim do të mbahet, njoftimet i kanë pasur, por gjithsesi kryesuesi do të vazhdojë ta bëjë punën e vet, në shërbim të Kuvendit, qytetarëve edhe atyre që tregojnë respekt.

Leonard Morina - Faleminderit, kryesues! Sa i përket dëgjimit buxhetor, faktikisht ne e kemi parë njoftimin, është thirr në emër tonë pa na konsultuar neve, besoj që u desh të njoftohemi për datën e takimit, sido që të jetë kjo temë është e mbyllur. Çka pashë në këtë buxhet, pra Buxhet i ri me avazin e vjetër. Po them buxhet i vjetër, sepse 90% e projekteve janë në vazhdim, ndërsa vetëm 10% të projekteve janë te vitit 2023. Zakonisht Komuna e Rahovecit shquhet për vonesa apo strategjitë të projekteve që stërzgaten. Vërejtja që zakonisht i ka marrë Komuna e Rahovecit është për shkak që projektet kanë zgjatë më shumë se tri vite. Njëjtë siç duket, prapë do ndodhë dhe s'do të ketë përmirësim në këtë pikë. Çka do të shohin qytetarët në buxhetin e këtij viti? Pesë projektet reja dhe katërdhjetë projekte janë në vazhdim. Ndërtimi dhe renovimi i QMF-së dhe AMF-së, projekti i ri njëqind e njëzetë mijë euro, ngrohja qendrore e objektit të kulturës njëzet mijë euro, ndërtimi i muzeut Sulejman Krasniqi katërdhjetë mijë euro, ndërtimi i shkollës Hamz Thaçi njëqind e pesëdhjetë mijë dhe projekti i fundit i ri për këtë vit, ndërtimi i Aneksit katër dëshmorët që janë ndarë njëqind mijë euro. Totali për vitin dy mijë e njëzet e tre është katërqind e tridhjetë mijë euro janë në projektet e reja për këtë vit, apo në përqindje bie dhjetë përqind, ndërsa krejt projektet në vazhdim janë katër milionë e dyqind e tre mijë, apo nëntëdhjetë përqind. Për vitin dy mijë e njëzet e katër pesëmbëdhjetë përqind e buxhetit në projektet e reja, ndërsa tetëdhjetë e pesë përqind janë nda mjete për projektet që janë në vazhdim. Nëse i analizojmë projektet atëherë mbi pesëdhjetë përqind e projektet janë pa adresë, nuk dihet ku janë, nuk dihet sa janë, këto tregojnë që nuk keni një plan të detajuar për këto projekte. Po ndalem pak te administrata, e pashë një projekt të ri te E-Kioskat që parashihet janë nda njëzet e tetë mijë euro, unë para disa ditëve isha në Xërxë e pashë që nuk po punon E-Kioska dhe po më duket si projekt i kotë për shkak se tani platforma E-Kosova, gjithë dokumentacionet mundesh me i nxjerrë online prej shtëpisë. Po besoj që kjo E-Kioska ka qenë më herët e dobishme, po tani nuk ia vlen më u zgjeru më shumë me E-Kioska. Sido që të jetë, kështu e keni parapa. Tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve njëqind e pesëdhjetë mijë euro, projekte pa adresë. Te ndriçimi publik, gjithashtu pa adresë. Na kemi propozuar edhe te KPF-ja që të specifikohen të gjitha projektet, ta dimë se ku gjendet ai projekt, sa kilometra ose sa metra do të shtrohen trotuar në secilën lagje, ose njëjtë është edhe tek ndriçimi, ose cilët janë me prioritet pak më të madh, gjatë vitit 2023-2024 e kështu me radhë. Tek Drejtoria e Zjarrfikësve, izolimi i objektit të zjarrfikësve për vitin 2023-2026, zero euro. S'e di pse ka ndodhë kjo, kisha dashtë një sqarim, nuk kam mundur ta kuptoj çfarë investimi të izolimit me zero euro. Tek Bujqësia qëndron pak më mirë, për shkak që në bujqësi janë parapa rrugët ku do të shtrohen d.m.th. është një përparësi në krahasim me drejtoritë e tjera. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e kanë një projekt në vazhdim, ndërtimi i kompleksit sportiv në zonë turistike me vlerën nëntëdhjetë mijë euro, tek cila zonë bëhet fjalë për shkak që nuk është e specifikuar? Te arsimi, projekti i ri ndërtimi i Aneksit, shkollës fillore të mesme e ulët Katër dëshmorët në Ratkoc. Me sa e di unë ky projekt ka filluar më herët, jo në 2024, ndoshta mund me qenë edhe gabim, po i vetmi projekt që m'u duk serioz është ky në fshatin Ratkoc, prej vitit 2023 në vitin dy mijë e njëzet e gjashtë parashihen një milion e tridhjetë e një mijë euro. Do të thotë, ky projekt shihet që është më seriozi prej kryetarit të komunës. Dhe në fund, meqenëse vijë nga Malësia e vogël, po e shoh që nga 45 projekte, vetëm në një Projekt është i përfshirë edhe ata tek rregullimi i prrockave. Po shpresojmë që këto projektet e tjera që janë pa adresë, të jetë edhe Malësia në këta projektet e tjera. Përndryshe, ne një orë para se me ardhë në Kuvend, na erdh një material, 3 emaila plotësim për adresat e rrugëve këtu, po mendoj nuk është

serioze një orë para Kuvendit të na vije materiali. Është dashur dy-tri ditë përpara për shkak që ne të mundemi të i analizojmë ma në detaje, jo një orë para Kuvendit.

Hasan Përboqi - Të nderuar kolegë asamblistë, më lejoni që para jush të paraqes qëndrimin tonë si Grup i Asamblistëve të Aleancës për pikën e buxhetit të komunës së Rahovecit për vitin 2024. Të dashur qytetarë të Rahovecit, Buxheti total i komunës, ashtu siç është prezantuar nga drejtori i financave është rreth nëntëmbëdhjetë pikë tetë milionë euro. Votimi i buxhetit për ne si Asamblistë është një moment i rëndësishëm, ku ne të zgjedhurit e juaj e kemi mundësinë që besimin tuaj ndaj nesh ta kthejmë ashtu siç ju e meritoni, me përkrahje direkte të projekteve që ndikojnë direkt tek ju, si dhe në mirëqenien tonë si bashkëqytetarë të Rahovecit. Ne si grup e kemi analizuar mirë këtë projekt-buxhet që e kemi para vetes, ku në të kemi vërejtur shumë projekte konkrete që ndikojnë direkt në përmirësimin e jetës tonë. Në këtë projekt-buxhet shohim projekte kapitale të rëndësishme për komunën tonë, qoftë ata që janë në vazhdimësi nga ky vit apo edhe projektet tjera që do të nisin së implementuari vitin e ardhshëm. Ndër projektet më me rëndësi që i shohim në këtë buxhet dhe që sigurojnë një shtrirje territoriale në gjithë komunën e Rahovecit, janë ndërtimi i sheshit qendror të qytetit, i cili projekt është buxhetuar me mbi një milion euro vetëm për vitin dy mijë e njëzet e katër, një shumë jashtëzakonisht e madhe për një projekt me rëndësi të madhe për qytetin e komunën tonë. Projekti tjetër është ndërtimi i objektit të ri të shkollës në fshatin Xërxë, ndërtimi i aneksit të shkollës në fshatin Ratkoc, ashtu siq u përmend edhe nga parafolësi kolegu nga Vetëvendosja. Pajisja e shkollave me mjete konkretizuese dhe mjete laboratorike, konsideroj që është një projekt me rëndësi të madhe dhe që duhet të përkrahet nga të gjithë. Restaurimi i objektit përkujtimor për gjashtëdhjetë e katër të masakruarit në fshatin Krushë e Madhe, ndërtimi i muzeut për shkrimtarin dhe atdhetarin Sulejman Krasniqi, që është një projekt i ri që do të fillojë si implementuari në vitin e ardhshëm. Pastaj ndërtimi i kanaleve kulluese të tokave bujqësore në Rahovec, Fortesë dhe vendbanime të tjera. Bashkëfinancim në ndërtimin e zonës ekonomike në Opterushe, së bashku me Qeverinë e Kosovës. Qendra për Kulturë, Arte në qytet, i cili projekt pritet të fillojë shumë shpejt e që është i një rëndësie jashtëzakonisht të madhe si për qytetin, ashtu edhe për të rinjtë nga komuna jonë. Pra, të dashur kolegë, asamblistë, projektet e përmendura më lart janë vetëm disa këtë vit apo edhe nga ata që pritet të fillojnë së realizuari vitin e ardhshëm. Po ashtu, jemi të vetëdijshëm se nevojat dhe kërkesat e qytetarëve janë edhe më të larta sesa këto projekte që i shohim në këtë projekt-buxhet të planifikuar, por po ashtu jemi shumë të vetëdijshëm edhe për kapacitetet e limituara buxhetore që i posedon komuna jonë, si dhe mbulimin me ligj të kontratave më të vjetra që janë. Përkushtimi ynë si grup i asamblistëve do të jetë çdoherë konstruktiv e kontribut dhënës kur janë në pyetje interesat direkte të qytetarëve tanë. Të nderuar qytetarë, vota jonë si grup i asamblistëve do të jetë për miratimin e buxhetit të komunës për vitin 2024, e po ashtu i ftoj edhe kolegët asamblistë të partive të tjera ta ndjekin këtë veprim dhe gjithë njëzëri ta votojmë buxhetin e komunës për vitin 2024. Për fund, po e përmendi unë për veti personalisht një arsye kryesore pse si asamblistë nuk do ta votoja buxhetin. Unë si asamblistë në pikëpamjet e mia nuk do ta votoja buxhetin vetëm për një arsye, nëse buxheti i vitit aktual apo buxheti i viteve paraprake nuk po shkon së shpenzuar në mënyrë të duhur dhe në përqindje të ë kënaqshme. Pra, kjo do të ishte arsyeja e vetme pse unë si asamblistë nuk do ta votoja buxhetin, e kjo besoj që të gjithë jeni të vetëdijshëm, të gjithë e keni pa që si po shkon shpenzimi i buxhetit ndër vite në komunën e Rahovecit, e kjo është vërtetuar edhe në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Pra, arsye kryesore pse nuk duhet votuar një buxhet nuk ekziston në komunën e Rahovecit, projekte, ide e gjitha tjera gjithë kemi, por vetëm i përmendëm e kapacitetet e limituara buxhetore që i ka komuna jonë edhe gjithë ju jeni të vetëdijshëm për këtë. Ju faleminderit për vëmendje, edhe një herë ju ftoj të gjithëve që së bashku ta miratojmë buxhetin e komunës për vitin 2024.

Lirigzon Kastrati - Faleminderit i nderuar kryesues, ekzekutivë, kolegë anëtarë të kuvendit të komunës, media, qytetarë të komunës së Rahovecit. Nga ajo çfarë kam parë nga ana e komunës në buxhetin për vitin 2024, janë vetëm gjashtë projekte të reja kapitale dhe të gjitha projektet tjera janë vazhdimësi e vitit 2023. Kështu që, duke vazhduar gjatë vitit 2024, por edhe për disa të tjera, siç është planifikuar do të do të vazhdojë përgjatë viteve 2025 dhe 2026. Kjo flet për një menaxhim të dobët të komunës, që do të ndikojë negativisht në

zhvillimin ekonomik të komunës sonë, pasi që të gjitha investimet janë vazhdimësi përveç gjashtë projekteve të reja, të cilat vetëm janë planifikuar dhe duke parë këtë gjendje, edhe këto gjashtë projekte komunale do të kenë fatin e njëjtë me atë që kanë mbetur në vazhdimësi. Mund të themi se me të vërtetë ka keq menaxhim të buxhetit, sepse qytetarët e komunës sonë kanë nevojë për shërbime komunale, për investime kapitale, me qëllim që të përmirësohet jeta e tyre. Ne nuk e dimë saktësisht se sa projekte kanë filluar gjatë vitit 2023 dhe sa të tillë kanë përfunduar, po gjatë këtij viti ose deri më sot. Pra, në përgjithësi buxheti për vitin 2024 nuk sjell zhvillim ekonomik, pasi çka është vazhdimësi e projekteve të mëhershme dhe unë mendoj se kjo gjendje duhet të jetë shqetësuese, sepse komuna ka ngecur në menaxhimin efikas të buxhetit. Pra, mund të veçoj se komuna nuk është duke i përfillë nevojat e qytetarëve të fshatit Hoqë e vogël dhe Brestoc, pasi që për vite me radhë në këto fshatra nuk ka buxhet në kërkesat për rregullimin e rrugëve fushore që t'i lehtësojë bujqve zhvillimin e bujqësisë, pastaj nuk i ka trajtuar seriozisht kanalizimet si dhe shtratin e lumit, njëra ndër projektet kryesore për këto fshatra. Këto projekte janë shumë të rëndësishëm për qytetarët e këtyre fshatrave dhe janë të nevojshëm për përmirësimin e jetës së tyre. Pra, më duhet të theksoj se për këto dy fshatra nuk është planifikuar asnjë projekt tjetër, së paku deri në vitin 2025 apo edhe më tutje. Andaj dëshiroj ta pyes kryetarin e komunës, sepse duhet të jetë kjo sjellje e komunës ndaj qytetarëve, pra sjellja diskriminuese në shpërndarjen e barabartë të buxhetit, sepse në fund të fundit të gjithë jemi qytetarë taksapagues të kësaj komune dhe unë mendoj se trajtimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë të barabartë, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

Defrim Kafexhiu - Faleminderit, i nderuar kryesues! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetarë, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të organizatave, media, zyrtarë komunalë, qytetarë të komunës së Rahovecit. Do të ndalem pak edhe të arsyetimi i Hasanit për projektbuxhetin për vitin dy mijë e njëzet e katër, por fillimisht dua të komentoj diçka që tha kryetari, që tha buxheti më i mirë i mundshëm për Komunën e Rahovecit. Unë po besoj që është buxheti më i mirë që ju mundeni me bo, e po dyshoj që më mirë nuk dini me bo. Pra, edhe të çështja e Hasanit, unë asnjëherë dikë prej grupit të Aleancës, apo shumë pak mundemi me veçu disa prej asamblistëve, edhe pse jeni shumë e keni shumicën, asnjëherë asnjë propozim nuk e keni bo në këtë Kuvend Komunal, qoftë edhe për projektbuxhetin për vitin 2024. Edhe nuk e di a po e kuptoni rëndësinë e institucioneve që janë të ndarë, për shembull institucioni i Asamblesë Komunale edhe institucioni i kryetarit të komunës. Institucioni i kryetarit e bën projektbuxhetin me grupin punues për hartimin e buxhetit projektbuxhetit për vitin e ardhshëm. Ne si anëtarë bashkë me juve e kemi për detyrë ta shqyrtojmë këtë projektbuxhet që na sjell kryetari dhe të i mendojmë propozimet edhe me i dhanë kritikën rreth këtij buxheti. Po, nuk është keq edhe me ja mbajte zhagin se kështu po ua qet. Pastaj, të dëgjimet buxhetore kryetari e dha arsyetimin edhe Burimi, po edhe shefi i grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, po ashtu edhe unë po i bashkëngjitem këtij arsyetimi, për shkak se anëtarët e KPF-së të deleguar janë prej Kuvendit edhe në konsultim me ata, duhet me u bë thirrja për organizimin e dëgjimit buxhetor, si organ i kuvendit të komunës që e përfaqëson Kuvendin, domethënë. Po ashtu, buxheti për vitin 2024, e thanë edhe parafolësit e mi, edhe të çështja e mënyrës së votës, Hasani tha që nuk ka arsye që të votohet kundër këtij buxheti edhe dha një arsye kot, se kur duhet me u votu kundër një buxheti, unë po besoj që gjithsecili që e ka parë në vazhdimësi mënyrën e implementimit të buxhetit edhe mënyrën e shpenzimit të buxhetit të komunës së Rahovecit, duhet ta ketë votë kundër për këtë buxhet, për shkak se buxheti për vitin 2024 nuk ka asgjë të veçantë, asgjë të re dhe asgjë të pritur nga kryetari i komunës. Për ne të gjithë doli e pritura, një dështim i radhës, i përvitshëm, njëjtë edhe sivjet. Rrjedhimisht, mjafton vetëm me e pa mënyrën e menaxhimit të buxheteve vit pas viti nga kryetari i komunës edhe na lë që ta kuptojmë që me miratimin e këtij buxheti nuk mundet me pas kurrfarë dobie për qytetarët e komunës së Rahovecit. Hasani e tha që shpenzimi i buxhetit në komunën e Rahovecit është e vërtetë që kryhet maksimalisht, duke u paguar borxhe. Shpenzohet buxheti 98%, por qytetarët nuk përfitojnë asgjë. Mënyra politike e procesit të buxhetimit nuk është e drejtë, domethënë forma se qysh Aleanca po e implementon edhe po e shpenzon buxhetin është puro-politike edhe nuk është për interes të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Po e tregoj pak ciklin e mënyrës së implementimit të buxhetit, duke filluar prej qarkores së parë buxhetore që vjen prej Ministrisë së Financave, çdo vite kryetari i komunës bashkë me

ekzekutivin, Drejtoria e Financave rrjedhimisht mban dëgjimet buxhetore që i marrin kërkesat e qytetarëve për t'i përfshirë në buxhetin për vitin e ardhshëm. Prej njëmbëdhjetë dëgjimeve buxhetore që i ka mbajtur grupi punues për implementimin e buxhetit, ka pas 104 kërkesa, teksa 125 janë të pranuar për t'u implementuar në buxhetin e vitit 2024. Por, 90% prej këtyre 89% kërkesave janë bërë edhe vitin e kaluar. Domethënë, 89% kërkesat përfshimë, e 90% e këtyre kërkesave kanë qenë edhe vitin e kaluar d.m.th. ky buxhet nuk ka asgjë të re, vetëm që po shkojnë vitet edhe po ndërrojnë numrat në buxhet, kurrëgjë tjetër nuk i shihet e mira për çështje të buxhetit. Domethënë, forma e përsëritur e implementimit të ciklit buxhetor nuk është premtuese dhe rrjedhimisht qytetarët nuk kanë çfarë të presin për vitin 2024, më shumë se në vitin 2023. Projektet e reja nuk kanë buxhetin 2024. Leonardit e tha që një dhjetë për qind ka projektet e reja, po ashtu edhe Burimi e Lirigzoni, po projektet e reja absolutisht asnjë nuk e ka. Në projektbuxhetin për vitin 2023, po në këto projekte që i keni cekë dhe i keni emërtuesit të reja. Projektet e reja ju i keni emërtuesit, të reja, por keni nda mjete edhe në vitin 2022 për këto projekte. Rrjedhimisht, në bazë të Ligjit të Prokurimit kontrata më e gjatë që mundet të nënshkruhet është tre vjet, domethënë 2022, 2023 dhe 2024. Ju keni përfshi si projektet e reja edhe investimet që i keni bërë në vitin 2022, domethënë asnjëra prej pesë projekteve të reja, që është ndërtimi i instalimit të ngrohjes qendrore, ndërtimi i muzeut, Sulejman Krasniqi, pastaj Shkolla fillore Bekim Sylka në Rahovec, pastaj Hamëz Thaqi në Xerxë dhe shkolla Katër Dëshmorët e Kombit në Ratkoc. Domethënë, për këto projekte janë nda mjete edhe në vitin 2022 dhe nuk munden me qenë për vitin 2024 si projektet e reja, por ju e keni gjet mënyrën edhe hapësirën, sidomos në plotësimin e këtyre kriterëve për përfitimin e grantit të performancës edhe grantin për transparencë komunale, po domethënë jeni të mirë vetëm aty. Me i gjet këto hapësira edhe me qene pretendent që ti fitoni këto grante që absolutisht pajtohem dhe jua zgjasë dorën që po i fiton Komunën e Rahovecit, por kurrëgjë nuk po përfitojnë qytetarët. Po ashtu te specifikimi i projekteve, që e ka përmend Burimi, domethënë gjithmonë e keni dhënë arsyetimin që sistemi apo programi i investimeve publike nuk jua lejon specifikimin e projekteve, por kjo arsye nuk qëndron. Për shkak se programi i investimeve publike është ekskluzivisht për specifikimin e projekteve. Po arsyeja pse ju nuk po i specifikoni është për shkak se programi PIP, që ju po i referoheni si arsyetim nuk e lejon që me u pagu edhe borxhet. Domethënë pa e mbyllë një projekt, një kontratë që është e parapanë për tre vjet, ju nuk mundeni me shti në sistem edhe një projekt të ri, rrjedhimisht pa i paguar këto borxhe që nuk dihet qeverisja Latifja a do të mundet ndonjëherë që ti kryej, nuk ka me pas edhe projekte të reja, po rrjedhimisht unë personalisht i kam këto arsye të mjaftueshme për me votu kundër këtij buxheti, ndërsa arsyet Hasani që i dha, le të I ushqen grupi i Aleancës.

Kryesuesi - Por, vetëm një vërejtje zoti Dëfrim Kafexhiu, pasi më parë m'u drejtuar që nuk po i respektoj rregullat e Kuvendit, në krahasim me ju, unë po i thyej rregullat për shkak të minutazhës dhe fjalës që po i jap.

Kryetari - Menjëherë prodhoi efekt fjala më herët, sepse unë prita Këshilla, i dëgjova me vëmendje dhe qenë shumë të arsyeshme dhe besoj se kanë me ndihmë që më kanë mirë edhe për diken këtu që nuk me sheh ashtu me sy të mirë, çka me i bo tash mua më kanë zgjedh popullata, tash votuesi më ka zgjedh, na kujt edhe s'i pëlqej. Teke fundit, dielli nuk nxen për të gjithë e sado që është i fortë, s'kemi çka me bo. E dikush tha që s'e ka votu buxhetin asnjëherë, mos ta voton bre edhe sot, por borxh ia kemi njëri-tjetrit me qenë më me respekt edhe me qenë më të arsyeshëm edhe më bindës. Pra, unë nuk e gënjej as GAP-in, nuk e gënjej as Ministrinë e Pushtetit Lokal, edhe nuk e gënjej as ligjin, se ne jemi në zbatim të ligjit. Kisha pas qejf me qenë i zoti që me qenë më i fortë sesa krejt Parlamenti i Kosovës, e krejt legjislatura e parlamenti, krejt çka ka bërë ligje prej dy mijë e njëzetës, Parlamenti i Kosovës me qenë më i forti edhe më specialist për t'i gjetur hapësirat ligjore. Unë hala dyert e prokurorisë nuk i di, as të hetuesisë, edhe nuk besoj që do ta mësoj ndonjëherë. Unë e kam një listë specifike të investimeve publike, edhe i kisha lutur njerëzit, se për hir të opinionit, edhe këtyre çka folën deri tash, unë i falënderoj për kontribut, për këshilla speciale që po na i japin, mirëpo unë e kam një listë dhe kjo listë nuk rren, as nuk rren sa rrugë janë shtruar në Hoçë të Vogël, as nuk rren për ndriçimin publik në Hoçë të Vogël, as nuk rren për shkollën në Hoçë të Vogël, as nuk rren për zgjidhjet e kanalizimit në Hoçë të Vogël, as nuk rren për rrugën e varrezave të dëshmorëve e të martirëve në Hoçë të Vogël. Në këtë listë asnjëherë s'është përmend përroi sepse shtrati i përroit është një problem tjetër që kemi diskutuar në këtë Kuvend,

madje edhe kemi tentuar, ju kam premtuar në këtë sallë, ju kam thënë që edhe përroit do t'i gjendet zgjidhje, por ne nuk guxojmë të buxhetojmë tani për shkak se mund të ndodhë që Ministria e Planifikimit e rikthen Kodin për përroin që përfshin Hoçën e Madhe, Hoçën e Vogël, Brestocin, deri në Krushë. Kështu që, domethënë kodër pas bregu, nuk po di, kemi të drejtë secili të flasim, po faktet janë fakte. Mos u mbështesni të flisni me ligj, sepse ndoshta aty ku banoj unë sot, me qira, është lagjia më e diskriminuar, pikërisht aty ku banoj unë. Ndërsa ku banojnë plot të tjerë që janë këtu, ka investime dhe ka me pasë edhe në të ardhmen. Kështu që është mirë, përgjegjësisht, se unë thashë se jemi të gatshëm të ballafaqohemi natë e ditë me të vërtetën e për të vërtetën jam në gjendje edhe me u fliju. Po kështu improvizime nuk kam dëshirë. A ka projekte të reja? Kurrkush nuk tha që ka projekte të reja. Bile ju i paskeni gjetur nja gjashtë, unë po them s'ka hiç, që po pajtohem me faktin se s'ka hiç, po këto që ndodhin, që janë pjesë e këtyre kontratave, këto janë projekte të reja, se janë kërkesa të qytetarëve. Nuk janë kërkesa të jashtëtokësorëve, janë kërkesa të qytetarëve të Komunës së Rahovecit. Ne jemi të vetëdijshëm që jemi vonuar diku, jemi vonuar edhe për shkak të rrethanave, si pandemia, çmimet e tjera, jo buxhet i limituar. Ne jemi pajtuar me faktin që kemi obligime dhe shqyr, se unë edhe kur të vdes nuk kam qejf të lë obligime, bile ndonjë porosi të mirë për këtë dynja. Sigurisht, Smajl Latifi, si kryetar i Komunës, e përfaqëson konceptin e status-kuosë, kur të na vijnë para te krejt tani, jo tani kur të na vijnë para te krejt nuk ka nevojë, kurrë unë nuk vij hiç këtu në komunë, se ec sistemi, vetë funksionon. Ne luftojmë që me pak para, të sjellim para më shumë dhe këto para çka i kemi me i shpërnda sa dimë e sa mundemi edhe në përputhje me prioritetet. Ndërsa, nuk e kam ndërmend fort me u marrë me asnjë, unë e ftoj Kuvendin e Komunës edhe një herë, meqenëse po përmenden votat këtu, e ftoj kryesuesin me hedh në votim buxhetin. Veç ta dini që ai që voton për, regjistrohet, që ai që voton kundër, regjistrohet dhe ai që abstenon, regjistrohet, që ai që del jashtë regjistrohet edhe krejt këta, çfarëdo vendimi që e kemi marrë individual ose grupor, krejt kanë me u ballafaqu me qytetarët. Pra do te ballafaqohen edhe për buxhetin kur nuk e voton, domethënë është ballafaqim, se tani nuk ka drejt dikush me thënë se këtu në këtë Kuvend, herë del thotë dikush futni ndonjë projekt të ri, herë thotë dikush s'mund të fusni projektet e reja pa i kryer këto që i keni në kontratë. Herë del dikush me shtru edhe një rrugë se s'po bëni kurrigjë, dikush jo s'pe votojmë buxhetin se s'po du me shtru atë rrugë. Mos harroni krejt këto janë përballje, edhe krejt kanë me u la krejt llogaritë në këtë dynjanë lahen, nuk lahen në atë dynjan. Te unë është ashtu, buxheti më i mirë i mundshëm me mundësitë që i kemi, me rrethanat qysh i kemi, asnjëherë nuk thashë që ky buxhet është buxhet i zhvillimit ekonomik. Po ku keni parë, Kosova ende nuk ka mbërri as për vete me pasë buxhet të zhvillimit të hovshëm ekonomik. Për shkak se buxheti i kësaj Kosove shtet, Kosove të varfër, e të përpëlitur, e të përflakur, e qysh doni të përgjakur, gjysma e këtij buxheti shkon për paga. A e kuptoni ju sa ka për investime? E tash, na thonë buxhet për zhvillim ekonomik, ky është buxhet i zhvillimit ekonomik. Është mirë me i largu këta terma prej fjalorit, sepse ky buxhet është lehtësim për jetën e qytetareve e rrit cilësinë e qytetarëve, krijon mundësi edhe hapësirë që mirëqenia e qytetarëve me qenë në vazhdimësi në rritje dhe njëkohësisht e ndihmon zhvillimin ekonomik. Po ku keni dëgjuar që komunat bëjnë zhvillim ekonomik, krijojnë lehtësira, hapësirë, mundësi, favore, benefite për zhvillim ekonomik e për punësim. Që ky Kuvend mos e harroni se këtu po dilni kontradiktor dikush. Që ky Kuvend ka votu me dhjetëra herë, ka çu dorë për me ia dhënë një tokë në shfrytëzim, një depo në shfrytëzim që ata e kanë zhvilluar për veprimtari ekonomike aty, ose tregtare, ose prodhuese që ata i kanë vetë në punë aty, përsëri do të japë edhe në të ardhmen, pra janë detyra të institucioneve. Edhe këtë buxhet që e kemi, ne nuk duam të themi që duam të ndërtojmë fabrikë. Ka ikur ai koncept, s'ekziston më ai koncept në këto rrethana, dinamika të reja, trende të reja që shteti ndërton fabrika. E pse s'po ndërton fabrika shteti, sepse jemi në kapitalizëm, sepse është sektori privat. Prandaj, këtë buxhet për investime publike e kemi qartë sa kemi pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë euro, kaq është. Çka mund të mbërrijmë më shumë është në rregull, mirëpo këtë kemi për detyrë me shpërnda e m'i plotësu kërkesat themelore, nevojat në bazë të prioriteteve që i kanë qytetarët e kësaj komune. Ndërsa, për diskriminim, dikur kam qenë më përpara sesa që janë disa sot, kam qenë edhe e kam votu Ligjin kundër diskriminimit atëherë, edhe në lexim të parë edhe në

lexim të dytë. E kam lexu edhe e di saktë se e kam provu në kurriz çka është diskriminimi edhe kurrë tjetrit nuk i bëj diskriminim, aq më tepër Hoçës së Vogël e Brestocit.

Ilir Pallqa - Faleminderit, kryesues! Për miratimin e buxhetit me interes të gjerë apo të ngushtë, me hile apo pa hile, nuk kemi dyshim që votat janë. Unë megjithatë po flas, meqenëse po më takon si i zgjedhur, po pyes për paqartësi që e kam si pasojë e mossaktësisë tuaj apo si pasojë e padijenisë sime, po mundohem me këshillu për ndonjë ndryshim për shkak të pozitës që e kam si këshilltarit. Këtu te përshkrimi i projekteve me donatorë vazhdim, po hyj në sendet konkrete, cilat janë këto projekte, pastaj te përshkrimet në shërbime publike, te përshkrimi i ndërtimit të trotuareve në komunën e Rahovecit, cilat rrugë kanë me u bë me trotuare, gropat septike ku kanë me u bë, ndërtimi i depos bujqësore në Bërnjak, a mundeni me na tregu rreth kësaj kur po planifikohet me u përfundu, investimet në shtigje të ecjes, ku do të bëhen këto investime në vitin 2024. Pra, në shumicën e përshkrimeve nuk kemi përshkrime të sakta, e po krijohet hapësirë për manovrim, krijohet hapësirë për hile. Pastaj, është një drejtori këtu, zero, që e përmendi Leonardi, shumë e rëndësishme për siguri, por është zero. Këtë s'po e them unë, por ky material që na është servu neve, pra Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim. Te përshkrimi nga ky vit, deri te viti dy mijë e njëzet e gjashtë për izolimin e objekteve të zjarrfikësve ka të figuruar shifrën zero, pra kot që po flasim ne, ku nuk përfilllet asnjë kërkesë e jona që adresohet nga banorët tanë. Megjithatë, ne duhet të flasim edhe kur injorohemi, të flasim për t'i qartësuar banorët respektimit të fjalës, se atyre që ata i kanë zgjedhur. Nuk po zgjatem më shumë, veç për fund e kam një këshillë, kryetar po të këshilloj që pjesën e mbetur të mandatit mundohu të paktën me punu pa anime, nuk po kërkoj më shumë, veç pjesën e mbetur të mandatit mundohu pa anime. Pas mandatit, të uroj fat, gjithashtu po mendoj që Parlamenti ka nevojë për një deputet si ti, e po ashtu, Komuna e Rahovecit ka nevojë që në të ardhmen të përfaqësohet nga ti në Kuvendin e Kosovës.

Kryetari - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, se më takon me fol, ju lutem, se mora lejen prej kryesuesit, veç mos të kujton dikush se e marr fjalën pa leje. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, vetëm drejtorin e kemi ne të emëruar politik. Edhe e kemi një zyrtar që është Beqir Hamza, që është punëtor i Administratës, shërbyes civil. Zjarrfikësit menaxhohen nga AME-ja, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Ajo punë që përmend izolimi i objektit të zjarrfikësve, ajo u kry. Prandaj, është zero. Po ka mbetur si kod edhe shlyhet. Por më mirë le të mbetet si kod se nuk i dihet, mund të ketë prapë nevojë për një objekt të ri, se kemi një negociim edhe me atë Shefkë Avdullahun, që ndoshta ata na japin një donacion, na duhet me lënë ne Kodin e hapur, ta bëjmë diku tjetër objektin e zjarrfikësve. Kështu që, ne nuk menaxhojmë me atë drejtor, duhet ta kemi në konsideratë. Prandaj, është zero. Me drejtorinë menaxhojmë, po me personelin që punon në atë drejtor, menaxhon AME-ja, komandanti i zjarrfikësve, drejtoresha bën politikat e Komunës në partneritet me ta, ndërsa komandën ata e marrin prej mekanizmit udhëheqës dhe komandues të AME-së. Kjo besoj është e qartë. Pjesa tjetër, që unë po mendoj që një listë që e ka sjellë Përparimi, ka specifika, ka argumente, ka fakte, janë kontratat, ne pak kemi hapësirë, sepse edhe ligji nuk lejon që të bëjmë veprime të cilat nuk janë të parashikuara në një kontratë të caktuar. Pra, ju mundeni me thënë që po i shfrytëzon Smajli, pasi është specialist për t'i shfrytëzuar hapësirat, mirëpo nuk është ashtu, sepse kontrata i ka specifikat e veta, cilat rrugë kanë me u bë, ku janë ato trotuare që kanë me u bë, e të tjera. Ti mundesh diçka me bë me ndonjë punë shtesë, me ndonjë zgjatje, po nuk mundesh me bë, sepse prokurorët edhe ata policët atë punë e kanë, në krimet e rënda, atë punë e kanë. Kështu, ndonjë hapësirë ti e ke, për ndonjë punë shtesë thashë, ndonjë që ka, e ke la, është si paushallë diçka, si shabllon gjë, zgjat edhe pak, e kane kërku banorët e ke zgjat edhe pak, në rregull, po jo më shumë. Tash, edhe një herë po ju them që buxheti, projektet, kodet nuk dua bre t'i kallëzoj askujt sende, të cilat besoj që duhet me i ditë, disa i dinë këtu në Kuvend edhe i dinë saktë që i dinë, bile edhe me emra i di kush i di, po gjithë kohën me ju mbajt dert tash unë. Sistemi PIP, lejon krejt specifika m'i futë, mirëpo emërtimi i një kodi është diçka tjetër, veç mos t'i ngatërrojmë sendet, të gjitha gjërat, të gjitha shënimet, çka duhet me përmbajte një projekt ne i kemi në BDMS, PIP e krejt i fusim ato, është sistem ai. As unë s'e kam ditë, po e kam mësu, bile nja gjashtë muaj nuk e kam ditë a hahet a pihet ky PIP, BMS-ja, po tash i kam mësu, mirëpo kodet emërtohen për shkak se nuk ndërrohen shpesh dhe nuk mund ta bësh specifikisht ti, pasi ka raste kur edhe një kod është veç specifik. Nuk

mund të bësh rrugë fushore për tri-katër fshatra, t'ua përmendësh edhe emrat e rrugëve, se kodi, domethënë emërtimi i kodit dallon, a krejt në PIP i kemi futur, krejt shënimet, në PIP edhe në BMS-në, siç janë duke i futë tash drejtoria e financave me punëtorët. Pra, mos mendoni që në këtë vend mund të bëjë dikush çka të dojë. S'mund ta bëj, boll i fortë jam, e boll trim jam, po unë tutna kur është në pyetje ligji. Prandaj, rastësisht nuk e përmenda që e thashë se zyrat e prokurorisë nuk e di as ku i ka Gjakova. Figurativisht po të them, se unë e di ku e ka objektin, po nuk e di dhe s'ka me i mësu kurrë. Se e di çka do të thotë zbatimi i ligjit, sundimi i ligjit. Nuk bëj veprime të papërgjegjshme ligjore njëherë, e këtu jemi edhe në qoftë se i bëjmë, ligjet janë tonat, në rregull jemi. Sa i takon, nuk ka nevojë unë kudo që jam, e çfarëdo pozite që kam, nuk më ka interesuar pozita ime në shoqëri. Edhe tash jam në këtë komunë ku jam udhëheqës i Komunës, nuk më intereson ku jam unë. Më intereson komuna, më interesojnë detyrimet që kam ndaj interesit publik. Edhe sa më kanë mbetë, sa s'më kanë mbetë, populli thotë qysh e ka shkru zoti, apo ndonjë, edhe besoj që të bie taman që kjo fjalë që ta thashë, qysh e ka shkruar zoti, bëhet, çka me bë tash, ishalla vjen puna me t'u gjet edhe në ndonjë vend, s'ka lidhje ku jam, unë do të mundohem të ju gjendem secilit, pasi jam shqiptar njëherë, po ashtu edhe tjerat, mundohem të kem virtyte që i takojnë një shqiptari, në rregull jam, ne po bashkëpunojmë edhe me amerikanë e me anglezë e gjerman, besa tani ndonjëherë dikush edhe me rusë, me kinezë, e s'po bashkëpunojmë me shqiptarë, por vëllezër jemi tek e fundit. E rrugë fushore ju thashë, ju mundeni mos me votu, sot ju kam kallëzu që kemi probleme me rrugë fushore e i kemi punët më mirë, po kjo nuk do të thotë që kemi pasur probleme në këtë vit për shkak të operatorëve pak më të dobët që kemi pasur në vazhdimësi, se rrugë fushore janë shtruar në komunën tonë plot. Depoja bujqësore, depoja bujqësore, u përmend, dikush s'ka besu edhe që bëhet, po ja po bohet tash, a jo? Janë duke punu, janë duke përgatitë tash edhe ato montimet, edhe ato punët brenda e plot të tjera. Bile unë tash jam duke mendu si me bë edhe një depo tjetër, se kjo është pak, se është veç për shtatë dhoma ftohëse që i ka, shtatë njësi janë, po të mund ta bëjmë me shtatëdhjetë njësi është më mirë. Po, ne s'kemi mundësinë të mbushim edhe gjatë me një donator, po për këto çka kemi nisë kemi me i kry kysmet. Pra, kemi edhe punë të pakryera, kemi edhe punë të nisura, kemi edhe punë që janë të përfunduara. Unë s'po ju ftoj me marrë pjesë, se ndoshta pritoni me marrë pjesë nëpër përrurime të projekteve, ato janë publike pra, duhet të merrni pjesë se ka mundësi që të fitoni vota pak më shumë kur të merrni pjesë. Për besë, se të sheh dikush, e shihni dikë, pasi ne fund është puna jonë e përbashkët, nuk është punë e një njeriu, e asnjë ekipi, është punë e komunës. E vazhdimësia e projekteve, unë nuk jam prej atyre që e kam shpatën e Demokleut edhe që e këpus ne vend. Unë jam, nuk bëj veprime që e këpusin vazhdimësinë, apo e shkëpusin vazhdimësinë, mos harroni vazhdimësi prej pasluftës, prej Agim Thaçit e deri te Smail Latifi, secili ka punu diçka, e ka me punu edhe në të ardhmen. Na nuk mundemi që kështu, qysh që janë vazhdimësi edhe projekte, po ka projekte që janë vazhdimësi. Ju lutem, ne nuk mundemi me parapa nesër që kushdo që një kryetar komune me thënë keq sa kanë bërë këta të tjerët, këta s'kanë bërë kurrëgjë. Tash kur të vij unë kam me bë mrekulli. Nuk është ashtu. Edhe unë kam kujtuar kur kam qenë një i ri shtatëmbëdhjetëvjeçar, që kur të vij unë, kam me bë revolucion të fortë, po e pashë që nuk mundem vetëm, po edhe në qoftë se kemi bërë, kemi bërë bashkë me të tjerët, me shokë, me bashkëpunëtorë, me bashkëveprimtarë, me bashkëlufëtare, bëjmë edhe sot. Edhe asnjëherë s'e kemi parë veten të shkëputur prej asamblesë, ju asnjëherë s'keni me pa arrogancë as të votave, se përndryshe ne mundemi me thënë, të hidhen vota edhe u kry puna. Edhe të hidhen votat, çka bëhet, përfundon debati, kryhen punët, po nuk jemi prej atyre. Nuk i takojmë atij koncepti. Ne kemi hapë debat, por hala s'pashë një propozim përnjëmend e konkret, me thënë këtij projekti, hiqja dhjetë mijë euro e vendosja këtij tjetri. E kur bëhet kështu, atëherë shihet që dikush ka punu, dikush ka punu vërtet seriozisht për me sfidë një qeverisje që e ka bërë një plan të caktuar të projekt-buxhetit, ose një projekt-buxhet të caktuar për vitin e ardhshëm. Nuk jam duke parë këso gjërash dhe ju kisha lutur, e kisha lutur kryesuesin me hedhë në votim, votojeni buxhetin, por na mundemi me hedh në votim, prapë vazhdon debati edhe pas votimit, sepse veç në qoftë se ka paqartësi, se debati duhet me u përmbyllë me një votim të caktuar. Edhe po besoj që kushdo që të flet, mirë është me hedh në votim, propozime të reja s'ka, hidhe në votim buxhetin edhe në rregull. Po kërkoj unë tash, ju prapë vlerësoni.

Rasim Fazliu - Faleminderit, kryesues! Mendoj që është gabim gjithmonë me thënë që në një komunë, edhe në Komunën tonë të Rahovecit nuk po punohet, domethënë se në çdo komunë punohet brenda buxhetit që ka komuna, kushdo qoftë që është kryetar, këtë radhë është Smajl Latifi, më përpara ka qenë dikush tjetër, të gjithë kanë punuar në mënyrën e vet sa kanë mundur apo jo. Pra, nuk është punu kurrëgjë, nuk është mirë me thënë ashtu, është punu, mirëpo tash qysh është punu, tani mundemi m'i dhënë vërejtjet tona konkrete, ku është punu mirë, ku është punu keq e të tjera e të tjera. Unë fillimisht e falënderoj drejtorin që na ka sjellë projekt-buxhetin për vitin 2024. Nuk dua të përsëris të gjithë kolegët e mi çfarë kanë fol deri tash, sepse i kanë thënë të gjitha. A është e vërtetë që ka projekte të përgjithshme? Po! Sa të duash, por ajo çka unë po du me thënë është që qeverisja komunale është mirë që po punon, që po i kryen detyrat e veta, në atë mënyrë qysh ajo e di dhe që e ka marrë zotimin prej qytetarëve, por kryetari jonë nganjëherë pak po bëhet, si me thënë ekstrem ose i dhunshëm, sepse po mundohet me na imponu, se ne jemi dy gjëra të ndryshme. Ekzekutivi është diçka tjetër dhe ne Kuvendi jemi diçka tjetër, por s'ka lidhje a jemi pozitivë apo opozitivë. Por, unë e kam bindjen që ne edhe qeverisja komunale, por edhe ne anëtarët e Kuvendit Komunal, duhet të punojmë dy palë për të mirën e qytetarëve, pa tendenca pa u munduar me përul njëri-tjetrit, kur të vijnë zgjedhjet, atëherë le të vrapojë secili dhe t'i bëjë votat e veta e le të fitojë, askush s'e ndalon askënd. Po a është mirë me qenë në nivel të detyrës këtu? Po, është mirë, edhe ne si Kuvend, po edhe ajo tendenca që po e shoh prej kryetarit gjithmonë shikon të bëjë ngërçe e të ndalojë bisedën e Kuvendit, pasi siç e dini Kuvendi është organ sovran, është organ i pavarur edhe nuk mundet kurrkush me ndalu, pavarësisht kush është ai. Kushdo që është kryetar s'mundet me ndal punën e Kuvendit. Tani po kthehem me drejtorin, po du me fol pak, se kemi njëfarë muhabeti. Drejtor, i nderuar, kemi pasë probleme shumë të mëdha katër-pesë vite për fjalën keqklasifikim. Ju thoshit s'është, ne thoshim është, kështu që është shtyrë gjatë ajo punë, po nuk po du me zgjat veç po e përmendi, si shembull, edhe në fund, përderisa Ministria e Financave ose Pushtetit lokalë ju kanë stopuar, nuk keni dashtë m'u ndal, domethënë është mirë, po me pas marrë vesh më herët ka qenë mirë, domethënë unë po flas si qytetar pa interesa kështu të caktuara, si anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës që jam këtu dega ne Rahovec. E tash tjetër çka është, po ndalemi te këto projektet që janë të përgjithshme. Mirë bre, unë jam i vetëdijshtë se buxhetin që po e votojmë ose që do ta votojmë tash, ky buxhet është i paraparë për vitin 2024. Po tash normalisht që projektet që janë, projektet që janë dyvjeçare, trivjeçare, ato zgjaten edhe në vitin tjetër, edhe në atë tjetrin edhe përfundojnë tani, apo jo, varësisht sa është projekti i gjatë. Po unë po fokusohem te projektet që janë njëvjeçare. Në qoftë se ne kemi, i nderuar drejtor i Shërbimeve Publike, me shtru një rrugë me kubëza pesëdhjetë metra, po s'kemi nevojë ne me fut këtu si projekt i përgjithshëm ose dyvjeçar ose trevjeçar, po me pas dalë këtu para nesh edhe me thënë kubëzimi i rrugëve për vitin dy mijë e njëzet e katër me këtë buxhet do të ndodhë në këtë rrugë, në këtë fshat, në këtë rrugë, në këtë qytet. Edhe s'kishin me ndodhë kësso debate pastaj. Pyetja është pse edhe ju s'i pranoni vërejtjet që vijnë nga Kuvendi. Unë nuk jam për me lëndu Qeverinë apo për me fol plot e tjera e tjera, po jam që edhe Qeveria pak me bashkëpunu me neve edhe me marrë disa gjëra me punu bashkë në të mirë të qytetarëve dhe kjo nuk po ndodh në çdo rast, pe shoh që nuk u pëlqeu dhe tha na mundemi me hedh votim edhe po ti nuk guxon me hedh në votim pa i shtjerrë diskutimet. E që ai mundet se ai kryesuesi vetë është, mirëpo ju kthen ajo ministria atje që është, se ne bëjmë një ankesë atje, edhe atëherë ku mbetemi, mbetet buxheti pa u miratu. Prandaj, drejtore të nderuar, të gjithëve, meqë kryetari nuk është këtu, specifikimet që keni bo nëpër drejtori. Ju faleminderit shumë, po ku t'i shohim na që janë ato pse s'i keni dërgu tre-katër ditë përpara që e përmendën këta, me të vërtetë s'do të kishte lindur ky debat, por besoni. Po e keni dërgu në momentin kur ne s'mundemi me lexu atë, se unë a duhet me të dëgju ty, a duhet me lexu atë. Kështu që, unë, Rasim Fazliu, si anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës, meqenëse nuk kam buxhet alternativ, unë do ta votoj buxhetin, sepse, buxheti është i qytetarëve, madje këtu ka thënie që këtu po punohet, aty s'po punohet, tek e fundit punohet në Komunën e Rahovecit, përfitojnë qytetarët e Komunës së Rahovecit. Domethënë, kështu që unë e dhashë qëndrimin tim, unë do ta votoj buxhetin, mirëpo me kusht që për buxhetin e ardhshëm, drejtorët edhe kryetari me bashkëpunu për ato çka fola unë, me bashkëpunu edhe nja dy fjalë, në qoftë se më lejon kryesuesi, i kam për kryesuesin, kryesues i nderuar, e di që je i ri në detyrë, po e di që ke perspektivë, je

djalë inteligjent, partia është tjetër send, detyrën që e ke marrë është tjetër send. Ka qenë dashtë me i thirr anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa këtu në zyrat e Komunës, m'u taku me ta, se edhe ne jemi të Kosovës, edhe të Rahovecit jemi, m'u taku me ta me bisedu, më së paku me i mbajtë nja 10 takime anekënd Komunës së Rahovecit, kudo qoftë, me i mbajtë edhe sikur që i kemi i mbajtë përpara, me i caktu këto takime, shembull, në Krushë të Madhe edhe shkojnë krejt tri-katër fshatra përreth, pastaj mbahet në Ratkoc e të tjera e të tjera, mos të zgjatem shumë, kjo ka qenë detyrë e jotja, po unë të arsyetoj për sivjet vetëm me arsyen pse ke hyrë rishtas, edhe ndoshta nuk i ke ditë këto sende, nuk mjafton me thirr një mbledhje për dëgjime buxhetore KPF-ja, duhet me ditë se dëgjimet buxhetore duhet t'i mbajë Komiteti për Politikë dhe Financa, edhe kryetari me ekzekutivin duhet me dalë me marrë mendimet e veta, edhe pastaj me i harmonizu. Edhe një herë po them që unë do ta votoj buxhetin, meqenëse nuk kam propozim-alternativë. Ju faleminderit që më dëgjuat!

Kryetari - Faleminderit, kryesues! Është e vërtetë që unë jam ithtar i asaj pikëpamjes, partizan i asaj pikëpamjes që e përmendi edhe Rasim Fazliu. Po, ka ndërru udhëzimi administrativ dhe po aplikohet një praktikë tjetër që edhe mua më ka kufizu, besoni edhe mua si kryetar komune. E, tash, ju e dini atë praktikën që unë kur i mbaja takimet me qytetarë, edhe mund t'i shfrytëzoja si dëgjime buxhetore edhe si shqyrtime publike e të tjera, për besë nuk i nxinte salla. Ju edhe kjo nga kush prej juve ka marrë pjesë sa shumë njerëz bëheshin. Tash unë krejt ato unë mund t'i mbaj ato, po për buxhet kurrëgjë s'kam të drejtë me folë. A më kuptoni? KPF-së ia kanë parapa minimumin një, po eventualisht dy, qe edhe tri. Kaq ia kanë parapa. E, tash, KPF-ja, pra kësaj radhe nuk është çështje veç me kursy kryesuesin, po edhe vitin e kaluar veç dy më duket, kryesuesi Defrim Kafexhiu, dy ose tri, veç një. Pra, një praktikë e cila fatkeqësisht ka ndryshu, e nuk po mendoj që i bën nder, Pra, tjetër praktikë ka qenë, ka të drejtë secili prej jush me thënë sa pak po marrin pjesë në dëgjime buxhetore, është e vërtetë, sepse nuk po mbërrij me mobilizu njerëz, sepse kryetari i Komunës kur të shkojë atje, nuk duhet me fol për buxhet, po duhet me fol për tema që s'kanë të bëjnë ndoshta hiç me buxhet. A e kuptoni? Edhe tash njerëzit mobilizohen ashtu, po ato s'po të regjistrohen si takime, si dëgjime buxhetore. Ka ndryshu praktika, unë nuk besoj që ka bë mirë Ministria e Pushtetit Lokal. Faleminderit shumë!

Sejfullah Sejfullahu – Përhëndetje për të gjithë. Siç e potencuat edhe ju kryetar, se kemi përgjegjësi secili se a e votojmë apo nuk e votojmë buxhetin. Me të vërtetë është shumë rëndë me iu thënë qytetarëve që nuk e kam votu buxhetin, apo kam abstenu. Është hera e dytë është që jam në votim, vitin e kaluar s'e kam votu, sepse kam mendu edhe besoj edhe kam pasë të drejtë që s'kam qenë i kënaqur që ajo ka ndiku që sivjet është pak më mirë puna. Buxheti është i qytetarëve, po pajtohem plotësisht, po ju e keni bë ekzekutive, i keni bë, e keni kanalizuar tash mirë e keq, mos ta zgjas unë, folën të gjithë këtu, por mirë është në mënyrë pak më racionale, tash s'po flas si krushjan, se mendoj që Krusha këtu pak më tepër, ka përfitu këtë herë, por nuk është në mënyrën racionale sa duhet. Po nisem te drejtor Përparim Krasniqi, e kemi të hapur ndërtimin e rrugëve të mbetura që realisht në Krushë të Madhe, ndërtimi i rrugëve lokale e ritenderuar pas ndërprerjes së kontratës, edhe ndërtimi i rrugëve lokale asnjë nuk është në Krushë dhe kjo me jep të drejtë mua që kur ka nevojë me u bë një rrugë në Krushë, nëse ta votoj buxhetin, me ta zënë derën, me thënë vallai ta kam votu buxhetin, mirëpo janë tridhjetë metra që kam ardhur me ta zënë derën, me ma kry atë rrugë, a i bie që është, thuana? Se ka, besoj, edhe prej atyre, po e kryej. Te dëgjimet publike, kryetar, ne dy herë kemi bërë, unë në dy herë kam qenë në Krushë që kanë qenë. Me të vërtetë është shumë për keqardhje, po nisem herën e parë sa kanë marr pjesë, na e dimë buxheti, e përmendët disa herë, pesë milionë e gjysmë. I pata thënë kryetarit pak me sarkazëm, pak me humor, ky bile qe prekur pak, thashë vallai pesë milionë e gjysmë me i fut veç në Krushë, tash, kurrëgjë s'mundemi të bëjmë as në Krushë të Madhe sa ka kërkesa, e mos të flas për qytetin e Rahovecit. Po megjithatë, me pasë mënyrë pak më racionale akoma më mirë është. Tash ajo që unë dua të them rreth Krushës, pse këtu përfaqësoj komunitetin e Krushës së Madhe faktikisht. Kërkesat që i kam bërë unë është Shtëpia-muze e Bajram Currit, që unë nuk e përmend, domethënë ka investime të reja, besoj që drejtori i Shërbimeve Publike, na ka kursyer në rrugë aty për shkallë që është Shtëpia-muze e Bajram Currit, është shtëpia e ushtrimeve të "Bajram Currit", Ansamblit, edhe Shtëpia-muze e Ukshin Hotit që është bërë dhe po duhet me hesht dhe me ulë kokën, po ajo që nuk duan me vu kushte, me kushtëzu, po mendoj që duhet me ndie obligim,

a nuk është në rregull që tash po i drejtohem drejtorit për Kulturë, Rini dhe Sport, fushën sportive, se jemi bërë bajat duke ju thënë që sa e sa herë. A do të ketë një fushë sportive, a do të fillojë shpejt edhe kur do të fillojë. E dyta, drejtor, e kryetar, e kemi pasur muhabet edhe një punë tjetër. Punën e rrethit, unë kam përmendur para dy muajsh, muajin e kaluar e ka përmend edhe Burimi, edhe në Krushë të Madhe edhe në Xërxë, unë po flas për Krushë të Madhe, e di që e kemi me u arsyetu, që i takon Ministrisë së Infrastrukturës, por megjithatë duhet me përdor ndikimin, shqetësimin tuaj, se ne jemi banorë të gjithë Komunës së Rahovecit që kalojmë aty pari. Në bazë të dëgjimit publik që e kam bërë unë, kërkesave që i kam bërë faktikisht, përpos qendrës sportive që prapë ke me arsyetu që është e Ministrisë së Kulturës, domethënë këto tjerët, i ke fushën sportive duhet me tregu, duhet me dëgju, pastaj Shtëpia-muze veç është duke u bërë, e kam parë që ka dalë në tenderim, nuk di unë qysh është, rrugët fushore deri diku, rrugët lokale, drejtori i Shërbimeve Publike besoj që duhet me na dhënë shpjegim ... Po edhe diçka, kryetar, në buxhet e pashë përroska e fshatit Celinë, që vjen prej Brestovcit, Hoçë e Vogël, Nagac, pasi unë edhe Lirigzoni e kemi ngritë me dhjetëra-dhjetëra herë pasi kjo ka i ka bërë veç pesë-gjashtëdhjetë. Kështu që qysh do të shkojë më tutje? A do të kryhet apo veç e kemi në letra këtu ne... Sepse një vit kemi pasur një buxhet të ndarë, vitin e kaluar, ku janë ndarë paratë, janë kthyer paratë edhe s'është punuar asgjë, sepse operatori s'ka pranuar. Edhe mirë e tha edhe Rasimi, kryetar, do te ishte mirë me na dëgju nganjëherë edhe ne.

Merisa Sharku - Përhëndetje për të gjithë! Sot na ka ardhë me votu një buxhet i borxhit, ashtu si vitin e kaluar, edhe këtë vit pothuajse të gjitha projektet janë vazhdimësi. Sidoqoftë, interesi im si përfaqësuese e një pjese të qytetarëve është zhvillimi i qytetit të Rahovecit, e një prej aspekteve të zhvillimit të qytetit është zhvillimi i fushës së turizmit. Për me pasë turistë duhet pak investim nga ana e Komunës. Në buxhet nuk e pashë ndonjë projekt konkret lidhur me turizmin. Një prej projekteve më të mira që ndonjëherë si qytet e kemi pasë është projekti i “Grapeland”-it, pjesë e të cilit kam qenë edhe unë. Analizat si grup që i kemi bërë për këtë projekt, vështirë që mundet ndonjë projekt i bërë prej komunës t'i ketë. Kështu që, ftoj ekzekutivin që të gjejë një vend në buxhetin e vet për këtë projekt, jo shumë të kushtueshëm, por mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e Rahovecit dhe zhvillimin e turizmit të Rahovecit. Te ndarjet buxhetore, kërkesat e mia të përhershme janë subvencionimi i grave në bizneset e tyre, nuk e di a nuk di unë me lexu buxhetin apo këtë pjesë e keni lënë pezull, nuk e keni qartësu, ose e keni lënë me bë “t'u pa t'u bo”.

Kryetari - Faleminderit, pikërisht që e kam dëgjuar Krushën, Shtëpia-muze e Bajram Currit është në proces të tenderimit, fusha sportive është e bërë para masave të projektit, kemi apliku, po edhe ne kemi planifiku vetë, me marr nga Qeveria, prej Ministrisë edhe më mirë nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, e kolektori i ujërave të zeza veç është në proces, pothuajse është në vlerësim edhe tash me siguri edhe lidhet kontrata, kolektori i ujërave të zeza edhe rrugët për atë parkun e biznesit atje, Shtëpia e Kulturës, po ashtu në Celinë, krejt çka kam marrë përgjegjësi nga Kuvendi i Komunës, unë kam dëgju, po veçse e përmendi Sefa që s'po na dëgjon ndonjëherë edhe neve, në këtë kuptim. Unë kam dëgju me vëmendje gjithë kohën edhe po dëgjoj edhe tash. Ideja është se kurrë, çfarëdo përgjigjeje që kam marrë prej Kuvendit, unë nuk i kam ikur, unë ndoshta mundem me i ikë si ekzekutiv, mirëpo kurrë nuk i kam ikur. Pra, çka u vendos në Kuvend, ne kemi shkuar tutje. Edhe rrethrotullimi, veç e dëgjova fjalën arsyetim, unë nuk jam marrë këtu me i marrë arsyetime, ju lutem, jam shumë i saktë në atë çka dua të them. Rruga Prizren-Gjakovë është rrugë magjistrale, jo rajonale. Tash, a kemi kërku prej Ministrisë me rikthy procesin ndoshta në pikën zero edhe me bë rrethrotullimin në Krushë. Ju kam treguar edhe në seancën e kaluar edhe po ju them prapë. Është përgjegjësi direkte e Qeverisë, e Ministrisë. Nuk bëj unë arsyetime këtu. Le të ma japë mua ministria lejen, unë vetë e bëj atë rrethrotullim. Po ne s'kemi të drejtë me prekë në rrugën magjistrale, as rrethrotullim, as kurrigjë. Po presion ti, duhet me pyet a po bëni presion. E mos thuaj a po vjen me mua, e di që e ka me u arsyetu tash kryetari. Unë s'arsyetohem këtu. Po presion bëjmë. Edhe përsëri nga sot do te vazhdojmë të bëjmë presion për aty, pastaj te Gradishi, edhe disa pika që janë nevralgjike dhe po ka rreziqe. Këto nuk janë në punën tonë, por kompetencat tona apo punët tona janë me bë presion. Te muzeu në Krushë, Muzeu i Kompleksit Përkujtimor, janë duke u kryer punë përfundimtare brenda. E do të kemi edhe disa punë jashtë. Besoj që me njëzet e gjashtë mars do të jemi gati me

të gjitha. Te Shtëpia-muze e Ukshin Hotit, qendra muzeore, kemi edhe disa punë që janë pa u kryer, kështu që unë propozoj që me njëzet e tetë nëntor me mbajtë një seancë të solemne aty në shtëpinë në qendrën muzeore Ukshin Hotit, se edhe mjedisi është i përshtatshëm edhe do të ishte një seancë e mirë ose një mesazh i mirë. Te përroi unë përsëri nuk po bëj arsyetime, pasi shpjegimin e dhashë më herët. Madje, në pikën e ridestinitimit e kam dhënë shpjegimin për përroin në Krushë të Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Hoçë e Madhe. Këtë projekt e ka larguar ministria nga kodi. Ne e kemi paraparë me rikthi kodin si komunë, po pa e buxhetu tash, po me bartje të të hyrave, në qoftë se na lëviz diçka nga ministria, mirë se vijnë, sepse edhe ashtu ata e kanë pasur përsipër me financu, e kanë hequr, po ne, mos bëfshin kurrë ata, ne duhet me rifillu vetë procedurën. Pra, projekti është gati edhe duhet me këqyrë edhe një herë mos ka ndryshuar diçka në atë projekt edhe me bë ne si komunë. Do të ishte mirë me bë ministria, po duhet. E shpjegova më herët. Për projektin që foli, Merisa. Ju e keni bërë një projekt dhe i falënderoj edhe kam kërkuar që ata me bë projekt kryesor, e kurrë s'kanë mbërri me bë projekt kryesor, për shkak se keni menduar që mos i mbetet nami ndokujt. Namin unë ua kisha dhënë juve që e keni bërë projektin, pa marrë parasysh që financimin e kishim bërë ne si komunë. Çka ka ndodhur? Hapi i parë që e kemi bërë ne, e kemi marrë një pronë nga Agjencioni Pyjor, e kemi bërë pronë të komunës. Hapi tjetër që e kemi bërë ne, e kemi aplikuar në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe do të bëhet ai. Po ju ashtu qysh e keni planifikuar ju, se ju s'e keni çuar në fund, e vlerësojmë punën tuaj, po do të bëhet një projekt që quhet Ballkoni Panoramik, sepse ashtu është edhe në komponentët e thirrjes publike që e kanë lëshuar ministria edhe ka me qenë një projekt më i mirë sesa që ju e keni planifikuar. Edhe duke ju falënderuar për kontributin tuaj profesional, e unë kam tentuar ta përvetësoj atë projekt, jo si Smajl, por si komunë që me bë edhe pjesën, pasi e keni bërë projektin ideor, bën edhe kryesoren, s'e keni bërë kurrë, po projekti do të bëhet në të njëjtin vend, edhe projekti nuk është pak i kushtueshëm, ne kemi aplikuar për 320,000 euro. Edhe projekti ideor ekziston, projekti kryesor do të bëhet, shpresoj që Ministria e Zhvillimit Rajonal, meqenëse sivjet s'na ka ndihmuar kurrë, për vitin e ardhshëm, na veç dihet paraprakisht na kanë thënë që edhe zëvendësministrat e ministrit që iu kemi borgj si komunë. Na kemi kaluar fazën e parë, na ka hequr dikush kinse komuna jonë ka fituar gjithmonë projekte prej MZHR-së, na kanë diskualifikuar në fazën e dytë, me qëllim, unë e kam bërë alarm, jo alarm medial, po alarm me ministrinë, e ata kanë me rikthi, me këtë projekt kemi konkurruar, tash ky projekt është vërtet konkurrues, e kemi fitu. Subvencionimi i grave, ne ende edhe tre muaj i kemi pa përfunduar viti, i kemi disa subvencione, jo kam thënë Merisë, këto që do të subvencionohen, sivjet më pak se s'ka mundësi shumë, po ka me fillu sivjet subvencionimi i zanatqinjëve, domethënë artizanaleve, edhe besoj që ne i kemi disa mjete, ato çka i kemi pasur, nuk i kemi zbuluar, edhe ato mjete kemi me ia nis vitin e ardhshëm. Pra, unë po besoj që jemi brenda kornizës, edhe një herë po ju ftoj me votu projekt-buxhetin për vitin dy mijë e njëzet e katër. Faleminderit shumë!

Merisa Sharku - Projekti kryesor ka ekzistuar, e kemi përfunduar, por mënyra e kërkesës tënde që me përvetësu projektin edhe me marrë meritat, si gjithmonë qysh ndodh, si grup na ka shtyer prapa që mos me leju me ardhë deri aty që me u ditë autori, mirë që e përmendi dikush. E dimë që kryetari ka pretendime që gjithmonë me marrë meritat vetë dhe për atë arsye ka ndodhur që ne nuk kemi dashtë. Krejt qytetarët e Rahovecit e dinë se sa shumë si grup kemi dhënë për këtë projekt edhe s'kemi lënë vend pa shkuar nëpër ministri e çdokund edhe krejt ministrat kanë qenë të njoftuar për këtë projekt edhe s'ke nevojë tash me i marrë meritat e me thënë që ne e kemi bërë një projekt kur ideja edhe gjithçka, krejt qytetarët e Rahovecit e dinë që ka qenë e grupit të "Grapeland"-it. Pronën prej Agjencisë së Pylltarisë, ne si grup, si OJQ, e kemi në emrin tonë edhe ne e kemi marrë vetë.

Kryetari - Nuk ka më keq në këtë botë se sa mos me ditë dikush çka po flet. E para, unë e dashta me të respektu, po s'ka lidhje, ky projekti i Ballkonit Panoramik në atë projektin e juaj. Hiç, është krejt projekt tjetër, sepse ne OJQ-të i respektojmë, po ne nuk jemi të obliguar t'i zbatojmë kërkesat e OJQ-ve. Më së pari, ju si OJQ nuk ekzistoni hiç, tash edhe krejt që tash a keni punuar, janë me mua tash, nuk janë me ty, nuk janë me grupin e juaj. Ballkoni Panoramik është projekt tjetër, edhe ajo pronë, mos e harro kurrë, është pronë e Komunës së Rahovecit edhe absolutisht aty ju mundeni me shku me shëtit kur të bëhet projekti me rekreacion,

do të jetë një vend i mirë, ka me pas vizitorë shumë, po aty ajo është pronë e komunës, jo e Smajl Latifit. Ndërsa unë, nuk jam Albin Kurti me i përvetësu sendet, a kuptova tash, pasi kam dashtë me marr e kam lut atë shëfën e juaj, i cili kam taku tash edhe ky projekt kryesor është Plan ideor edhe disa skica, kurrëgjë s'ka hiç. Fotografi unë gjej me i marr nëpër Kinë e nëpër Indi, se sa të doni, u gjej unë fotografi turistike, po projekt s'ka. A e keni të qartë? Unë e di, që ku është Rumiri, drejtor, i kam takuar unë, ju kam takuar edhe juve, sillni bre sillni, jeni frikësuar që kushedi se çka po bëhet. Ju e dini që unë publikisht ju kisha falënderuar, qysh ju falënderoj edhe sot, edhe e kam guxim me shpreh mirënjohje për kontributin e të tjerëve, mirëpo, ai projekt është vetëm ideor dhe është aq i mangët sa mendja nuk ju merr. Prandaj, ti nuk e di as sa kushton, sepse s'keni bërë më tutje, veç e keni çuar deri diku edhe e keni lënë ashtu. Në qoftë se e keni bërë ju nëpër sirtarët e juaj, i keni lënë, është tjetër, në Komunë e di çfarë keni sjellë. Me logjikën e juaj se Komuna është e Smajl Latifit, ju them se Komuna e Smajl Latifit kurrë nuk ka qenë, por e Vetëvendosjes kurrë s'ka me qenë. Me këtë logjikë, me të pavërteta, me improvizime, me kësofarë tendencash, Unë thashë, ata njerëzit, më vjen keq se më ka ardhë turp me ia dhënë librezën, se edhe librezën e merr. Ata shefat që juve ju kanë mësuar tash ata janë tërhequr, ju kanë lënë juve të bëni zhurmë. Projekti është Ballkoni Panoramik. Edhe për hatër tuaj nuk ka me pas Grapeland, por ka me pas ndryshe.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! Po, një jashtë. Pas diskutimeve të shumta, të drejtën e replikës e keni kryer dhe kërkojmë mirëkuptim që të vazhdojmë seancën, e hedh në votim këtë pikë, konstatoj se me 19 vota pro, 10 kundër dhe asnjë abstenim, votohet buxheti për vitin 2024 në Kuvendin komunal të Rahovecit. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së Komunës së Rahovecit P-00266-0, ZK- Hoçë e Madhe.

Erhan Morina - Të nderuar anëtarë, para jush keni vendimin për dhënien në shfrytëzim përmes interesit të përgjithshëm të Fabrikës së Kartonit, e cila gjendet në Hoçë të Madhe, për njëzet e pesë vjet. Kjo pikë ka kaluar në seancën e Kuvendit të Korrikut, do të thotë kushtet dhe kriteret i ka përcaktuar Komisioni. Çmimi minimal ka qenë pesëqind e pesëdhjetë euro. Në këtë ankand publik ka marrë pjesë veç një ofertues, i cili ka ofertuar me pesëqind e shtatëdhjetë euro. Komisioni e ka konstatuar që kriteret kanë qenë në rregull, nuk ka pasur ndonjë shkelje, janë respektuar të gjitha procedurat ligjore, kështu që ne si Komision rekomandojmë Kuvendin e Komunës së Rahovecit që ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës, me qëllim që kryetari i Komunës në afat ligjor të lidhë kontratë me kompaninë e cila ka ofertuar në këtë ankand. Ftoj anëtarët e Kuvendit që ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës.

Burim Krasniqi, Faleminderit shumë! Unë kam vetëm një pyetje, jo rreth vlerësimit, është Komisioni profesional, nuk dua të ndërhyj. Objekti në fjalë, drejtor, a i është nënshtruar procedurës së legalizimit, a keni e legalizuar? Në qoftë se jo, ju lutem, meqenëse është, besoj që është proces i hapur në **ala**, është objekt i komunës, është investitor privat mbi bazën e një kontrate dikur që i ka pasur, aset komunal, legalizojeni, të futet te pjesa e aseteve të komunës dhe të jetë tamam legale për të ardhmen. Faleminderit shumë!

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës. Me shumicë të votave aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

8. Informatë nga DKA-ja për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024

Ftoj zyrtarin Jeton Krasniqi për prezantim të kësaj pike nga Drejtoria e Arsimit.

Jeton Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, besoj se informata ju ka ardhur si material për këtë mbledhje të kuvendit, unë mundem të ju lexoj nëse jeni të pajtimit, por nëse jo atëherë jam i hapur për çdo lloj pyetjeje, ju faleminderit!

Lirigzon Kastrati, Faleminderit, kryesues! Faleminderit zyrtari i DKA-së për paraqitjen dhe informatën. E pata edhe unë një pyetje, e di që këtë vit shkollor shkollat janë ballafaquar edhe stafi menaxherial i shkollave, drejtorët me këtë problemin e pajisjeve të librave. Në rregull me ata që Qeveria i ka kompensuar, domethënë

me tetëdhjetë euro për furnizim me libra shkollorë, por më intereson për klasat e gjashta, të nënta, të shkollave të komunës sonë, a janë të furnizuar krejt shkollat, domethënë krejt me këto pajisje shkollore, a janë kthyer këto libra dhe a janë të gatshme që këta nxënës me fillu vitin e ri shkollor qysh duhet? Nëse ke informacion, mirë, nëse jo, mundem me prit përgjigjen me shkrim nga ana e drejtorit.

Dëfrim Kafexhiu - Faleminderit, kryesues! Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Po e shoh që edhe në informatën e këtij viti shkollor, këtij fillimviti shkollor, po e shoh që Drejtoria Komunale e Arsimit po mundohet me gjetë të paktën një pengesë apo një lëshim apo një problem që ka ndodhur prej Ministrisë së Arsimit për çështjen e furnizimit me libra, po unë po besoj që Drejtoria Komunale e Arsimit ka më shumë probleme që duhet m'u marrë me to, sesa që kjo që ka ndodhë tash me libra. Nuk kemi rezultate dhe nuk kemi përparim në sistemin e arsimit prej këtij ekzekutivi politik apo prej Drejtorisë së Arsimit. Nëse e shohim më thjesht, Komuna e Rahovecit po has në mungesë të kuadrove që, edhe nëpër konkurse specifike që po hapen prej Komunës së Rahovecit, nuk po ka kuadro që me u punësu edhe për shkak të drejtimeve specifike që po kërkohen. Edhe po du me e pyet kryetarin, meqenëse drejtori i Arsimit nuk është aty, a ka ndonjë plan strategjik të zhvillimit në karrierë për nxënësit e shkollave të mesme në Komunën e Rahovecit? Për shkak se ky është një problem që po besoj një pjesë të madhe mundet me e kry edhe Komuna, ku me u dhënë përparësi me anë të bursave, për shkak se bursa për drejtime specifike ku kemi mungesë të kuadrove, për shkak se e dimë edhe forma e punësimit në arsim qysh është, po edhe forma e ndarjes së subvencioneve për bursa për nxënësit është e politizuar. Kështu që, po e pyes kryetarin a ka ndonjë plan që mundet me u siguru për shembull nxënësve apo me u dhënë një mbështetje për me i orientu ata në karrierë në plotësimin e kuadrove që janë në suficit.

Kryetari - Faleminderit Jeton edhe faleminderit për kontributin që po e jepni në informatën që e ka sjellë DKA-ja, që në këtë rast po e transmeton informatën e përgatitur nga drejtori i DKA-së. Informata është, ka të bëjë me përgatitjet e vitit të ri shkollor. Meqenëse ka të bëjë me përgatitjet e vitit të ri shkollor, besoj që ne nuk jemi fajtorët është që ka dështuar ministria në furnizim me libra dhe ka gjetur një model tjetër. Një model që Kosovës, deri më tani, i kushton një herë, një dy herë më shtrenjtë sesa që ka mundur t'i kushtojë, në qoftë se do të kishte kontratë me shtëpitë botuese. Por, tash unë nuk dua me cilësu paaftësi, se është më shumë sesa paaftësi, mundet me pasë edhe diçka tjetër, po nuk jam kompetent me bë komente të ministres së Arsimit, as Ministrisë së Arsimit. Tek e fundit, fare nuk ish marrë DKA-ja me këtë informatë ose me këtë çështjen e librave sikur të mos kish qenë e vërtetë kjo. Pra, edhe një herë para të vërtetës edhe për të vërtetën, në këtu jemi. Është ndërlidhur direkt me furnizimin me libra që kanë nevojë, është ndërlidhur direkt a i ke dorëzu libra tash këta që i kanë disa libra të shkruara që i kanë përdorur një vit, i kanë shqyer nga pak, i kanë shkruar nga pak aty diçka, unë nuk kam qene mësimdhënës asnjëherë por e di si qëndron ajo punë dhe tash e vërteta është se i kanë dorëzuar dhe kjo për herë të parë po ndodh në historinë e arsimit të Republikës së Kosovës, nuk është dashtë me ndodh pasi është çështje që do të tejkalohet. Ne e kemi krijuar edhe e kemi përruruar qendrën e karrierës në Institutin e Arsimit dhe Aftësimin profesional "Selajdin Mullabazi-Mici". Edhe besoj që me nxjerrjen e këtij produkti, me funksionalizimin e vazhdueshëm të këtij mekanizmi, këtij institucioni, do të ketë mundësi shtesë, mundësi të reja për orientimin e njerëzve tanë, nxënësve tanë në karrierë. Një orientim më të qartë që ata që vendosin të arsimohen, të kenë arsim universitar, ose edhe arsim profesional, atëherë sigurisht do ta kenë më të lehtë me iu përgjigj tregut të punës, kushteve, kërkesave që ka tregu i punës dhe trendit që është duke shkuar Republika e Kosovës. Mirë është që qendra e karrierës është funksionale dhe po besoj që edhe kontributi i Komunës nuk do të mungojë në këtë drejtim, mirëpo prej se merrem me politikë, asnjëherë nuk kam dëgjuar që çdo gjë duhet me lidh me politikë. Të gjithë ata që kanë aplikuar nxënësit e shkollës se mesme, përveç që kanë qenë dy, vëlla e motër, të gjithë janë përkrahur për herë të parë me bursa këtë vit. Dhe nëse dikush i ka pyet ata se kush janë dhe cilës parti i takojnë, pasi ka disa kriterë që është vendosur dhe do të vazhdojë përkrahja nxënësve e sidomos e atyre nxënësve që kanë cilësi dhe synime për me pas arritje në karrierë. Ndërsa sa i takon bursave për studentë që janë klasifikuar, ata që kanë notën mesatare mbi 9, i kanë marrë nga 60 euro, pasi kaq janë mundësitë buxhetore, kurse të tjerët me nga 50 euro, dhe po besoj që askush

nuk ka mbet pa u përfshirë edhe në aplikacionet për bursa, kështu që do të ishte mirë me lënë jashtë ndonjëherë politikën, nga Kuvendi, edhe me harru se ne bëjmë politikë brenda kuvendit dhe me largu termin politik, pasi unë nuk përdori gjuhë denigruese, por përdori fakte. Pra, studentet të cilët kanë përfituar në bursa, janë 174, plus fondacioni “Shyqeri Makshana” i ka katër studentë dhe disa të tjerë me ankesa, kështu që është rritur numri i studenteve që kanë përfituar. Pra, kjo është në interesin e Komunës së Rahovecit dhe për anëtarët e kuvendit dhe qytetarët e komunës, që me një lehtësi sado të vogël për familjet që kanë një apo më shumë studentë në komunën tonë. Drejtimet specifike, sigurisht se kemi plan me i përkrah, por konkurset që hapen e që s’ka drejtim të Matematikës as në Gjakovë, pasi nuk konkurron askush dhe të imponohet që me marr një kuadër tjetër që me zëvendësu dhe për këtë nuk jemi në fajtorë apo edhe ne të gjithë jemi fajtorë për shkak se unë nuk jam në situatën që me vendos se cili ka me shku në matematikë e cili në fizikë, apo cili në juridik apo cili në inxhinieri. Kështu që njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin vetë dhe detyra jonë me kriju rrethana edhe me ju sjellë favore që me zgjedh aty ku përfitimet janë më të mëdha, si nevojat e komunës dhe të shtetit. Pra, është e vërtetë që na dështojnë konkurset për matematikë apo fizikë, pasi nuk ka dhe neve na duhet me gjet zgjidhjen. Sigurisht se ne do të vazhdojmë përkrahjen me bursa, bile jemi duke shiku që a mundemi me rrit vlerën financiare të bursave dhe gjithashtu do të vazhdojmë përkrahjen për nxënësit, bile do të rritet numri i nxënësve të shkollave të mesme, në mënyrë që ata me pas një lehtësi apo dorë të zgjatur nga komuna dhe ne do të kemi bërë takime dhe të organizojmë tryeza edhe me ekspertë të fushës e madje ka plot aktivitete që zhvillohen edhe në komunën tonë për orientim në karrierë. Por tani nuk jemi në situatën kur mundemi me ia imponu vullnetin e dikujt që me orientu në një drejtim të caktuar.

Defrim Kafexhiu – Te çështja e politizimit e veprimeve tuaja është diçka faktike, kështu që nëse unë flas dhe bëj politikë në Kuvend, sigurisht se kuvendi është vendi i politikbërjes përndryshe ju edhe veprimet i keni politike. Te bursat e studenteve është shumë mirë që po subvencionohen studentët me bursa, edhe nxënësit e shkollës se mesme, por kriteret aty po dallojnë, kështu që si Komunë, si institucion, mundesh me bë një nxitje në orientimin e nxënësve në drejtimet specifike, përndryshe, meqenëse i përmende bursat e studentëve, keni dhënë bursa për studentë që edhe janë duke punuar, edhe i kanë kushtet më të mira se më shumë se gjysma këtu që jemi të pranishëm.

Kryetari – E para, rregullorja e Kuvendit nuk ka mundësi kryetarit të Komunës mos me ia dhënë fjalën, po ashtu unë me politikë merrem, mirëpo nuk bëj politikë pa moral, pasi të gjithë aplikuesit janë përfitues, mirëpo më shumë përkrahje ju japim atyre që kanë drejtime deficitare, pra aty që ka nevojë më shumë komuna, por unë nuk e përjashtoj asnjëherë as familjarin e dëshmorit, të invalidit, as rastet sociale, as ata që kanë një apo më shumë studentë dhe asnjëherë nuk do të anashkalohen rastet e tilla, pasi deri më tani mua më bën të ndihem mirë që kam pasur mundësi t’u ndihmoj edhe shumë të tjerëve që kanë nevojë për ndihmën e tonë. Unë nuk e kam të ndaluar të drejtën e fjalës për shkak se ma lejon rregullorja, mirëpo anëtarët e kuvendit kanë një rregullore që do të ishte me zbatu dhe shëfat e grupeve kanë një përgjegjësi tjetër dhe kanë mundësi me operu më shumë në këtë drejtim.

9. Informatë për muajin e mërgimtarëve prej 15 korrikut, deri më 15 gusht 2023.

Afrim Dina – Ne edhe me planin e punës se kuvendit, e kemi pasur që të japim informatën për muajin e mërgimtarëve nga 15 korriku, deri më 15 gusht 2023. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si bartëse e të gjitha aktiviteteve për muajin e mërgimtarëve, ju informojmë për mbarëvajtjen dhe procesin përgjatë muajit të mërgimtarëve prej 15 korrikut, deri më 15 gusht, që i ka organizuar aktivitetet në gjithë territorin e komunës sonë. Manifestimet tradicionale për muajin e mërgimtarëve kanë filluar më 15 korrik ku kemi bërë hapjen e një koncerti në qytet, konkretisht në rrugën “Xhevat Kasapi”. Me qellim të ofrimit të mundësive për takime reciproke ndërmjet mërgimtarëve tanë dhe takimeve me autoritete lokale, kryetari komunës, z. Smajl Latifi, ka pritur në zyrën e tij shumë mërgimtarë me të cilët ka biseduar për gjendjen socio-ekonomike në Komunën e Rahovecit, si dhe ka dëgjuar te gjitha propozimet, këshilla, por ka kërkuar nga të gjithë mërgimtarët që zhvillojnë biznese në Perëndim, që të mundohen dhe të gjejnë mundësi për investime kapitale dhe hapje të bizneseve edhe në komunën tonë. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, së bashku edhe me drejtori të tjera, si

të Administratës, DKA-së, Ekonomisë, Bujqësisë, aktivitetet që i kemi organizuar janë gjithsej 16 -të në komunën tonë. Në kuadër të muajit të mërgimtareve është organizuar takim edhe me biznese, gjithashtu edhe në kuadër të muajit të mërgimtarëve është organizuar edhe Agrofesta, e cila është mbajtur në Krushë të Madhe, ku janë prezantuar të gjitha prodhimet bujqësore të cilat janë pjesë e jona dhe kemi pasur edhe koncerte ku ka marrë pjesë edhe këngëtari i madh, Sabri Fejzullahu, e shumë këngëtarë të tjerë. Po ashtu kemi organizuar edhe aktivitete sportive, turne në futboll, i cili është mbajtur në Ratkoc, pastaj në shah dhe gjithashtu mbrëmjen apo Sofrën e Mërgimtarit nëpër disa vendbanime të komunës tonë. Tani shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjitha bizneset që kanë treguar bashkëpunim dhe gatishmëri e sidomos në aktivitetet që i kemi mbajtur në qytet në rrugën "Xhevat Kasapi" që kemi pasur një bashkëpunim të mirë e gjithashtu i falënderoj të gjithë qytetarët pjesëmarrës që kanë pjesë në të gjitha këto aktivitete, nuk e kemi pasur as edhe një ekces sado të vogël. Po ashtu e falënderoj edhe Policinë e Kosovës e cila ka qenë e pranishme në të gjitha aktivitetet për sigurinë e qytetarëve tanë. Pra, në material i keni të paraqitura në fotografi për të gjitha aktivitetet që i kemi mbajtur në të gjitha vendbanimet e komunës tonë.

10. Vendim për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.129/23, i datës 30.08.2023 për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore.

Në fillim të seancës, drejtori e beri prezantimin sa i përket kësaj pike, atëherë nëse nuk kemi, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi - Atëherë, këtu po e përmbyllem seancën e sotme, shihemi në seanca të tjera!

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



KOMUNA RAHOVEC

RAPORTI FINANCIAR JANAR-SHTATOR

202



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Përmbajtja

HYRJE.....	2
1. TË HYRAT VETANAKE.....	3
1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2023/2022	3
1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2023/2022 dhe krahasimi i tyre.....	3
1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2017-2023.....	4
1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut, dhe gjobat nga gjykatat 2023/2022.....	4
1.5 Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik 2023/2022.....	4
1.6 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2023/2022.....	5
2. TATIMI NË PRONË.....	6
2.1 Planifikimi dhe realizmi i tatimit në pronë 2023/2022.....	6
2.2 Shpërndarja e faturave, regjistrimet dhe verifikimet e objekteve në Tatimin në Pronë.....	7
3. REALIZIMI I BUXHETIT.....	8
3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtorive.....	8
3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike.....	9
3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve.....	10
3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike.....	15
3.5 Shërbime Komunale.....	17
4.0 RAPORTI PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE.....	18

HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori - Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsim dhe Shkencë për periudhën Janar - Shtator 2023, duke përfshirë kategoritë ekonomike të paga & mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetjake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Shtator të vitit 2022/2023

Buxheti i Komunës për vitin 2023, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2023, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
 - Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
 - Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,
 - Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.
- ❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:
- Realizimi i të hyrave vetjake-komunale sipas burimeve,
 - Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
 - Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

1. TË HYRAT VETANAKE

1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2023/2022

Përshkrimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Ndryshimi 2023-2022	Krahasimi 2023/2022
Të hyrat e rregullta	929,072.70	1,450,652.50	521,579.80	56.14 %

-Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2022 dhe 2023 janë pa gjobat e trafikut dhe gjykatave.

1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2023/2022 dhe krahasimi i tyre.

Periudha	Realizimi 2022	Planifikimi 2023	Realizimi 2023	Ndryshimi Realizimi/Planifikim 2023	Përqindja e Realizimit 2023
	1	2	3	3/2	3/2
Janar	66,546.55	120,466.92	102,903.74	(17,563.18)	(14.58)
Shkurt	69,046.40	120,466.92	98,383.47	(22,083.45)	(18.33)
Mars	119,738.61	120,466.92	157,671.40	37,204.48	30.88
Prill	144,682.98	120,466.92	280,607.75	160,140.83	132.93
Maj	93,475.56	120,466.92	273,175.62	152,708.70	126.76
Qershor	105,034.28	120,466.92	117,174.95	(3,291.97)	(2.73)
Korrik	115,322.77	120,466.92	103,713.52	(16,753.40)	(13.91)
Gusht	150,878.51	120,466.92	198,025.06	77,558.14	64.38
Shtator	64,347.04	120,466.92	118,996.99	(1,469.93)	(1.22)
Totali	929,072.70	1,084,202.25	1,450,652.50	366,450.25	133.80

1.3 Krahاسimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2017-2023.

Periudha	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Janar	65,258.72	71,296.21	67,441.16	73,433.20	79,206.53	66,546.55	102,903.74
Shkurt	53,970.89	79,441.98	101,728.36	90,756.67	85,381.57	69,046.40	98,383.47
Mars	123,917.27	100,586.69	77,787.87	80,321.71	116,898.68	119,738.61	157,671.40
Prill	67,409.06	74,037.40	88,525.55	19,328.99	107,245.33	144,682.98	280,607.75
Maj	86,337.92	64,983.12	90,937.21	27,181.24	81,201.86	93,475.56	273,175.62
Qershor	55,212.16	65,779.79	102,804.51	113,580.53	78,604.19	105,034.28	117,174.95
Korrik	69,950.39	72,593.52	84,884.33	102,990.93	93,519.12	115,322.77	103,713.52
Gusht	84,523.01	88,320.39	103,839.12	119,444.48	147,698.34	150,878.51	198,025.06
Shtator	61,105.72	66,711.18	132,861.21	175,103.89	133,644.70	64,347.04	118,996.99
Totali	667,685.14	683,750.28	850,809.32	802,141.64	923,400.32	929,072.70	1,450,652.50

1.4 Krahاسimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut, dhe gjobat nga gjykatat 2023/2022.

Gjobat në trafik në baza mujore**Gjobat e gjykatës baza mujore**

Muajt	Gjobat e trafikut 2022	Gjobat nga trafiku 2023	Ndryshimi 2023-2022	% 2023/2022	Gjobat e gjykatave 2022	Gjobat e gjykatave 2023	Ndryshimi 2023-2022	% 2023/2022
Janar	26,449.50	18,680.00	(7,769.50)	(29.37)	8,740.00	2,483.33	(6,256.67)	(71.59)
Shkurt	26,237.00	19,310.00	(6,927.00)	(26.40)	4,360.00	1,761.00	(2,599.00)	(59.61)
Mars	29,404.50	24,695.00	(4,709.50)	(16.02)	1,600.00	3,300.00	1,700.00	106.25
Prill	26,370.00	18,885.00	(7,485.00)	(28.38)	2,435.00	1,570.00	(865.00)	(35.52)
Maj	19,405.00	22,045.00	2,640.00	13.60	4,400.00	1,101.00	(3,299.00)	(74.98)
Qershor	20,641.00	21,080.00	439.00	2.13	1,751.33	1,120.00	(631.33)	(36.05)
Korrik	20,325.00		(20,325.00)		1,901.33		(1,901.33)	
Gusht	31,225.00		(31,225.00)		2,671.33		(2,671.33)	
Shtator	23,060.00		(23,060.00)		6,510.00		(6,510.00)	


Totali	223,117.00	124,695.00	(98,422.00)	(44.11)	34,368.99	11,335.33	(23,033.66)	(171.50)

Vërejtje: Në këtë tabelë nuk janë të përfshira të hyrat nga gjobat e trafikut dhe gjykatave për TM3 të vitit 2023

1.5 Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik 2023/2022

Përshkrimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Ndryshimi 2023-2022	Krahasimi në % 2023/2022
Të hyrat e rregullta	929,072.70	1,450,652.50	521,579.80	56.14
Gjobat e gjykatave	34,368.99	11,335.33	(23,033.66)	-67.02
Gjobat e trafikut	223,117.00	124,695.00	(98,422.00)	-44.11
Të hyrat nga pyje	51.00	60.00	9.00	17.65
Totali	1,186,609.69	1,586,742.83	400,133.14	33.72

Paraqitja Grafike të hyrat 2022/2023



1.6 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2023/2022

	Përshkrimi	Planifiki mi 2023	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Ndryshi mi 2023-2022	Krahasimi në % 2023/2022	Realizim/Planifikim 2023 në %
40110	Tatimi në pronë	423,250.00	366,997.22	895,074.35	528,077.13	143.89	211.48
40110	Tatimi ne Tokë	367,264.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50001	Taksa per Regjistrimin e Automjeteve - Kod i ri	0.00	66,347.00	81,114.00	14,767.00	22.26	#DIV/0!
50002	Taksa rrugore	90,000.00	9,420.00	0.00	9,420.00	-100.00	0.00
50009	Taksa komunale për leje ndërtimi	36,000.00	18,654.35	35,273.02	16,618.67	89.09	97.98
50010	Taksa për demolim	2,000.00	1,194.94	394.00	-800.94	-67.03	19.70
50011	Taksa regjistrimin e trashigimisë	30,000.00	24,621.00	22,353.00	2,268.00	-9.21	74.51
50012	Taksa për ndrrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	1,000.00	245.59	105.85	-139.74	-56.90	10.59
50013	Taksa për certifikatat e lindjes	14,000.00	2,213.00	3,001.50	788.50	35.63	21.44
50014	Taksa për certifikatat e kurorzimit	8,000.00	8,435.00	6,547.00	1,888.00	-22.38	81.84
50015	Taksa për certifikatat e vdekjes	2,000.00	701.00	1,085.00	384.00	54.78	54.25
50016	Taksa për certifikatat e tjera të ofiqarisë	45,389.00	42,213.00	41,760.00	-453.00	-1.07	92.00
50017	Taksa per verifikimin e dokumenteve te ndryshme	5,000.00	4,075.00	4,717.00	642.00	15.75	94.34
50019	Taksa të tjera administrative	44,000.00	24,905.70	17,067.00	7,838.70	-31.47	38.79
50020	Taksë për pjesëmarrje në tender	200.00	0.00	12,950.00	12,950.00	#DIV/0!	6,475.00
50026	Takse për legalizimin e objekteve	21,000.00	17,889.48	0.00	17,889.48	-100.00	0.00
50029	Takse për ushtrimin e veprimtarisë	75,000.00	79,403.90	60,914.00	18,489.90	-23.29	81.22
50032	Taksa për certifikatat të Pronsisë	0.00	4,284.00	14,244.00	9,960.00	232.49	#DIV/0!
50045	Leje mjedisore komunale	8,000.00	3,981.75	5,843.47	1,861.72	46.76	73.04
50103	Largimi dhe deponimi i automjeteve	500.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50104	Gjjobat nga inspektoriat	5,000.00	10,270.00	46,344.69	36,074.69	351.26	926.89
50201	Licencat për aktivitete individuale dhe të lira	300.00	181.00	742.00	561.00	309.94	247.33
50205	Licencat për pranim teknik të lokalit	1,000.00	1,030.00	1,215.00	185.00	17.96	121.50
50206	Licencat për shërbimet profesionale	0.00	20.00	117.00	97.00	485.00	#DIV/0!
50290	Licencat tjera për afarizëm	0.00	450.00	1,890.00	1,440.00	320.00	#DIV/0!
50401	Shitja e shërbimeve	3,000.00	642.00	737.50	95.50	14.88	24.58
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	4,000.00	744.16	2,983.50	2,239.34	300.92	74.59
50407	Qiraja për vendosjen e objektit tregtar	82,000.00	56,555.27	82,043.14	25,487.87	45.07	100.05
50407	Qiraja nga objektet e	3,000.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00


RAPORTI FINANCIAR JANAR-SHTATOR							202
	përkoshme (Sh.Publike)						
50408		3,000.00	2,507.75	2,887.08	379.33	15.13	96.24
	Qiraja nga objektet publike						
50409	Participimet-Bujqësia	42,000.00	97,236.59	31,545.10	65,691.49	-67.56	75.11
50409	Participimet-Shëndetësia	80,000.00	38,164.50	30,057.80	8,106.70	-21.24	37.57
50409	Participimet-Qerdhja e Femijeve	22,000.00	22,815.50	21,750.00	1,065.50	-4.67	98.86
50409	Participimet-Arsim jo formal	200.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50503	Inspektimi rrespektimit të planit urbanistik	2,000.00	1,900.00	0.00	1,900.00	-100.00	0.00
50504	Taks për matjen e tokës në teren	25,000.00	20,974.00	25,896.50	4,922.50	23.47	103.59
50507	Inspektimi higjenik sanitar	500.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
	Të hyrat pa gjobat	1,445,603.00	929,072.70	1,450,652.50	521,579.80	156.14	100.35
	Gjobat e gjykatave	0.00	34,368.99	11,335.33	23,033.66	32.98	#DIV/0!
	Gjobat e trafikut	0.00	223,117.00	124,695.00	98,422.00	55.89	#DIV/0!
	Të hyrat nga pyje	0.00	51.00	60.00	9.00	117.65	#DIV/0!
	Totali	1,445,603.00	1,186,609.69	1,586,742.83	400,133.14	133.72	9.76

2. TATIMI NË PRONË

2.1 Planifikimi dhe realizmi i tatimit në pronë 2023/2022

Periudha	Të planifikuara	Të realizuara	Të planifikuara	Të realizuara	Përqindja e realizimit	Përqindja e realizimit	Krahasoni në %	Nr. çert të lëshuara	Nr. çert. të lëshuara	Nr fatura ve të paguara	Nr fatura ve të paguara
	2022	2022	2023	2023	2022	2023	2023/2022	2022	2023	2022	2023
Janar	58,509.75	25,056.86	65,876.17	55,232.10	42.83	-16.16	120.43	748	831	503	2323
Shkurt	58,509.75	25,393.10	65,876.17	41,439.57	43.40	-37.09	63.19	568	639	499	1761
Mars	58,509.75	47,793.81	65,876.17	106,186.79	81.69	61.19	122.18	710	732	847	3920
Prill	58,509.75	62,765.81	65,876.17	216,019.27	107.27	227.92	244.17	643	536	1056	9831
Maj	58,509.75	37,900.67	65,876.17	219,517.30	64.78	233.23	479.19	454	480	544	3074
Qershor	58,509.75	30,550.52	65,876.17	33,131.02	52.21	-49.71	8.45	347	405	469	1226
Korrik	58,509.75	35,725.96	65,876.17	46,566.75	61.06	-29.31	30.34	440	414	487	2734
